

BSH-32

R2 96

BIBLIOTEKA E RINISË

**RRUGËS  
MES  
NJERËZVE  
TË  
THJESHTË**

**TREGIME**

891.983-32

R2.96

5

RRUGËS MES NJERËZVE  
TË THJESHTË

TREGIME

2292

~~52084~~

LIBRERIA E SHTETIT  
PRAPASHTË

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## DY FJALË LEXUESIT

Në këtë përmbledhje janë përfshirë disa tregime të autorëve tanë, të cilët përfaqësojnë faqe të prozës sonë të realizmit socialist.

Lexuesi do të ndeshet me një tematikë të larme, me tregime të shkruara në kohë të ndryshme nga shkrimtarët tanë me përvojë të gjatë, si dhe nga letrarë të rinj. Përmbledhje të tilla me një tematikë të caktuar kanë dalë herë pas here si «Ujërat e Verdha», e të tjera, të cilat bëjnë fjalë kryesisht për të kaluarën e hidhur të popullit tonë në regjimet antipopullore.

Kjo përmbledhje ka një tipar të veçantë që e përshkon si fill i kuq nga faqet e para e gjer tek të fundit. Lexuesi do të njihet me personazhe të ndryshëm, me ish-partizanët e Luftës NacionalÇlirimtare, me heronjtë e ditëve të sotme, njerëzit e përparuar të prodhimit dhe luftëtarët e së resë. Duke kaluar nga një pejsazh në tjetrin, nga panorama e Atdheut në kohën e luftës dhe gjer te pejsazhi industrial, nga përceptimi i shkrimtarit që vinte erë barut dhe gjer te «qyteti që ka humbur qetësinë», ku ai, si shkrimtar, e ka zor të gjejë një qoshe të qetë për të shkruar ditën, nuk është e mundur që lexuesi të mos verë re nëpërmjet këtyre faqeve rrugën e lavdishme që ka kaluar populli ynë gjatë këtyre 25 vjetëve nën udhëheqjen e urtë të partisë sonë me shokun Enver në krye.

Te lexuesi nuk mund të mos lërë mbresa të pashlyeshme figura e komunistit Nasi Mitroshi, apo ajo e vajzës së thjeshtë komuniste Katerina, të cilët nuk u përkulën para torturave çnjerëzore të xhelatëve fashistë, po edhe në qeli menduan dhe ëndëruan për lirinë, për jetën e ardhshme, për shokët. Ata u bënë burim i pashembëllt vetmohimi. Kjo qe një shkollë e madhe për gjithë komunistët, gjithë partizanët dhe gjithë popullin tonë të papërkulur nga asnjë rrebesh.

Rinia jonë duke e marrë në dorë një përmbledhje të tillë do të mbushet me optimizëm për të kaluarën e lavdishme dhe për ditët e bukura plot heroizëm që po gëzojmë sot në Shqipërinë tonë socialiste.

## PROVA E MADHE

### 2.

Iku pranvera e vera, plot ngjarje të mëdha. Ranë shira të shumtë dhe toka u bë det. Frynë erërat e Moravës dhe pemët mbetën lakuriq. Iku edhe vjeshta dhe ra dëbora e parë e vitit 1942.

Nasi Mitroshin e nxorën dy herë nga puna si të papërshtatshëm. Kishte një punë të mirë në fabrikën e birrës, po aty u organizua një grevë për t'u shtuar rroga punëtorëve dhe me këtë rast i vunë drunë. Pas një muaji zuri punë në një punishte tullash, nja tre kilometra larg qytetit, po edhe atje nuk punoi më shumë se dy javë. Padroni i punishtes, një bullafiq, e quajti «ngatërrestar të rrezikshëm» dhe e pushoi pa i paguar edhe punën që kishte bërë gjatë atyre pesëmbëdhjetë ditëve. Tani kishte hyrë në një garazh maqinash, po edhe aty s'i kishte ditët e gjata. I zoti i garazhit, një njeri që fliste më shumë greqishten se sa shqipen, nuk i donte njerëzit që merreshin me politikë. Nasi punonte sa për katër, po puna nuk i kishte duk. Shpesh vinte në punë me vonesë. Nganjëherë mungonte një ditë, dy, bile edhe një javë. I zoti i garazhit grindej dhe nuk i besonte Nasit, kur ky i thoshte se kishte munguar për arsëye sëmundjeje. Po e kishte mbajtur gjer tani në punë se kishte patur leverdi prej tij.

Nasi Mitroshi ishte zhytur i tëri në punët e Par-

tisë. Edhe sikur dita të ishte njëzet e katër orë si në yllin e Marsit, ai me këto punë do të merrej. Në fabrikën e birrës, në punishten e tullave, në garazh, agjionte midis punëtorëve, shante padronët e fashistët, shpërndante trakte dhe organizonte grupe të vegjël simpatizantësh të lëvizjes nacional-çlirimtare. Domosdo që do të quhej prej padronëve «ngatërrestar i rrezikshëm» dhe do të pushohej nga puna.

Atentati që kishte bërë ja shtoi besimin në forcat e veta. Ai nuk u trondit më, si në fillim, kur plotësoi detyrat e tjera që ju ngarkuan. Tani nuk i merrte më punët aq rrëmbyer. Më parë se të vepronte, do të mendonte mirë e mirë çdo gjë.

Një muaj më parë bëri një atentat tjetër. Ishte veshur përsëri si fshatar, kishte lidhur nofullën dhe ashtu i parruar dukej me të vërtetë sikur të dy anët e fytyrës i qenë enjtur. Kishte marrë informata se kuestori, një katil i pamëshirshëm do të dilte pasdite jashtë qytetit, me një veturë të markës «mileçento»:

Ja edhe vetura ku po vjen, duke lënë prapa shtullungën e pluhurit. Nasi ecte në mes të xhades së ngushtë të paasfaltuar. Dëgjoi borinë prapa krahëve që binte pa pushim, po kokën nuk e ktheu, as rrugën nuk e liroi. Maqina u ndal mu përpara këmbëve të tij, po motori nuk u shua.

— Hap rrugën! — shfryu kuestori duke çelur derën e maqinës, ndërsa shoferi i binte borisë me inat.

Nasi doli më krah të kuestorit dhe vuri dorën në vesh, duke i dhënë të kuptojë me këtë shenjë se nuk dëgjonte mirë.

— Pyka i djallit! Hap rrugën të thonë! — ngriti zërin kuestori. — Mos shko si ata kuajt e arabave.

— Më merrni gjer nga Plasa, o njerëz të mirë, se ma nxori shpirtin kjo dreq dhëmballë! — tha duke vënë njëren dorë te faqet e tjetrën në xhep.

— S'ka vend!

— Po ja, rri këtu përpara, me shoferin.

— More ç'popull i ndyrë! — u sha kuestori dhe i

bëri me shenjë shoferit që të niset. Deshi të thonte edhe diçka tjetër. Po s'e tha dot. Nasi ja kishte drejtuar dhjetëshen në zemër:

— Për Shqipërinë e lirë!

Arma u zbraz dhe gjoksi i kuestorit u bë shoshë nga plumbat...

4.

Nasi Mitroshin e plasën në një birucë të kuesturës dhe kur u përmend, dy orë pas arrestimit e muarën në pyetje. E mori në pyetje vetë kuestori i ri, një burrë i gjatë si lis, me fytyrë të ndritur, pak të kuqe dhe pa qime. Duke hyrë në zyrë, në katin e dytë të kuesturës, Nasi, i shtyrë në kurriz nga roja u pengua te pragu i derës dhe ra përpara këmbëve të kuestorit. Vështroi një hop çizmet e ilustruara të kuestorit dhe u ngrit.

— U vrave? — e pyeti kuestori duke i treguar karrigen që të ulej.

— Jo! — u përgjegj Nasi dhe sytë i vanë te gusha si samar e kuestorit që lëvizte posht e përpjetë sa herë gëlltitej.

Kuestori zuri vend në një kolltuk të kuq pranë tryezës së mbuluar me xham dhe pyeti:

— Si ta thonë emrin?

— Nasi!

— Po mbiemrin?

— Mitroshi!

— Ooo! Ti je Nasi Mitroshi! — ja bëri kuestori i gëzuar dhe si i habitur, sikur të mos e dinte se cili ishte i arrestuari.

U hap dera dhe Nasi pa të hyjë brenda një toger hundështypur e leshtor, si majmun. Togeri nuk u ul, po qëndroi më këmbë në krah të Nasit dhe dëgjonte bisedën me vështrimin përtej dritares së kuesturës, ku dukej, përmes plepave të zhveshur, maja e një xhamie.

— Ç'punë bën? — vazhdoi të pyesë kuestori.

— Jam pa punë...

— S'më kuptove. Ç'profesion ke, doja të pyes.

— Punëtor!

— Përse të kanë arrestuar?

— Ju duhet ta dini. Unë s'di përse.

Kuestori vështroi letrat nën xhamin e tryezës duke bërë sikur i lexonte dhe pa ngritur kokën foli:

— Nuk e di përse të kanë arrestuar? Mirë. Ja, ta pyesim zotin oficer.

Togeri sikur ta kishin kurdisur, me vështtrimin gjithnjë përtej dritares, filloi të tregojë me zë të qetë e të ngadalshëm përse e kishin arrestuar Nasi Mitroshin.

— Nasi Mitroshi, — tha oficeri në një shqipe të keqe, e nga gjuha Nasi e kuptoi se ishte italian, — është komunist dhe ka marrë pjesë në një aksion që është bërë më gjashtëmbëdhjetë të shkurtit kundër forcave tona në afërsi të qytetit. Nasi Mitroshi dyshohet të ketë vrarë agjentin e kuesturës Ruçon. Nasi Mitroshi dyshohet të ketë vrarë ish-kuestorin tonë, të ndjerin zotni...

— Mjaft! — ja bëri kuestori dhe si fërkoji gushën me pëllëmbë, vështroi Nasin drejt në sy. — Tani e more vesh përse të kanë arrestuar?

— Po. Por këto që thoni s'janë të vërteta, — tha Nasi duke u munduar të tregohet i qetë. Po zemra filloi t'i rrahë me shqetësim. Nuk mundi ta shohë kuestorin në sy. Kishte frikë mos tradhëtonte pa thënë asnjë fjalë. U mendua një hop. Nga i kishin marrë vesh gjithë këto? Mos kishin ndonjë spiun në radhët e tyre? A po mos, vallë, në kuesturë çdo njeriu që arrestohet i bëhen të njëjtat pyetje për t'i futur frikë?

— Kështu more Nasi. Kot mendohesh, — ja preu mendimet kuestori. — Ne i dimë të gjitha ç'ke bërë por këto s'na interesojnë. Ne duam prej teje emrat e shokëve të tu. Ne duam të dimë ku janë bazat e ilegalëve, ku shtypen traktet, kush i shpërndan?

Ndërsa kuestori fliste, Nasit i kujtoheshin dhe i kalonin në mendje si në film fytyrat e shokëve të njo-



hur, ilegalët, vendi në qilarin e një shtëpie ku shtype-shin traktet e komunikatat, shokët që i shpërndanin.

— Nga ana ime — vazhdoj kuestori — unë marr përsipër këtë gjë: nëse ti do të tregosh, të zotohem nder-shmërisht që jo vetëm do të shpëtoj jetën, por edhe do të liroj.

Nasi e mblodhi veten; zemra nuk i rrihte më me shqetësim. Edhe kuestorin tani e dëgjonte me qetësi dhe e vështronte drejt në sy.

— Unë s'kam ç'të tregoj. Nuk di gjë! — tha me vendosmëri dhe shtrëngoi grushtat. Po shpejt i liroi se ja vrau zinxhiri me të cilin ja kishin lidhur.

Kuestori u gëlltit e Nasi i pa gushën si kurriz që i lëvizi si ndonjë qenje e gjallë.

— Do të na tregosh tani çerdhet e ilegalëve, një nga një...

— Unë s'njoh të tillë! — ja preu fjalën Nasi.

— Një nga një.

— S'kam ç'të them!

Kuestori vuri pëllëmbët mbi xhamin e tryezës dhe u ngrit.

— Po Dhori Janku, ku e ka bazën? — thirri ai dhe fytyra e ndritur e pa qime ju bë flakë e kuqe.

— Nuk e kam dëgjuar këtë emër!

Kuestori filloi t'i bjerë xhamit me të shpejtë herë me gishta dhe herë me grushta. Nga këto lëvizje Nasi e kuptoi se i hipën xhindët dhe priste nga çasti në çast që ato duar të përplaseshin në fytyrën e tij. Po, për çudi, kuestori e mbajti veten.

— Do t'i tregosh të gjitha dhe do bëhesh pishman për kokëfortësinë tënde!

E mbajtën në pyetje gjersa u lodhën. Dy orë të tëra u munduan me dredhi t'i shkëputnin të paktën edhe një fjalë. E lanë vetëm në zyrën e kuestorit që të mendohej. Po përsëri nuk nxorën gjë. Në mes të natës e zgjuan nga gjumi dhe e morën përsëri në pyetje. E pyetën edhe një herë pa gdhirë mirë. Të nesërmen vazhduan të gjithë ditën, pa pushim gjersa u këputën

edhe ata edhe Nasi vetë. Edhe natën tjetër, vazhdoi kjo punë. Ditën e tretë kuestori, i lodhur sa s'bëhet u dha fund pyetjeve:

— Do të bëjmë të vish vetë të tregosh, — tha me zë shumë të qetë dhe urdhëroi oficerin hundështypur e leshtor si majmun: — jepini një dush të ftohtë dhe mos e lini t'i bjerë të fikët...

## 6.

Nasi Mitroshi e kaloi natën në ethe e në ankth. Në mëngjez, kur u përmend, nuk mbante mend ç'kishte ndodhur me të dhe nuk e dinte se ku ishte. Ndjente vetëm dhimbje të mëdha në gjithë trupin e sidomos në gishtat e duarve. Ishte mbledhur kuspull, përmbys, mbështetur në dysheme vetëm me bërrylet e me gjunjët. Dhe kështu kishte ndenjtur kush e di se sa orë. Duke mbajtur kokën e rënduar si hekur midis pëllëmbëve të enjtura, u mundua të hapë sytë për të parë ku ndodhej. Po nuk pa gjë. Përpëliti ca herë kapakët e syve, pastaj i shtrëngoi fort dhe u mundua t'i hapë përsëri. Po sytë i qenë puthitur. I shqetësuar, ai i fërkoji me kurrizin e duarve dhe i goditi fort fort me noçkat. Sytë i lëshuan xixa, po nuk iu hapën.

— U qorrova! — pëshpëriti ai dhe duke zgjatur krahët thirri — Dritë! Dritë!

I shqetësuar nga kjo e papritur u mundua të ngrihet, po i dhembti tërë trupi, i përvëluan tabanët e këmbëve, i çau peshku i kurrizit, i shkuan të prera në gjoks e në shpatullat. Dhe ra përsëri kuspull përmbys. Majat e gishtave që u përplasën në dysheme, i therën sikur ja preu njeri me thikë.

Me majën e gjuhës preku gjilpërat që i kishin vënë nën thonjtë dhe atëherë e kuptoi nga i vinte gjithë ajo dhimbje e padurueshme. Shtrëngoi me dhëmbë gjilpëren të ngulur nën thoin e gishtit të madh të dorës së djathtë dhe e tërhoqi. Ju duk sikur ja shkuli njeri gishtin me darë. Po pas pak gishti ju lehtësua. Atëherë

mblodhi gjithë fuqitë që i kishin mbetur dhe i hoqi me dhëmbë gjilpërat.

Pas një ore u lehtësua. Dhimbjet ju larguan sikur ja hoqi njeri me dorë. E ndjeu veten disi më të qetë. Dhe atëherë pati dëshirë të shohë ku ndodhej. Po sytë nuk i hapeshin. I goditi përsëri me grushta gjersa i lëshuan xixa.

— Dritë! Dritë! Nuk shoh! Ç'më kini bërë? Më qorruat, të poshtër! — dhe shtrinte krahët përpara duke prekur murin e ftohtë të birucës.

Dëgjoi prapa derës zëra njerëzish. Ndërroheshin rojet.

— Heeeej! Nuk shoh!...

— Ç'ke more që thërret — pyeti roja prapa derës.

— Nuk shoh!.. Nuk shoh!

— Kurrë mos pafsh!

Nasi ishte ngritur e kishte qëndruar përpara dritares së vogël të birucës. Po përtej dritares nuk shihte gjë; vetëm ndjente se dita kishte zbardhur. Shtrëngoi me duar hekurat e kryqëzuara të dritares dhe i tërhoqi me sa fuqi kishte. Po hekurat, të mbërthyera mirë, nuk lojtën nga vendi. Duke ecur anës murit, me pëllëmbët e mbështetura në çimenton e ashpër e të ftohtë, preku derën e drunjtë.

— Nuk shoh! Kush është këtu?

Nuk iu përgjegj njeri.

Nasi i ra derës.

Pas pak vuri veshin dhe dëgjoi këtë bisedim që bëhej, si duket, midis rojeve që po ndërroheshin:

— Mos ja vërë veshin.

— Mos është çmendur?

— Vallahi, me ato tortura, edhe mundet...

— Gjynah more, është shqiptar!...

— Shqiptar? Komunist thuaj. I shërben Moskës.

— E rrahën shumë?

— Të zit e ullirit i punuan! Tabanët ja përvëluan, zemrën ja çanë me kamxhik, i dhanë dy okë kripë, gjilpëra i futën edhe në korrent e vunë.

— Dhe s'tregoi?

— Asnjë fjalë!

— Kush, ai? Nasi Mitrosi?... Po ai ka vrarë kuestorin, ore t'u haptë dera!

— Ikë ore!

— Dhe për këtë do ta pushkatojnë... Po e mbajnë se mos i shkëputin ndonjë fjalë!

U dëgjuan hapa që u larguan dhe pastaj asnjë zë.

Tani Nasit ju kujtuan të gjitha torturat. Kishte ndodhur me të vërtetë ashtu si kishte thënë roja. E kishin rrahur sa mend i kishin marrë shpirtin. Tamam përpara se ta vinin në korrent, ai kishte dëgjuar Jonuz Lapin që bisedonte me ta. Si t'i lajmëronte shokët për këtë tradhëtar, për këtë spiun?

Asgjë nuk mund të bënte.

— ... Do ta pushkatojnë! — Do ta pushkatojnë!  
— i tingëllonin Nasit fjalët e rojes që kishte dëgjuar pak përpara prapa derës. Ndërkaq e përfytyroi veten përpara ushtarëve që kishin drejtuar pushkët kundrejt tij, po menjëherë u mundua ta largojë mendjen gjetkë.

Ju kujtua Teto Kata. Plaka vinte vërdallë nëpër shtëpi duke qortuar nusen që i kishte lënë punët e shtëpisë rrëmujë. Nasi rrinte afër mangallit e mundohej të kapte një gështenjë që kishte vënë mbi prush.

— Dale, more i zi, se do të djegësh dorën! Nuk sheh se po i vë gishtat në zjarr? — e qërtonte e ëma dhe fët e fët ja nxirrte gështenjën nga zjarri.

— Nuk shoh, nënë, po e marr me mend se gështenja u poq. Ja, e dëgjon? Po zjen.

— Asgjë nuk sheh ti, o bir! E me ç'sy të shohësh! Ti s'ke sy, o bir! T'i çkulën me darë qafirët. Ta prenë dritën në burg!

Nasi u mallëngjye shumë nga kjo ngjarje e paqënë dhe fshiu shpejt e shpejt sytë me grushta. Po duke i fshirë, dalloi përpara një gjë të ndritshme, si furrë e ndezur. Nëpërmjet asaj furre flakë të kuqe që ja vrau sytë, dalloi një copë qiell të prerë vijëza-vijëza e të

mbuluar me mjegull. Fshiu përsëri sytë me mëngën e setrës dhe pa përpara. Zemra ja bëri tak!

— Po shoh! Po shoh! — pëshpëriti ai duke kryqëzuar duart në gjoks. Po shoh. . . Dritë! Nuk jam qorruar!

Fytyrat e dashura të Teto Katës e të Sofisë u zhdukën dhe përpara tij u duk dritarja e birucës me hekura kryq e kryq.

Matanë dritares ai pa agimin e ri që shkëlqente si agim pranveror. Pesë metra më tej, ngrihej një avlli nja dy metro e lartë, e zbukuruar nga degët e thata e të njoma, të mbushura me bisqe gati për të shpërthyer, të një dorëzonje të moçme. Degët e saja të holla, të gjata e të shtrembëra, me forcën e tyre të madhe kishin hyrë midis gurëve të murit dhe kishin dalë mbi strehën e mbuluar me një sërë tjegullash të nxira nga koha. Njëpërmjet atyre degëve të dorëzonjës, që në pranverë e në verë kundërmojnë gjithë lagjen, Nasi Mitroshi pa qiellin e larë e të kulluar si ujërat pranverore që rrjedhin përrrenjve të tërbuar të maleve. Këtëj avllisë ishte një truall pa jetë, i mbuluar me llucë dhe me degë lulësh të thata. Matanë saj ishte rruga ku kalonin qytetarët, fjalët e të cilëve i dëgjonte Nasi Mitroshi, po nuk i kuptonte. Një erë e këndshme akaciesh dhe qershijash futej përmes dritares dhe ja përkëdhelte dhe ja ledhatonte fytyrën e vranë, flokët e zez e të pakrehur dhe gjoksin tërë vurata. Duke vështruar atë qiell të mrekullueshëm dhe duke thithur atë ajër të lehtë erë-këndshëm, Nasi e ndjeu veten si në shtëpi të vet, si midis shokëve, si pranë Teto Katës e Sofisë. Po kur ktheu kokën dhe pa muret e errëta e të gërvishitura që e rrethonin, e kuptoi se ishte në një birucë të mallëkuar burgu. Një zog i vogël sa një kokërr arre erdh e mbërtheu kthetrat e veta të përdredhura si majat e pjergullave në një nga hekurat e dritares. Zogu cicëriti, çukiti me sqep prevazët dhe fluturoi i trembur duke u tretur në hapësirë tej nga malet, si guri në ujë. Oh! Sa dëshirë kishte Nasi atë çast të ishte si ai zog e të fluturonte matanë hekurave të dritares, të fluturonte mbi avllinë

e mbuluar me dorëzonjën dhe të arrinte sa më shpejt malet e Moravës, të mbështjellë me guna prej dëbore. Në ato male ai do të takonte partizanët, do të çante me ta dëborën dhe do të luftonte. Në ato male ishte liria, së cilës ai i kishte ndenjur besnik dhe ja kishte duruar të gjitha mundimet si një nënë shtatzënë! Në ato male ai do të jepte edhe jetën e tij të re, po jo në këtë birucë plot lagështirë, të trishtuar e të errët.

Në këtë kohë Nasi dëgjoi hapat e një njeriu që afrohej te dera dhe u përmend. Roja çeli me zhurmë derën dhe pa hyrë brenda, thirri:

— I arrestuar, dil të takohesh me njerëzit e tu!..

Nasi s'bëri zë. U mbajt pas murit dhe mezi u çapit. Zemra i rrahu fort, si pak më parë, kur kishte parë dritë.

Te dera u ndesh ballë për ballë me rojen. Polici ishte një djalë i ri, me një fytyrë të bukur, i veshur i tëri me roba të zeza, sikur mbante zi. Kapellën me strehë të ndritshme e kishte vënë mbi sy, si ndonjë çapkën. Dorën e mbante te rripi rreth belit, ku i varej në këllëf një revolver. Krahaqafë kishte hedhur një rrip tjetër që mbaronte në fund me një kuti prej meshini. Në të sigurisht kishte municion rezervë.

Nasi kaloi përmes korridorit duke u mbajtur me duar anës murit. U ndal përpara një dera me hekura si kangjella dhe matanë asaj dera, pranë dy ushtarëve italianë që lonin një lojë me gishta, dalloi Teto Katën dhe Sofinë. Ato qëndronin më këmbë me nga një bohçë në duar dhe prisnin. Sofia kur e pa Nasin përmes hekurave pëshpëriti me vete: «Ky s'është Nasi!... Të mjerrin, sa e paskan munduar!» Kurse Teto Kata bëri një hap para dhe vuri dorën në zemër. Bohça, ku kishte vënë vezë të zjera, një palë çorape leshi që i kishte thurur vetë ajo me duart e saja, ca bukë e ca mish derri, i ra përdhe, mu te këmbët e një polici tjetër, që qëndronte këtej derës. Sofia u ul të mirrte bohçen.

— O zoti krisht! — tha plaka e tronditur, — qenkan të vërteta ato që thuhën! Bir i nënës! — dhe sytë iu mbushën me lot.

— Ç'ke që bën kështu?! Mos qaj, se kur të dali Nasi do të mallëngjehet! — e qërtoi nusja dhe e ngriti bohçen.

— Ja ku e ke Nasin, moj dritëshkurtër, te dera!

Nasi zuri hekurat me duar dhe mbështeti ballin te to.

— Si je nënë?... Po ti, Sofi?

Gratë ngrinë në vend dhe nuk u përgjegjën menjëherë. Sofisë nuk i ngjiste më si i shoqi ajo fytyrë gjithë njolla të zeza, e shtrembëruar dhe e fryrë në anën e majtë që nga veshi e gjer te qafa.

— Mirë jemi, o bir, — u përgjegj si me vete Teto Kata. Po ç'ta duam jetën pa ty?!.. Sa të paskan munduar qafirët, o Nasi i nënës!.. A të dhembin plagët, o bir?... Kush e di ç'ke hequr!

— Mos u mërzit nënë! S'ka gjë! Do të kalojë edhe kjo!..

— Ç'të mos mërzitem! Po duket si burrat ke qëndruar pa të kanë bërë më këtë ditë... Mos u ep! Me që vajte gjer këtu, qëndro i fortë, si druri i thanës!..

Polici, që ishte këtej derës, hyri në mes tyre dhe ju drejtua Teto Katës:

— Plakë! Përse ke ardhur këtu? Për muhabete të tilla?. S'do të lë herë tjetër, dëgjon?

— Dëgjoj, dëgjoj, që mos të dëgjofsha!

Sofisë ju muarën mendtë dhe u mbështet pas supeve të kërrusura të vjehrrës. Vështroi Nasin dhe heshti.

— Si jini nga shtëpia? — pyeti Nasi.

— Mirë jemi, mirë!

— Po shokët si janë?

— Ty të kujtojnë!

Polici bëri me dorë në shenjë pakënaqësie dhe shfryu:

— E? A u patë?! E patë bukuroshin? Hajt, ikni tani. Ç'kini këtu? Ushqime?... Mirë. Dale t'i kontrolloj! — dhe qëndroi në mes tyre si mur, duke penguar Nasin që të vështrojë nënën dhe Sofinë.

— Ke nevojë për ndonjë gjë, Nasi? — e pyeti Sofia për të parën herë duke e vështruar gjithnjë e habitur.

— Jo, u përgjegj Nasi. — Po menjëherë e ndërroi

mendimin. — Po, po kam. Prisi pak, — tha ai shpejt e shpejt dhe ndërsa polici kontrollonte bohçet, u largua nga dera dhe u kthye në birucë. Hoqi xhakëtën dhe këmishën. Në xhep të pantallonave gjeti një laps të vogël kopjativ. Duke vështruar nga dera, ktheu së prapi këmishën dhe shkroi në mëngën e saj: «Jonuzi është spiun. Merrni masa!»

— Hë, more, ç'bën? Ty do të presim? — u grind polici prapa derës. — Ç'je zhveshur kështu?

Nasi ktheu shpejt këmishën mbarë, hodhi xhakëtën krahëve e doli në korridor.

— Të ka hipur morri? Mirë. Jepua të ta lajnë!

Bohçat i kishin kontrolluar dhe i kishin futur në korridor. Gratë të heshtura e të menduara, prisnin matanë derës me hekura. Nasi zgjati këmishën përmes hekurave dhe u tha grave:

— Siç më shihni, këtu jam ngjallur. Këmisha s'më nxe. M'i zgjeroni pak krahët.

Roja ja rrembeu këmishën nga dora, e shkundi disa herë me ndoht dhe ja flaku plakës në gjoks.

— Hajt! Ikni tani!

Teto Kata vështroi e hutuar njollat e gjakut të përtharë në këmishë, e shtrëngoi atë në gji, i mori erë dhe ja hodhi të birit syt duke pëshpëritur me vete:

— Bir, o bir! Ti je tretur si qiriri e më thua të ta zgjeroj!

— Ikë, plakë. Hajt! Ikni ju thashë! — shfryu përsëri polici.

— Ta laj që sot e ta dërgoj — tha plaka me zë të lartë duke u matur të largohet.

— Jo vetëm ta lash por edhe ta zgjerosh! — ja bëri Nasi duke lëvizur krahët këtej hekurave sikur donte t'u thoshte: «Hapni sytë, te mënga. Merrni masa dhe më lajmëroni!»

— Mirë, mirë! — psherëtiu thellë Teto Kata, pa kuptuar gjë.

— Rri me shëndet! Mos u bëj merak për ne! — tha Sofia dhe e vështroi drejt në sy e përmalluar. Kurse Nasit ju duk sikur i tha: «Qëndro si burrat!»...



Duke larë këmishën Teto Kata qau në heshtje. Lotët e saj rrodhën çurk në govatën tërë shkumbë sapuni. Sofija e thau mbi mangall dhe e hekurosi. Pas dite e shpuri në kuesturë. Nasi ja rrëmbeu nga duart nëpërmjet hekurave, tërë gaz. Sofisë iu duk sikur ai kishte dhimbje të madhe po ashtu bënte për të mos i rënë asaj në sy.

— Prit! Mos ikë! — e urdhëroi Nasi.

Në birucë ai ktheu shpejt e shpejt mëngën e këmishës. Fjalët që ai vetë kishte shkruar ishin zbehur e vende-vende prishur nga ujët e nga sapuni.

— S'më paskan kuptuar! — pëshpëriti, — dhe pa humbur kohë shkroi përsëri.

Gëzimi që kishte treguar pak më parë i qe zhdukur. Këtë e vuri re mirë Sofia. Kësaj radhe ajo u bind se Nasi ishte shumë i dëshpëruar dhe i shqetësuar.

— U thashë të ma zgjeroni te mëngët, kurse juve vetëm e kini larë. S'më nxe, a më kupton? S'më nxe!

— S'donte nëna...

— Mos e pyet atë, bëje ti. Më kupton, Sofi?

Gruaja, si duket e kuptoi se i shkeli synë me marifet.

— Po, po...

— Dhe ma sill këmishën se jam zhveshur. Këtu, në pallatin tim bën ftohtë kijamet! — qeshi ai.

— Mirë. E mora vesh. Ta sjell tani atë këmishën e gjerë ushtarake. Ajo të mban edhe ngrohtë.

Në mbrëmje roja, ai polici i bukur, i veshur i tëri në të zi, ja hodhi këmishën në birucë duke thirrur:

— Merre more, na plase edhe ti me këtë këmishë.

Nasi e rrëmbeu si ndonjë gjë të çmueshme. E ktheu shpejt me duart që i dridheshin. Pastaj e ngjeshi në kraharor, e vërtiti nëpër duar dhe mbuloi me të fytyrën për të ndjerë erën e këndshme të sapunit dhe të ujit.

Lexoi përsëri te mënga shkrimin e imtë, të qartë dhe të kujdesshëm të Sofisë.

— «Lajmëruam. Çdo gjë në rregull! Shokët të falenderojnë. V.F.L.P.».

Dhe qau nga gëzimi...

Në kuesturë rojet ndërroheshin çdo tetë orë. Në mbrëmje dhe pas mesnate ishin dy policë që nuk këmbenin asnjë fjalë me Nasi Mitroshin, sikur të ishin memecë. Nasi shpesh u fliste, po ata ja prisnin shkurt:

— I arrestuar, nuk lejohet të flasësh me policin. Hesht!

Kurse në mëngjez e gjer pasdreke e ruante një polic tjetër, i cili megjithëse ndruhej fort, guxonte dhe këmbente ndonjë fjalë.

— E more Nasi, si u gdhive? — e pyeste polici.

— Si mos më keq!

— A mërzitësh?

— Eja në vendin tim dhe do ta shohësh.

— Po të kishe mend nuk do të vuaje. Koka bën, koka pëson! — i thonte polici dhe Nasi dallonte në fytyrën e tij një shenjë keqardhjeje.

— Asgjë të keqe s'kam bërë, o Rakip (kështu e quanin policin). Në kam bërë ndonjë të mirë, për ty e kam bërë...

— Për mua?! — habitej polici.

— Për ty edhe për gjithë popullin. Për fukarenjtë si ti. Apo je i pasur, o Rakip?

— Mos më folë për politikë. Hajde, a ke qejf të dalësh në korridor? — dhe polici ja hapte derën e birucës.

Nasi e ndjente veten të lumtur që mund të forconte këmbët duke u çapitur poshtë e përpjetë korridorit. Shpesh Rakipi, sipas urdhërit që kishte, e detyronte të pastronte nevojtoret e kuesturës. Sado punë e fëlliqur që ishte kjo, Nasi e pranonte me gjithë qejf. Nganjëherë Rakipi e ftonte në dhomën e vet, edhe ajo e vogël sa një birucë, për t'u ngrohur në mangall, për të këmbyer një fjalë a për të ngrënë së bashku një kokërr gështenjë a një copë bukë.

— S'kam ç'të bëj, o Nasi! Duhet të të ruaj.

— Zanat të mirë ke, si qeni! — ja priste Nasi dhe e vështronte me kujdes për të kuptuar se ç'përshtypje do t'i bënin këto fjalë. Po habitej kur dëgjonte përgjigjen e Rakipit.

— Ke të drejtë. Zanat qensh është ky i yni, — ankohej polici, duke parë me frikë nga korridori se mos e dëgjonte njeri.

Një ditë Rakipi e ftoi të hanin drekën së bashku. Në dhomën e policit kishte vetëm ca gozhdë nëpër muret, një tryezë, një karrige, një krevat dhe mbi të fotografitë e Duçes e të Skënderbeut.

Nasit i dërgonin shokët çdo ditë ushqime nga më të mirat. Dhe kaqë shumë i kishin dërguar sa ai s'dinte ç't'i bënte gjithë ato ushqime. Mori një kuti me reçel dhe si e hapi, e vuri mbi tryezë.

Duke ngrënë me shije reçelin, Rakipi i tha pa të keq:

— Ti, Nasi, kot merr veten më qafë. Më mirë trego ç'të kërkojnë, që të shpëtosh. E kush do ta marrë vesh se ke tradhëtuar?

— Le që unë s'di ç'të tregoj, — ja preu Nasi, — po edhe sikur të dija, nuk do të tregoja. Njeriu duhet të jetë i ndershëm. Tradhëtia është gjëja më e shëmtuar. Kush tradhëton s'është njeri.

— Po unë ç'jam?...

— Ty të kanë gënjyer, Rakip. E ç'je ti në fund të fundit? Një fukara, si unë, hyzmeqar ke qenë tërë jetën. Për të tjerët ke punuar, për aganë e fshatit. Tani të kanë dhënë pesë napolona të krimbura, një kostum polici dhe një kobure për të vrarë vëllezërit e tu.

— Unë s'kam vrarë njeri...

— Kanë vrarë shokët e tu, ata që më bënë mua më këtë ditë. Po edhe ti një ditë do t'i lyesh duart me gjak. S'ta kanë dhënë kot atë kobure.

Polici dëgjoi duke vërtitur nëpër gishtat një lugë të vogël prej alumini, pastaj tha:

— Tani ik, se mos na vijë njeri.

Nasi shtyu karrigen prapa për t'u ngritur, kur, pa-

pritur, në sirtarin pak të hapur të tryezës pa një revolver.

— Hajde Nasi se do të më marrësh më qafë...

— Ja, se më janë mpirë këmbët, — gënjeu ai dhe me shpejtësi e çeli edhe pak sirtarin. Tani revolverin e dalloj më mirë. Ishte një «beretë» italiane me karikatorin brenda. Mjaftonte të shtrinte dorën dhe ta merrte. Mos e kishte lënë me qëllim Rakipi atë armë? Zemra i rrahu fort. U ngrit ngadalë dhe ndërsa polici vështronte nga korridori, preku me pëllëmbë çelikun e ftohtë.

— Po he more, ç'bën? — u nxeh roja, dhe i zëmëruar i bëri me shenjë që të largohet.

Nasi u mbështet pas tryezës dhe e mbylli sirtarin me trup.

— Ja, dola, — tha ai dhe çalë-çalë, duke u mbajtur pas mureve, kaloi përmes korridorit dhe hyri në birucë. Dëgjoi zhurmën e hekurave, me të cilat Rakipi kyçi derën...

Pas dy orëve dëgjoi një shamatë që bëhej në korridor.

— Ç'm'u bë revolja? — thërriste një njeri me dëshpërim.

— Ku e di unë! — u përgjegj Rakipi.

— Në sirtar e kisha. Kush e mori?

— Hajd, more, tutkun! Kush e di ku e ke lënë.

— Mos u tall! Ma jep në e ke marrë!

— Unë s'mbaj dot timen! Ç'më duhen dy!

— Po kush e mori?! Qenat! S'lë dot një gjë se ta vjedhin! S'di njeriu ku t'i lërë plaçkat! Të poshtërit!

Nasi, i shtrirë në kurriz mbi batanijen e qelbur, me krahët nën kokë, dëgjonte policët që shaheshin dhe buzëqeshte i kënaqur.

U hap dera dhe te pragu i saj Nasi pa fytyrën e prishur të Rakipit.

— Dëgjo, more, mos ke marrë ndonjë revole? — pyeti me inat duke parë nëpër birucë.

— Çfarë! — bëri sikur u habit Nasi dhe u ngrit ndenjur.

— Atje në sirtar ka qenë një revole, mos e more ti?  
— Revole?!...  
— E!...  
— Ç'ta dua unë atë?  
— Dëgjo, në e ke marrë, ma jep se. . . do të liroj-  
më.  
— Je në vete, — tha Nasi dhe u shtri përsëri si  
pa të keq.

Rakipi shau një herë, mblodhi supat dhe doli.

Mbi derën e birucës ishte një kamare e vogël ku  
qe vendosur llamba e elektrikut. Atje e kishte vënë Nasi  
revolverin. Po tashi iu duk vend fare i papërshtatshëm.  
Po t'i bënë një kontroll, menjëherë do t'ja gjenin. U  
ngrit shpej dhe e mori armën, ja nxori një herë kari-  
katorin. Të shtatë plumbat ishin në të. Arma ishte fare  
e re. Me siguri duhej të punonte mirë. Po ku ta fshihte?  
Mendoi dhe vendosi ta mbajë me vete, por jo në xhep,  
se xhepat shpesh ja kontrollonin. Mori shaminë, dhe  
mendoi ta lidhë armën me të në kofshën e këmbës, mbi  
gju. Bollkat prej shajaku i kishte të trasha e të gjëra.  
Mbi to nuk duhej të dukej fare forma e armës.

Sa lidhi mirë revolen me shami dëgjoj hekurat e  
derës që lëvizën. Padashur i vuri duart prapa dhe e ngje-  
shi armën nën jastëk.

— Nasi Mitrosi! — thirri një zë dhe Nasi dalloj  
te dera gjysmë e hapur oficerin italian, atë hundështy-  
purin e qetë. Oficeri vështroi një herë të katër muret e  
birucës duke mbajtur dorën e djathtë te këllëfi i zbër-  
thyer i armës.

— Përsëri do të kontrolloni? — pyeti Nasi duke u  
munduar të mbajë veten dhe pas pak shtoi: — Urdhë-  
ro e shiko. Vrimë mos lërë pa parë.

Sikur ta kishte urdhëruar njeri rrëmbeu jastëkun  
dhe e ngriti lart. Prapa jastëkut ai shtrëngoi fort revol-  
verin të lidhur me shami. Gishtin tregues e kishte vënë  
te këmbëza.

— Do ta vras, — mendoi Nasi për një çast, — po të  
dyshojë që kam armë, do ta vras.

— Ç'bëni sehir, kontrolloni, — ngriti zërin Nasi dhe i ra batanijes me këmbë. Një çip i saj fluturoi si zog dhe ra mbi çizmet e ndritura të oficerit. Ky bëri një hap prapa e tha qetë-qetë:

— S'kam ardhur për kontroll, po për të të parë si jeton. Pasnesër që pagdhirë do të të heqim prej këtej.

Oficeri u mat të dalë, po qëndroi pak para derës, me vështrimin te kamarja e llambës elektrike. Duke parë Nasin me një vështrim të dyshimtë futi dorën në të.

— Pasnesër që pa gdhirë u bëj gati se do të të çojmë në botën tjetër, Nasi Mitrosi! — tha oficeri duke i theksuar fjalët e fundit dhe doli nga biruca.

Nasit i ra jastëku po revolja i mbeti në dorë.

— Të shohim se kush nga ne do të vejë i pari në atë botë! — pëshpëriti ai dhe si e lidhi armën te kofsha e djathtë e këmbës u shtri përsëri mbi kurriz.

Natën fjeti më keq se herët e tjera. Kur u gdhi, e ndjeu veten të drobitur. I çanin kyçet e këmbëve dhe të krahëve. Mezi u çapit gjer te dritarja e vogël me hekurat kryqe-kryqe. Vështroi dorëzonjën mbi avlli. Ajo kishte filluar të lëshonte gjethe e të përtërihej. Pas një muaj do të gjelbërohej e tëra dhe do të mbushte gjithë rrugën me erën e saj të këndshme. Edhe natyra po përtërihej e po gjallërohej. Malet e Moravës atje larg po e hiqnin dalëngadalë gunën prej dëbore. Qielli s'kishte më re. Zogjtë cicëronin mbi telat, nëpër pemët e në fluturim. Edhe Nasi e donte jetën, ajrin e freskët që futet nga dritarja kryqe-kryqe, diellin me rrezet e tij që i kanë rënë në fytyrë, zogjtë që fluturojnë, njerëzit që kalojnë në rrugë e ai s'i sheh dhe atë dorëzonjën mbi avlli që përtërihet dita-ditës. Po nesër të gjitha këto s'ka për t'i parë e për t'i dëgjuar. Nesër do ta pushkatojnë. Kështu i kishin thënë.

Ju shtua edhe një dëshpërim tjetër. Rakipin ja kishin hequr dhe në vend të tij i kishin sjellë një polic tjetër, nemrut edhe ai, si shokët e tij. Me Rakipin këmbente një fjalë, qante një hall, bënte ndonjë shaka. Kohët e fundit ai kishte filluar ti fliste më hapur dhe

i dukej sikur e kishte bërë Rakipin për vete. Mundet që ai t'i hynte në punë më shumë, ta ndihmonte për ndonjë gjë dhe pse jo, edhe për t'u arratisur. U dëshpërua që nuk i kishte thënë Rakipit të merrte kontakt me shokët e tij, të paktën me Hakiun. Mund të kishte kërkuar t'i sillnin sharra të vogla për të prerë hekurat e kësaj dritareje. Nga kjo dritare mund të shpëtosh jetën. Duhet vetëm sharrat. Pastaj futesh nëpër të, kapërcen avllinë dhe bie në rrugë. Andej të presin shokët dhe jeta.

E pyeti policin e porsaardhur për Rakipin, po polici nuk i dha përgjigje.

— E kam të ndaluar të flas me ty! — vetëm kaq i tha dhe i vuri gojës kyç.

Nasi i fliste shpesh, po polici bënte sikur nuk e dëgjonte. Nganjëherë e kërcënonte me dyfek që të pushonte. Bile një herë polici edhe e goditi me kondak në kurriz. Që atëhere Nasi hoqi dorë dhe nuk i foli më, s'kishte qejf të hante dajak për hiç gjë, për një fjalë goje.

Nga dreka e nxuarën të pastrojë nevojtoret. Prej kaq kohe, për herë të parë punoi fare pa qejf. Mezi mbante fshesën dhe kur përkulej mezi e drejtonte shpinën.

— Nuk punoj dot! — i tha me inat policit dhe e flaku fshesën.

Në korridor, papritur, pa Rakipin. Iu duk shumë i pikëlluar. Vetullat i kishin mbuluar gjysmën e syve. Po u gëzua që e pa.

— Si vete? — e pyeti.

Rakipi nuk iu përgjegj, nga frika e rojes, po u largua duke e parë me një vështrim të shqetësuar, të dhimbshëm e të pikëlluar..

Një orë më vonë Rakipi kaloi përsëri nëpër korridor. Kësaj radhe i bëri shenjë Nasit me kokë, po përsëri ishte shumë i pikëlluar. Qëndroi pak te dera e dhomës së rojeve, ku policët lonin me letra, dhe pastaj ju afrua birucës së Nasit:

— Më caktuan me shërbim në një vend tjetër, — tha ai shpejt e shpejt me zë të ulët, duke vështruar herë Nasin dhe herë derën e çelur të dhomës së poliçeve. — Ke të fala nga Hakiu.

— Nga Hakiu?! — pyeti Nasi dhe fytyra ju gjallërua.

— Më tha të të pyes se ç'nevojë ke.

— Të më dërgojë sharra.

— Sharra! E ç'i do ato?

— Më duhen.

— Unë e di përse të duhen, — tha Rakipi dhe tregoi me një shenjë të kokës hekurat kryqe-kryqe të dritares së vogël. Dhe si heshti pakëz shtoi me mallëngjim. — Është vonë, o Nasi. Ajo që të tha oficeri dje është e vërtetë. E pashë vetë urdhërin e kuestorit... Nesër që pagdhirë... Eh! Nasi! — dhe u largua duke kafshuar buzën...

Dita kaloi shumë shpejt. Gjithë pasdreken Nasi nuk u ul fare. Vinte vërdallë nga një qoshe e birucës në tjetrën duke u ndalur shpesh para dritares. Sikur ta shtynin pushkatimin edhe një javë ai do të mund të shpëtonte. Po tani çdo gjë kishte marrë fund. Edhe sikur t'ja dërgonin sharrat, s'do të mund të bënte gjë. Hekurat e dritares nuk ishin të trashë edhe mund të priteshin lehtë. Po ishin gjashtë copë. Duheshin të paktën tre-katër net për t'i prerë. Dhe duhej bërë një punë me shumë kujdes dhe me shumë durim, vetëm pas mesnate, kur kuestura bie në gjumë... Po tani është tepër vonë. Mirë i kishte thënë Rakipi.

Megjithëse e dinte që të nesërmen do ta pushkatonin, Nasi nuk i kishte humbur të gjitha shpresat. Njeriu që humbet shpresat është një njeri i vdekur. Ku dihej ç'sillte dita e re?

Në mbrëmje, nga vrima e derës së birucës, një dorë e një njeriu të padukshëm hodhi një send të mbështjellë me pëlhurë që ra përdhe me një zhurmë të mbytur. Nasi nuk e pa njeriun po e mori me mend se do të ishte Rakipi. E mori copëzën e pëlhurës dhe e hapi shpejt e shpejt. Në të ishin ca sharra të vogla, pa dorezë. U gëzua sa s'bëhet.



— Sharra! — pëshpëriti ai — një, dy, tri, katër. Katër sharra! — Dhe, duke vështruar hekurat e dritares, shtoi: — Ah! T'i kisha pasur një javë më parë! Sonte duhet të punoj gjithë natën. Po do të jetë zor, se janë shtuar rojet.

Duke pasur mendjen nga dera provoi sharrën pas hekurit të dritares. Sharra nxori një zhurmë që ja ngjethi mishtë, po në hekur shënoi një vijzë të hollë.

— Prekan, po bëkan zhurmë e të vrakan duart — mendoj ai.

Në korridor dëgjoheshin herë pas here zërat e policëve dhe trokëllima e çizmave që përplaseshin mbi çimento.

— Nga mezi i natës do të filloj. Tani mund të më diktoj në fare lehtë. Duhet t'u gjej vendin sharrave, — tha me vete dhe si vështroi rreth e rrotull birucës, ju afrua derës.

I vuri sharrat në të dy anët e derës, në të plasurat midis murit dhe direktut dhe i mbuloi pastaj me tul buke...

Pak më vonë i ndodhi një gjë e papritur, që ai nuk e kishte menduar. Tre policë hynë në birucë dhe si e lanë të hajë darkën, ja lidhën duart me hekura prapa kurrizit. E shtrinë mbi batanije dhe e lanë përsëri vetëm, në terr, si në pus.

— Tani çdo gjë mori fund! — mendoj Nasi dhe pati një dëshirë të flinte për të shkuar i ngopur me gjumë në «atë botë», së cilës ai nuk i besonte. Po gjumi nuk e mori. Nuk ishte gjë e lehtë të flinte para vdekjes. U vërtit me zor mbi batanije duke rënë herë përmbys, herë më një krah e herë më krahun tjetër. Kishte të nxehtë dhe i pihej ujë. Po ujë në birucë nuk kishte. Nga temperatura mbi ballë i dolën sumbulla djerse. Pastaj i hynë të ngjethura dhe mbërdhiu fort. Po s'kishte me se të mbulohej. Filluan t'i merren mendtë dhe i erdhi për të vjellë. Kishte ethe. Herë pas here rënkonte, po asnjëri nuk i afrohej. Ju duk sikur dikush hapi derën ngadalë dhe e thirri me emër. Ishte një zë i panjohur. Ngriti kokën po ishte errët dhe nuk pa njeri. Pastaj sikur u

hap drita dhe biruca llapsi. Në dritën verbonjëse ai pa një mori policësh, oficerësh dhe një prift me mjekër të gjatë gjer te këmbët dhe me një shandan plot qirinj në dorë.

— Nasi Mitroshi, faliu zotit! Kërkoj mëshirë për mëkatet e tua! — dëgjoji ai zërin e ngjirur e të ngadalshëm të priftit, që po i afronte përpara fytyrës një kryq të madh të florinjte.

— Nuk mundem — pëshpëriti Nasi. — I kam duart të lidhura.

Fryu një erë e marrë dhe e përplasi derën disa herë me radhë. Hekurat e dritares së vogël u shkulën dhe ranë përdhe. Prej saj hynë degë plot lule të dorëzonjës. Biruca u mbush me erë të këndshme e të fortë. Nasi u ngrit me zor.

— M'i zgjidhni duart, — tha ai. — Kështu s'falem dot.

Se kush ja hoqi hekurat. Atëhere Nasi u përkul pak dhe me shpejtësi nxori revolverin që mbantë lidhur në këmbë. Nuk ishte më revolver po një bombë e madhe, e rëndë, e kuqe.

— Tani kërkojini ju mëshirë zotit tuaj për krimet që keni bërë se unë s'kam zot! — thirri ai, dhe si ngriti dorën lart, flaku bombën. Bomba shpërtheu. Njerëzit lebetitën. Çatia u hodh në erë. Nasi u gjakos dhe ndjeu dhimbje të mëdha në bylezikët e duarve, në këmbët e në gjithë trupin. Fryu përsëri një erë e marrë dhe e rrëmbeu Nasin, ashtu të gjakosur. Ai fluturoi mbi qytet, lehtë e lehtë, si një pendë, i qeshur, i gëzuar, i lumtur. Qëndroi përpara shtëpisë së tij dhe thirri:

— Sofi! Nënë! Dilni e shikoni si digjen armiqtë! Ejani me mua.

Teto Kata donte ta përqafonte, po ai nuk qëndroi. Fluturoi përsëri, me shpejtësi të madhe. Prapa e ndiqte fluturimthi Sofia duke qarë nga gëzimi.

— Nasi! Nasi! — thërriste ajo me lot në sy.

— Shiko, — i tha ai duke hyrë përsëri në birucën e shkatërruar. — Çdo gjë ka marrë fund. U përvëluan. Vetëm dorëzonja ka mbetur e gjallë, e bukur, e lulëzuar.

Shikoje Sofi! Mos u largo! Pse ke frikë, Sofi? Çdo gjë ka marrë fund. U përvëluan. Vetëm dorëzonja ka mbetur e gjallë, e bukur, e lulëzuar. Shikoje Sofi! Mos u largo! Pse ke frikë, Sofi? Çdo gjë ka marrë fund!...

Kjo kishte qenë vetëm një ëndërr e bukur. Kur u përmend, Nasi e pa veten në birucë, përpara dritares së vogël me hekura. Mbështeti ballin te hekurat e ftohtë dhe mori frymë thellë thellë. Kur ktheu kokën pa pesë a gjashtë ushtarakë që e kishin rrethuar.

— U përmend! — tha dikush.

— Nasi Mitroshi, ec përpara! — urdhëroi një tjetër dhe e shtyu në kurriz, ndërsa dy të tjerë e mbajtën për krahu që të mos binte.

Nasi mblodhi të gjitha forcat. Liroi krahët nga ushtarakët që e mbanin dhe si ngriti ballin lart eci drejt derës.

Përpara kuesturës qëndronte një kamion, i cili në vend të karrocerisë kishte një sëndyq të madh prej dërrase, të lidhur me breza hekuri. Dera e tij nga prapa ishte e çelur dhe në të dy anët e saj qëndronin dy civilë. Nasi nuk i njohu. Ata e ndihmuan dhe e futën në kamion. Dera u mbyll nga jashtë me hekura. Po në këtë kohë motori u ndez, po maqina nuk lëvizti nga vendi. Në kamion s'kishte njeri. Nga një vrimëz sa një pëllëmbë dore hynte drita e zbehtë e elektrikut. Nasi u ul mbi një bidon benzine dhe vështroi përjashta. Roja, i mbështjellë mirë me kapotë, qëndronte i mërëzitur, në kaushin e tij të vogël prej dërrase, në qoshe të derës së kuesturës. Tre-katër oficerë bisedonin italisht me zë të ulët më të hyrë të kuesturës. Dy të tjerë ishin afër rrotës së maqinës dhe pinin duhan, të heshtur. Një veturë «mileçento» u ndal buzë trotuarit. Prej saj dolën dy vetë. Po Nasi nuk mundi të dallojë mirë, se ja vrisnin sytë dritat e ndezura të veturës. Gjithë sa ishin aty përpara kuesturës nderuan ushtarakisht të porsaardhurit dhe i mbështuallën në mes. Kur vetura i fiku dritat, Nasi mundi të dallojë midis tyre kuestorin dhe atë oficerin hundështypurin.

Zhurma e motorit ishte e madhe dhe Nasi nuk mundi të dëgjojë veçse këto fraza të shkëputura.

— Ç'presim? Pse nuk nisemi?

— Duhet të kishim vajtur në karabineri dhe në burgun e madh për të marrë të tjerët.

— Fike maqinën. Do të presim.

— Si? Po na zuri dita! U gdhi!

— Presim urdhër!

Maqina u shua. Ushtarakët disi të habitur mblidhnin supat dhe hynin në kuesturë. U bë qetësi.

Vërtet po gdhihej. Nga vrimëza e kamionit Nasi shikonte një copëz qiell dhe një majë mali nga lindja. Ylli i mëngjezit po tretej. Yj të tjerë nuk dukeshin. Mbi majën e malit ca re të zeza kishin qëndruar si të mbërthyer. Po dukej fort mirë që, së shpejti, në majë të atij mali do të shpërthente dielli. Po diellin sot Nasi nuk do ta shihte. Me siguri para se ai të dilte ata do ta pushkatonin. Rrezet e diellit do të puthnin sot trupin e tij pa jetë gjersa të hapej lajmi dhe shokët me Sofinë e me Teto Katen të vinin e ta mbulonin. Mbi varrin e tij shokët do të betoheshin për t'ja marrë hakun. Dhe do të këndonin me grushtat lart këngën më të dashur të Nasi Mitroshit, atë këngë që ai tani po këndon me zë të ulët:

*Ngrehuni ju, o të munduar  
Ju turët, skllëvër anëmban,  
Na vlon gjaku i turbulluar,  
S'duam patron e as tiran!*

Nasi e filloi këngën ngadalë, si dikur, si atëherë që këndonte në mbledhjet me ilegalët, po pastaj e ngriti zërin:

*Eshtë lufta finale,  
Luft' e fundit për ne, —  
Internacionale  
Do të jet' bot e re!*

Sekush i ra derës së kamionit me grusht. Pas pak Nasi dëgjoi një zë:

— Ç'këndon, more qyq! Ti do të vdesësh!

— Do të vdes? Po ç'është vdekja? A ka vdekje?... S'ka vdekje! — thirri Nasi dhe mbështeti ballin te vrimëza e kamionit.

Pas gjysmë ore maqina u ndez përsëri po kësaj rradhe nuk u ndal. Me dy-tri të hedhura si top, u vu në udhë. Tani ishte gdhirë, megjithëse dielli s'kishte dalë dhe Nasi dallonte çdo gjë në krahun e djathtë të rrugeve, ku kalonte kamioni. Një fshesaxhi po pastronte me fshesën e tij të gjatë prej shelgjishte. U hap me zhurmë një qepenë dyqani. Bar bufe! Kafe pijetore! Vend për reklama! Film i bukur italian! Kinkaleri — parfumëri, vllazën...! Kemi paçë çdo mëngjez! — Kallonin me shpejtësi para syve të tij mbishkrimet e dyqaneve. Te qoshja e një rruge një plak po ndizte cigaren me masat. Fytyrë e panjohur. Një vajzë ecte në trotuar me hap të shpejtë në drejtim të maqinës. «Ecka si Sofia. Sa i ngjan Sofisë! Mirëmëngjez, shoqe!..»

Dëgjoi fishkëllimën e rrotave të frenuara. Maqina bëri stop në vend dhe Nasi ra nga bidoni ku ishte ulur. Qëndruan pak para karabinerisë, pastaj maqina bëri prapaktheu dhe vazhdoi rrugën nga kishte ardhur. Nasi nuk mundi të ngrihet dot për të parë nga vrimëza e kamionit se, kur kishte rënë nga bidoni, kishte vrarë keq të dy gjunjët.

Maqina u ndal përsëri.

— Mbërritëm — mendoj Nasi. — Mos u ep! — i dha ai zemër vetes.

Rreth maqinës se kush jepte urdhëra:

— Hapni derën! Shpejt! Nxirreni! Ja zgjidhni duart brenda! Nuk është mirë të na shohin! Ai është bërë si i vdekur! Largohuni ju! Largohuni!

Nasi ndjeu një gëzim.

— Do të më pushkatojnë me duar të zgjidhura?! Pëshpëriti ai dhe i shkoi mendja te revolveri që mbante lidhur me shami në kofshën e këmbës së djathtë. — Pse s'thua që do ta marrësh vetë hakun Nasi Mitroshti!

Dera e kamionit u hap: Nasi shtangu në vend. Kishin qëndruar përsëri përpara kuesturës.

— Kuestura! — ja bëri ai i habitur dhe zemra i rrahu fort. — Domethënë nuk do të më pushkatojnë sot!...

\* \* \*

Nasi gjithë atë ditë rrahu të gjejë arësyen e anulimit të pushkatimit. Patjetër duhej të kishte ndodhur diçka me rëndësi. Mundet që shokët të kishin zënë prita te vendi i pushkatimit. Mundet që partizanët të kishin kapur ndonjë shtab ushtarak armik, dhe të kishin vënë si konditë për mosprishjen e tij, anulimin e pushkatimit të Nasit e të shokëve të tjerë. Apo mos pushkatimi kishte qenë vetëm një gënjeshtër dhe kuestura e kishte trilluar këtë për të bërë presion mbi Nasin, për ta torturuar. Çdo gjë mund të kishte ngjarë. Puna është që Nasi u kthye në birucën e tij të parë, te sharrat.

Nga mezi i natës, duke shkelur si macja, ai mori sharrat dhe filloi të presë hekurat e dritares. Puna ishte shumë e zorshme, ashtu si kishte menduar. Sharra, që brente hekurin me mundim, bënte zhurmë. Në qetësinë e natës ajo dëgjohej gjer në rrugë dhe jo pastaj në zyrrat dhe në korridoret e kuesturës. Ai u mendua pak për të gjetur mënyrën se si të punonte më mirë. Vuri veshin dhe dëgjoi mbi birucë hapat e rënda e të ngadalshëm të një njeriu. Sikur ishte një korridor i madh. Me siguri roja kalonte posht e përpjetë tij, mendoi Nasi. Filloi të punojë, në ritmin e hapave të rojes. Sa herë roja hidhte hapin, Nasi priste hekurin.

— Një... dy... tri... katër... dhjetë... njëmbëdhjetë, — numëronte Nasi.

Roja u ndal. Ndali punën edhe Nasi. I dogjën pëllëmbët e duarve. Ja kishte zhvoshkur sharra. Grisi një copë të këmishës nga fundi dhe i mbështolli me të anët e sharrës. Kështu nuk do t'i vriteshin duart. Vështroi një herë nga e çara e derës së birucës. Ishte errët

dhe s'pipëtinte njeri. Dëgjohej vetëm një gërhitje në dhomën e policëve. Pas pak u kthye përsëri te dritarja dhe porsa roja lart filloi të ecë, filloi edhe ai nga puna.

— Njëzet... tridhjetë... pesëdhjetë...

Punoj kështu gjer më të gdhirë, me ndërprerje të gjata, me kujdesin më të madh. Kapakët e syve i rëndonin nga pagjumësia. Këmbët i ndjente të këputura. Shpatullat i çanin dhe pëllëmbët i digjnin. Mundi të presë vetëm dy hekura. Nuk i këputi fare po la një fije hekuri sa një gjilpërë e cila mund të këputej me një brehje sharre. Pastaj i mbuloi vendet që kishte prerë me një shtresë të hollë buke të cilën e përtypi më parë në gojë. I fryu pluhurit të hekurit që kishte rënë mbi parmak, vështroi dritaren me kujdes dhe si u bind që s'kishte njeri ta merrte vesh atë punë, fshehu sharrat në vendin e mëparshëm dhe ra e fjeti.

Nuk fjeti shumë po kur u zgjua e ndjeu veten të përtëritur. Për herë të parë bëri ca lëvizje gjimnastikore, po me përtesë të madhe. Hëngri me oreks një kuti të tërë me mish dhe një gjysëm buke. Pastroi me qejf korridorin, nevojtoret, birucën e vet.

Pasdreke dora e Rakipit hodhi në birucë një letër të zhubravitur. Ishte një trakt i komitetit qarkor të partisë komuniste. Nga ai trakt Nasi mori vesh arësyen e anulimit të pushkatimit të tij e të nëntë komunistëve të tjerë të arrestuar prej kohe. Në trakt thuhej se fashizmi barbar kishte vendosur të pushkatonte dhjetë bij të popullit. Nasi i lexoi emrat me radhë. Dhe midis tyre edhe emrin e vet. Ishin të gjithë shokë që ai i njihte. Partia i kërcënonte fashistët për një akt të tillë të paligjshëm e barbar dhe i bënte thirrje popullit që të demonstronte, i madh e i vogël, nëpër rrugët e qytetit, nëse armiqtë do të guxonin të bënin një krim të tillë.

Nasi e lexoi traktin disa herë me radhë dhe e mësoi përmendsh. Sytë i shkëlqenin nga gëzimi. Sillte ndër mend fytyrat e Dhori Jankut, të Hakiut e të shokëve të tjerë. Të gjithë ata kishin menduar për të, për jetën e tij dhe e kishin shpëtuar. E ndjente veten të lumtur, të fuqishëm e të pamposhtur. Kush e di sa herë do të

kishin kaluar Dhori, Hakiu, e shokët e tjerë të njstitit në rrugë, matanë asaj dorëzonjës, që i duket sot aq e këndshme dhe e bukur. Ndoshta edhe tani ndonjëri prej tyre do të jetë aty. Vëzhgojnë, kontrollojnë, nuhatin, presin Nasin që të kërcejë nga muri e të bjerë në duart e tyre. Shokët kishin menduar për të, ashtu si kishte menduar edhe ai për ta...

Natën vazhdoi të presë hekurat më me guxim, po me vëmendjen më të madhe. Dhimbjen në pëllëmbët e zhvoshura e duroi më shumë. Kapakët e syve nuk i rëndonin nga pagjumësia.

— Pesëdhjetë... gjashtëdhjetë... njëqind... dyqind... — numëronte ai hapat e rojes mbi birucë dhe të brehurat e sharrës.

Sharrën tani e përdorte më mirë. Ajo nuk bënte atë zhurmë që bënte më parë. Ja mori dorën dhe puna i shkoi më mbarë. Preu tre hekura. I mbeti edhe një. Edhe një natë punë. Ah! Sikur të kishte edhe tri-katër orë natë! Ai do ta sharronte edhe hekurin e fundit, dhe rruga do të ishte e çelur! Jo, nuk do të ishte e çelur! Ai vetëm do të dilte nga dritarja, do të kapërcente murin dhe do të dilte në rrugë. Po si do ta kapërcejë atë mur dy metra të lartë? Ai s'ka fuqi e s'hidhet dot. Po në rrugë si do të ecë? Atij i janë zënë këmbët, i janë ndryshkur. Vetë, pa u mbështetur te muri, nuk ecte dot. Po sikur ta diktojnë?! Ai s'është në gjendje të vrapojë si njëherë, kur s'i zinin këmbët dhe. Do ta kapin me siguri dhe atëhere, patjetër s'ka më shpëtim. Sigurisht që do të përdorë revolverin, po arma ka vetëm shtatë plumba. Ja, i përdori ata. Pastaj?.. Nasi bluante në mendjen e vet të gjitha mundësitë e arratisjes e të kapjes...

Dy ditë më vonë, porsa u zgjua nga gjumi, pa në të çarën e birucës fytyrën e qeshur të Rakipit.

— E, more Nasi, si vete? — e pyeti ky dhe si uli zërin shtoi: — A je gati?

Nasi brofi në këmbë.

— Gati jam, — u përgjegj pa menduar gjatë.

— Atëhere sonte, në ora njëmbëdhjetë, — tha Ra-



kipi dhe, si i shkeli synë, i bëri shenjë me kokë në drejtim të dritares me hekura dhe u zhduk në korridor duke qeshur.

Po në mbrëmje i ndodhi një gjë tjetër që ja turbulloi mendjen fare. Një marshall që nuk e kishte parë asnjëherë në kuesturë vjen e i thotë:

— Jo në ora njëmbëdhjetë, po në ora nëntë. A dëgjon?

Nasi ngriu në vend.

— S'të marr vesh ç'thua, — ja bëri ai duke mbajtur veten dhe priti që marshalli të hapë derën e të vejë drejt e te dritarja, për t'ja zbuluar gjithë punën. Po marshalli qëndroi prapa derës.

— Në ora nëntë, se më vonë është i ndaluar qar-kullimi, — tha ai.

Nasi mblodhi supat e përsëriti:

— S'të marr vesh!

Si u largua marshalli, i hyri dyshimi. Me siguri puna e tij ishte zbuluar. Tani do ta linin të dilte nga dritarja dhe para se të kapërcente murin do t'i hiqnin një plumb dhe do ta vrisnin. Të nesërmen do të thonin: «U vra në arratisje e sipër!» Vetëm këtë gjë ai nuk e kishte menduar. Ja pra se armiku doli më i fortë se ai.

Ora ishte tetë e mbrëmjes.

— Ç'të bëhet le të bëhet! — tha ai dhe vendosi të dalë në orën nëntë. Në kishte për të dalë le të dilte dy orë më parë. Pa edhe në kishte për t'u vrarë, le të vritej dy orë më parë.

Hapi të gjitha konservat që kishte dhe i shtroi mbi batanije. Kishte vendosur të hante shumë që të fitonte sadopak energji. Po vuri në gojë vetëm një kafshore. Nuk i hahej. S'kishte oreks fare. Vështroi orën dhe u habit kur pa se akrepi kishte dalë vetëm një minutë nga teta. Si ishte e mundur? Ndoshta kishte mbetur ora. E vuri në vesh.

— Tik! tik! tik! tik! — ja bënte ora si gjithnjë.

— Punon, — pëshpëriti Nasi.

Ora punonte për bukuri po Nasit i dukej sikur akrepët nuk lëviznin. Ecte koha jashtëzakonisht ngadalë, ose, më drejt është të thuhet se për Nasin nuk ecte fare.

Nasi u vërtit disa herë nëpër birucë, kot, për të vrrarë kohën. Pastaj u ul rreth darkës së bollshme dhe hëngri me zor edhe një kafshatë tjetër. Sikur ju hap oreksi. Ngjeu një copë bukë me marmallatë dhe filloi ta gdhendë. Pa orën. Ishte tetë e dy minuta. E vuri përsëri në vesh.

— Tik! tik! tik! — ja bënte ajo.

— Sa ngadalë ecën! — pëshpëriti dhe e hodhi copëzën e bukës mbi batanije. Po buka ra mbi një kuti me reçel. Kutia u përmbys dhe reçeli u derdh.

— Në djall të vejë! — ja bëri Nasi dhe ju afrua derës së birucës.

— O polic! Ku je, polic! — tha ai dhe si nuk ju përgjigj njeri, thirri: — O roje, më jep një cigare, more, se m'u ça hunda!

Përsëri nuk ju përgjigj njeri. Policët ishin në dhomën e tyre dhe bënë muhabet. Nasit nuk i pihej duhan, as malli nuk e kishte zënë për të parë policët. Ai donte në këtë mënyrë t'i bindte që të mos dyshonin për të. Kishte tri net me radhë që në orët e vona të mbrëmjes thërriste nga dera duke kërkuar cigare. Herën e parë roja i kishte ardhur, po cigare nuk i kishte dhënë. E kishte sharë dhe kishte ikur. Herën e dytë kishte bërë veshin të shurdhër. Edhe sonte po kështu. Aq më mirë për Nasin. Kështu ja kishte arritur qëllimit.

E pa edhe një herë orën. Kishin kaluar vetëm pesë minuta, kurse ai kujtonte se tani do të ishte nëntë pa pesë. U ul në qoshe të birucës, mbështeti kurrizin pas murit dhe vendosi të mos e shohë kaq shpesh orën. Për të kaluar kohën filloi të numërojë. Numëroi ngadalë dhe shumë, gjer në njëmijë. Pastaj u ngrit dhe i hoqi këpucët, se i qenë tharë e shtrëmbëruar në majë kaq keq, sa ja shtrëngonin gishtat. Ju afrua dritares

dhe zgjati duart, drejt hekurave. Sytë i vanë te ora. Ishte nëntë pa njëzet. Duhej të merrte sharrat për t'i prerë hekurat gjer në fund. Po vendosi ta provojë një herë pa i prerë. I shtrëngoi hekurat me grushta dhe me tërë fuqinë i tërhoqi. Hekurat u shkulën me një zhurmë të vogël dhe i mbetën në duar. Dritarja sikur u zmadhua. Nasit ja bëri zemra tak. Eh! të kishte mundësi të bëhej zog e të fluturonte! Po ai ishte njeri e zog nuk mund të bëhej. Mbështeti hekurat pas murit, dhe, si zgjidhi revolverin nga këmba, e futi në gji.

Dy mendime vlonin atë çast në mendjen e tij. Mendimi se do të shpëtonte dhe mendimi se do të vritej te muri, atje te rrënjët e dorëzonjës, apo te dritarja e birucës. Po mendimi se do të shpëtonte ishte më i fortë. Ai sikur e mbulonte me mjegull të dendur mendimin e vrasjes.

— Tani ecë përpara, Nasi Mitrosi! — i tha ai vetes dhe kërcëu në dritare.

Futi kokën në të dhe vështroi përreth. S'kishte njeri. Nga e majta dukej një pjesë e oborrit të kuesturës e shtruar me plloça dhe njëra qoshe e derës kryesore. Më të djathtë ishin nja gjashtë a shtatë akacie dhe kaçube me ferra e me gjemba. Përpara, matanë avllisë, dukej vetëm një rrip i rrugës.

Nasi u mundua të futë në dritare shpatullat. U vërtit ca herë si ndonjë peshk i zënë në grep po nuk mundi t'i futë. Atëhere e kuptoi se dritarja kishte qenë e vogël dhe nuk e nxinte. Hoqi shpejt setrën prej shajaku dhe u mundua përsëri me të gjitha forcat. Po më kot. E pengonin supat. Eh! kur s'i kishte nja katër gishtat më të ngushtë! Provoi të futet tërthorazi. Shtriu krahun e majtë përpara duke e puthosur pas kokës dhe i dha vetes një të shtyrë të madhe me anën e dorës tjetër që e mbante te prevazi i poshtëm i dritares. Prevazi u thye, po shpatullat ai nuk mundi t'i futë. U lodk sa s'bëhet dhe filloi të dërsijë. Nuk kishte më fuqi. Pushoi një grimës sa mori një herë frymë thellë dhe sa ndryshoi qëndrimin e trupit.

Kësaj radhe futi kokën dhe krahun e djathtë. Me kaq forcë e bëri këtë veprim sa ju duk sikur e vunë në mengene dhe s'mundi të lëvizë as përpara dhe as prapa. Shpatulla e djathtë i qe zënë te një copë hekur që ai s'e kishte prerë gjer te rrëzët. Copa e hekurit : kishte hyrë në mish dhe tani po ja brente kockën. Ai dëgjonte edhe zhurmen e mbytur që bënte fërkimi i hekurit me kockën. Ju muarën mendtë dhe për pak desh i ra të fikët. Përmblodhi edhe një herë gjithë forcat, dhe, duke ju marrë fryma gjithnjë më shumë, shtrihej përpara, zgjatej, hollohej si macja kur kalon në një vrimë të vogël. Rënkoi një herë, dy, tri, katër dhe më në fund nxori një «of» të mbytur. Vuri dorën te goja për të mbajtur klithmën. Shpatulla e djathtë ju thye dhe trupi i tij rrëshqiti matanë dritares.

Me dy tri hapa kapërceu truallin, u kacavir te dorëzonja dhe, pa e kuptuar edhe ai, u gjend matanë avllisë, në rrugë.

Tani s'kishte më fuqi. Mezi u ngrit dhe duke u mbajtur pas murit të rrugës bëri disa hapa.

— Qënke bërë tapë, more Nasi! Ç'paske pirë kaq shumë! — dëgjoi ai një zë të njohur dhe ndjeu mbi krahë një gjë të rëndë. I kishin hedhur një pallto të gjatë gjer në fund të këmbëve. Ktheu kokën dhe pa fytyrat e qeshura të Dhori Jankut dhe të Hakiut. Nuk tha dot asnjë fjalë veç u derdh në krahët e tyre, duke ndjerë lot gëzimi në sy.

— Duro edhe pak. Te qoshja na pret maqina! — i thanë shokët dhe e futën në mes duke e mbajtur për krahu...

...Dhe kështu Nasi Mitroshi u kthye gjallë në gjirin e familjes së vet të madhe.

*(Botohet me shkurtime).*

### H A S M I

— Shoku Qazim, po hiqe vallen de, hiqe. Jepi udhë se na le në vend. Hajde, ngrije — i tha i zoti i shtëpisë komisarit. Dhe filxhani pa bisht, mbushur përgjysmë me raki filloi të vijë përsëri rreth vatrës.

— Ne s'kemi ardhur për t'ja shtruar me raki, o Nuredin vëllai. E pimë nga një gotë e po hajde de, po jo kështu.! Këtë raki e shtet e u merr ndonjë gjë fëmijëve — ja pat komisar, kur filxhani ra përsëri në dorë të tij.

— More po ju lumshin këmbët që më erdhët në shtëpi, pa këtë pikë raki që kemi do ta pimë se s'bën, sa të ziejnë fasulet. Juve ju ka hyrë të ftohtët në palcë, zjarri po siç e shikoni, s'po bëhet për mbarë. Kështu që kjo e shkretë sikur ta ngroh barkun. Po hajde, ngrije, ngrije komisar — ngulte këmbë i zoti i shtëpisë.

— E po, për shëndetin tënd, o mik. Të paçim gëzuar, — uroi komisar e ngriti filxhanin.

— Shëndet e gaz paçi!.. Shëndet pastë Partia mbi të gjithë — ja ktheu Nuredini. Filxhani përsëri nisi vallen. Kur Nuredini ja dha atij që kishte zënë vend në cep të vatrës, një partizani trupngjeshur e me prenka, gishtat e tyre u takuan. Të zotit të shtëpisë i kërceu vetulla e majtë, u ngrit e iu ul disa herë, siç ngrihet e ulet toka, kur nën të shkon urithi.

Kështu i kërcente vetulla e i ndizej shikimi sa herë i jepte filxhanin Zenunit, partizanit me prenka, të cilin shokët e thërritnin shkurt Zeno. Nga thellësia e qënjes së tij shpërthente një psherëtimë e thellë, që tretej brendapërbrenda.

Në këto çaste buzëqeshja, që ai u hidhte mysafirëve, ishte e ftohtë; ajo i ngjante reflektimit të rrezeve të diellit nga dëbora.

Partizanët kishin rënë pas muhabetit për marshimin e fundit dhe s'e vinin re ndryshimin e humorit tek i zoti i shtëpisë. Edhe partizani me prenka s'e vuri re në fillim, por një herë shikimet e tyre u ndeshën e ai vuri re se sytë e Nuredinit ishin turbulluar.

Partizani u hutua, ngriti supet e mbi fytyrë iu end një shprehje habie, përzier me një buzëqeshje naive.

— Ngrije, ngrije — i tha Nuredini, duke i bërë shenjë me kokë për t'i treguar filxhanin që i kishte mbetur në dorë.

Zëri i tij nxori dhe një pjesë të asaj psherëtime të brendshme.

— U bënë fasulet, o bij. A t'jua sjell, a? — u dëgjua zëri i plakës së shtëpisë, që kishte futur vetëm kokën në të ndarën ku kishin zënë vend partizanët.

— Silli, silli sa janë të vala — tha Nuredini dhe u ngrit e shtroi sofrën. Mori dy misërnike e i ndau më katërsh, duke i vënë mbi gju e duke u mëshuar. Partizanët zunë vend rreth sofrës, e ai u afroi nga një copë bukë. Edhe Zenuni ndeu dorën.

— Merre mik, merre — tha Nuredini dhe i zgjati copën e bukës.

Plaka u duk përsëri në derë me një tavë balte në duar, mbushur me fasule që avullonin. I biri u ngrit, ja mori nga duart dhe e vu në mes të sofrës.

— Bujrum, o miq, e mirë se më kini ardhur. Kjo na u ndodh... — dhe Nuredini mori lugën.

— Mirë se të gjetëm, byrazer e buka mos t'u ndaftë nga sofa, e uroi një partizan.

— A s'të ndodhet edhe një lugë tjetër, o mik — i

tha komisari dhe tregoi me sy Zenunin që po ngjyente copën e misërnikes në lëngun e fasuleve. Nuredini i numëroi me sy lugët e drunjtja.

— Mos u vur në siklet, vëlla... Ja, po hamë me një lugë me Kason — e mori fjalën një partizan dhe i zgjati lugën Zenunin.

— Nënë... o nënë... — i bëri zë s'ëmës Nuredini.

Ajo s'u përgjigj.

— Merre timen — i tha Zenunit dhe i zgjati lugën.

U ngrit nga sofa.

Zenunit kësaj here zëri i tij iu duk më i ngrohtë dhe mendoj se Nuredini s'e kishte lënë me qëllim pa lugë, por mund të kishte harruar.

— Po rri, o Nuredin, se jemi mësuar ne... Kemi ngrënë edhe dhjetë vetë me një lugë — foli Komisari, po Nuredini doli pa kthyer fjalë.

Kur u kthye ai, partizanët e kishin gjysmuar tavën.

— Kot që u ngrite, për besë po, kot — i tha ai me mustaqe të verdha.

— Si ore... fjalë është ajo?! Urdhëroni... si në shtëpi tuaj... — dhe sytë i shkuan te Zenuni, i cili i buzëqeshi... Nuredini uli kokën.

— Ka bërë fasule zamani nëna jote!.. i ka zier në poçe të mbyllur — hapi muhabet mustaqeliu. — E di ç'tregojnë për poçen me fasule? Që thua ti, o vëlla, një mbret ka dhënë gjysmën e pasurisë për një poçe fasule.

— Jo ore?! — u habit Nuredini.

— E ore, për një poçe fasule gjysmën e pasurisë dha i biri i botës.

— E ç'nuk bën vaki, xhanëm... Apo është përrallë?

— Po ç'kujtove ti, se mos e ka bërë atë punë Ahmet Zogu, a... jo or jo...

— More, fasuleve u marrtë të keqen... Ai deshte një poçe me ashtu, me nder... me baltë misri, se po hamë dhe bukë...

Partizanët ja plasën gazit... Qeshi me të madhe edhe Zenuni, po me të ndeshur në sytë e Nuredinit e qeshura i fluturoi si një flluskë sapuni.

— Hajde, bromp me fasule, foli i zoti i shtëpisë dhe mbushi lugën. Së shpejti hëngshim në sofër të lirë dhe... Por një krismë e thatë pushke ja këputi fjalën në mes, e atij i mbeti goja hapur.

— Ç'të ketë ndodhur? — pyeti komisari.

— Si pushka e Faros më duket — tha Zenuni.

Pushka u dëgjua edhe një herë.

— Thashë unë, ajo zëngjirura e Faros është...

— Rrëmbeni armët, shokë!..

Në derë u duk një partizan i ri, një çunak 16-17 vjeç.

— Shoku komisar...

— Ç'ndodhi Naum?

— Një tufë nga derrat e Ballit na kanë diktuar e po rrethojnë fshatin.

— Shpejtoni, shokë!

— Gati jemi.

Dhe partizanët dolën pa harruar të falenderonin të zotin e shtëpisë për pritjen e tij bujare. Gjithshka ndodhi vetëtimthi e Nuredini shtangu një çast pa ditur ç'të bënte.

S'kaluan disa minuta e krisi pushka.

Në kasollet e fshatarëve filloi të futet era e barutit, që prishi ajrin e lagësht të asaj mbrëmjeje dhjetori. Nuredini u suall një copë herë nëpër shtëpi pastaj veshi opingat e doli. Me të dalë në oborr dëgjoi fare qartë fiskëllimat e predhave. Ku të drejtohej? Armë s'kishte, vendin ku ndodhej komandanti ose komisari s'e dinte.

— Po si nuk ika bashkë me ta, e hëngërt dreqi. Mos më marrin për ndonjë mik të ballistëve?! Si m'u lidhën këmbët, dreqi e marrtë... — bluante me vete, aty pas gardhit të një kopshti.

Një partizan me automatik në duar kaloi me vrap para tij.

— O partizan! A e di ku është komisari? — e pyeti Nuredini.

Partizani e vërejti.

— Ishin në shtëpinë time, po krisi pushka e s'e di ku kanë zënë vend — u shpjegua Nuredini.



— Hajde pas meje — tha partizani dhe ja dha prapë vrapit. Nuredini u nis pas tij. Por pa arritur akoma atje ku ndodhej komisari, partizanët u hodhën në sulm.

— Tani s'ke ku e gjen komisarin... — i tha partizani me automatik në duar dhe humbi në errësirë drejt krismave, që sa vinte dëgjoheshin më pak.

Nuredini nxori qesen prej lëkure dhe drodhi një cigare të trashë.

— Kushedi ç'do të mendojnë për mua... këmbëlidhur derdimeni... — grindej me vete dhe u nis me hap të ngadaltë për në shtëpi.

«E morën bishtin në shalë qenët» tha me vete duke dëgjuar krismat, që sa vinin e bëheshin më të shurdhëta. S'i bëhej të hynte në shtëpi. U ul mbi një trung lisi të gërryer nga krimbat, aty para shtëpisë. Humbi në mendime.

— Hajde brenda, mor bir... luftë është kjo e shkretë. Hajde brenda, — dëgjoi ai zërin e s'emës, që i qe afruar si një hije.

— Dëgjo, dëgjo. Po e thyejnë qafën ballistët, po marrin bishtin ndër shalë...

Plaka kryqëzoi duart mbi bark e nguli sytë në errësirë, andej nga vinin krismat. Papritur feksën tri raketa të kuqe. Plaka u drodh.

— Hajde brenda bir, luftë...

— Shko ti, shko... e fli pa merak se u pa puna e tyre, i tha Nuredini.

Mbas ndonjë ore krismat e fundit i përpiu nata. Ballistët kishin ikur nga sytë këmbët.

Nuredini drodhi dhe një cigare tjetër sa gishti i madh i dorës.

— Hej, shokë... mblidhuni te bregu, — thirri dikush larg. Nuredini u çua.

— Te bregu!...

— Te bregu... — përsëritnin partizanët në drejtime të ndryshme.

— Te bregu, — tha me vete edhe ai e u nis drejt vendit ku do të mblidhej kompania.

Nëpër errësirë filluan të duken siluetat e partizanëve.

— E? — pyeti Nuredini të parin që i kaloi pranë.

— U dhamë një mësim që s'do ta harrojnë kurrë, ua thyem hundët.

— I mbushën brekët — ja pat një partizan bojalli që mbante mbi sup një mitraloz të rëndë.

— Po komisar i ç'u bë? — pyeti përsëri Nuredini.

— Aty ishte matanë, nga boka... Ja ku po duken ca hije, mos është me ta...

Dhe ai u nis t'u dilte përpara siluetave, që sa vinte e merrnin trajta më të plota.

Dhe vërtet komisar i ishte me grupin e partizanëve që zbritnin nga boka. Vetëm kur dolën te bregu, Nuredini vuri re se ata mbanin ndër duar dy shokë.

Nuredinit i theri në zemër, e aty për aty nuk guxoi ta pyeste komisarin, i cili ashtu si edhe partizanët e tjerë dukej pik e vrer.

— Qenkan vrarë — pëshpëriti Nuredini dhe u nis pas partizanëve. Ata ndaluan pranë disa shkurreve, pas të cilave mbështetën armët.

— Kujdes! — u dëgjua zëri i komisarit.

Partizanët lëshuan ngadalë shokët që mbanin në duar, sikur të druhen se mos i zgjonin prej gjumit.

Një çast u bë heshtje. Dy partizanë u përkulën mbi njërin prej shokëve.

— Qemal... dikush foli.

I plagosuri rënkoi... Ata i shkopsitën gjoksin.

Nuredini u afrua.

— Mos ju duhet ndonjë gjë për të plagosurit?

Me sa duket ai foli shumë ngadalë, e s'u përgjigj njeri.

— T'i shpiem të plagosurit në shtëpi më mirë, — tha përsëri ai.

Partizanët kthyen kokën.

— T'i shpiem në shtëpi më mirë, — tha Nuredini.

— Merreni, — tha komisar i.

Partizanët e ngritën të plagosurin. Ai nxori një rënkim të mbytur.

— Mbahu, Qemal, — e qetësoi partizani mustaqeli.

— Po tjetrin — pyeti Nuredini komisarin.

- Ai ka mbaruar.
- Ka vdekur?
- Na mbaroi në duar.
- Oh, të poshtrit!
- E mori në zemër plumbi.
- Po ai tjetri, që e morëm tani?
- Rëndë është, po s'ka rrezik.

Komisari u përkul mbi të vrrarin dhe ra në mendime.

- A e paguan të paktën qentë?
- Nja dhjetëve ua dëgjuam të pallurat e vdekjes vetëm në sektorin tonë. Vetëm ky i palosi nja tre a katër me birkon — dhe komisar i bëri me kokë nga mitra-lozi që ishte vendosur te kryet e partizanit.

— Ishte trim, hë?

— S'kishte shok, — ai s'ja ndante sytë partizanit që heshte, shtrirë në lëndinën e lagur, — Besa s'kishte shok... Xhevahir ishte. Gjithmonë i qeshte buza. Komisar i ndezi çakmakun dhe i ndriçoi fytyrën.

— Shiko, edhe i vdekur duket sikur qesh.

Nuredini zgjati kokën.

— Zenua!... Shtangu i habitur.

— I mbeti peng që ti u solle me atë ndryshe nga ne të tjerët. Edhe kur u nisëm t'i ndiqnim ata zabëhanët më pyeti, po s'dija ç't'i thosha. I mbeti merak...

Nuredini kaloi tri katër herë me zhurmë pështymën; përsëri i kërceu vetulla e majtë.

— E botë, o botë!

— Një pushkë më pak, — shfryu pikëllimin e thellë komisar. — Një pushkë e fortë më pak në kompaninë tonë.

— Pushkët janë tamam, shoku komisar.

Komisari zhytur në atë pellg trishtimi mezi e kapi fillin e fjalëve të Nuredinit.

— E, si, tamam pushkët?

— Në këmbë të tij më kini mua, shoku komisar. S'di a do të bëj aqë punë sa bënte ai, po di të them këtë, o shoku komisar, s'do të lë kusur. Nuredini mori mitralozin që rrinte në kryet e Zenunit, i ra tytës me

pëllëmbë, siç i bie fshatari qafës së kalit të tij që s'e lë kurrë në baltë.

— Ta mbash me nder, o Nuredin, e të mos e turpërosh armën.

— Shoku komisar...

— Shikoja dhe një herë fytyrën, që të mos e harrosh kurrë këtë trim. — Ai ndezi përsëri çakmakun e përsëri vërente me kujdes tiparet me copa hijesh, që luhateshin sipas luhatjes së flakës.

— E mor shoku komisar. Unë mund të harroj edhe nënën time, po këtë sa të kem jetë s'e harroj dot... Më lidh gjaku, shoku komisar — dhe psherëtiu. — Gjaku...

— E paske tëndin Zenunin? ..

— ...

— Po ai s'tha gjë!

— E kisha hasëm, shoku komisar.

— Hasëm? — Komisari brofi në këmbë.

— Po, hasëm e kisha. I jati i tij më ka vrarë babanë dhe vëllanë e madh.

— Përse?

— E... e... Përse!? Për një bisht gomari... Për mustaqet e Çelos, komisar...

— Çudi!

— Unë kam dashur ta vras Zenunin. Bile dy herë i zura edhe pusi, po s'më doli në shteg...

— Prandaj e haje me sy kur i jepje gotën e rakisë...

— Më ra shtëpia në kokë kur e pashë që hyri në derë, po s'e bëra veten. Po kur i dhashë filxhanin, në fillim m'u ndez gjaku e m'u frynë damarët... m'u duk sikur ma vrau për së dyti babanë e tim vëlla.

— Çudi e madhe... Po s'mu duke edhe aq i tron-ditur, bre burrë!..

— E kisha në shtëpi pra, e kisha mik, pastaj e pashë edhe partizan dhe inati sikur m'u fashit.

— Po ky s'dinte gjë?

— Nuk më njihte fare siç duket. Ky ka qenë i vogël kur u futëm në gjak. Pastaj i jati vdiq e këtë e

rriti tezja... në një fshat nja tetë a nëntë orë larg që këtej.

— Ç'ka hequr ky popull..!

— Më rëndon zemra si ndonjë shkëmb, o shoku komisar, e më dridhet mishi nën lëkurë..

— .....

— S'ma pat marrë mendja de, se mund të bëhem vëlla me hasmin.

Komisarit i shkuan mornica.

— Po s'di për nga zotësia a do t'i vij për krah, a do ta nderoj dot — vijoi Nuredini.

— Ja ku të them unë që ke për t'ja kaluar tënd vëllai.. Ai ka grirë ballistë e gjermanë, po ti ke fituar një luftë më të zorshme, o Nuredin. Ti vrave hasmin... atë zakon të egër që na fuste në gjak vëlla me vëlla që na është shtruar prej shekujsh në vatra e na ka lëshuar rrënjët në palcë të trupit e në mes të zemrës.

### CILA ËSHTË KOMUNISTE?

Katerina rrëshqiti mbi çimenton e ftohtë e të lagur. U përpoq të mos zgjonte vajzat. Mezi arriti në vendin e saj.

— Erdhe Rina? — pyeti Iliriana.

Katerina iu shtri pranë e lodhur. Mori frymë e lehtësuar.

— Nuk po fle?...

— Të prisja ty... Ç'donin që të rrëmbyen nga rrjeshti?...

— Shkumëzojnë nga zemërimi. Sidomos ai «vampiri plak.»

Katerina nuk tha asgjë, nuk tregoi si kishte qëndruar pranë drejtorit të kampit, që e quanin «vampiri plak», nuk tha as sa kohë e kishte pritur atë çast, duke bërë ç'ishte e mundur, të ruante zemrën e saj dhe të vajzës së tjerë të kësaj barake, të mos dobësoheshin, të zave të tjera të kësaj barake, të mos jepeshin. Çasti kishte ardhur! Ajo e shikonte drejt në sy vampirin plak. Donte t'i kujtonte se edhe pse i

kanë rrethuar me tela me gjemba, edhe pse u kanë vënë në vend të emrit nga një numër, prapëseprapë ata janë njerëz, njerëz të fortë, gjersa e bënin atë të dridhesh.

Katerina e kishte vështruar me ngulm e heshtur: ajo i dinte të gjitha. Ndërsa ai e kërcënonte se do ta vriste po të mos tregonte rrugën nga kishin kaluar të arratisurit. «Ah!» mendonte Katerina «edhe një mijë jetë sikur të më falin, s'do të nxjerin asnjë fjalë nga unë».

Katerina bënte pjesë në organizatën e fshehtë të kampit, ishte një nga udhëheqëset. Ajo e dinte prej kohësh përgatitjen e arratisjes. Duhej që të shpëtonin sa më parë dhe sa më shumë që të ishte e mundur. Disfatat e njëpasnjëshme i tërbonin nazistët. Ata kishin në dorë vetëm të internuarit e kampeve. Mbi ta do të hakmerreshin. Organizata e kampit mendonte t'i armatoste të gjithë në një farë mënyre. Ata duhej të rezistonin deri në fund për të ruajtur sekretin e arratisjes. Duhej të vigjilonin në çdo çast, që të mos i korrnin tashti, në prakun e fitores. Plani pësoi ndryshime kohët e fundit. Shokët organizuan arratisjen e të dënuarve me vdekje. E dinin që këta ishin grupi i parë i të dënuarve me vdekje, pastaj do të fillonte asgjësimi në masë. Varkat e çetave partizane u afruan pranë portit të vjetër. Shokët kaluan nëpër rrugën e nëndheshme. Kanalin e kishin hapur banorët e lashtë!

Le t'i rrethonin sa të donin hekurat ose telat me gjemba e me korent. Le t'i ndiqnin me qen ose ujçer të llojit më të përsosur që kishin SS-të, prapëseprapë shokët shpëtuan, ata hipën në varkat. Ata kaluan në bregun tjetër të partizanët. Kanali ishte ende i pazbuluar! Dhe sa do të tërboheshin nazistët. Sikur edhe gjithë kampin të përmbysnin, nuk do të gjenin qoftë edhe një mundësi të kapnin fijen e lëmshit. Si të mos ishte krenare Katerina!

Iliriana e shtyu dyshekun prej kashte pranë Katerinës.

Katerina lëvizi dorën në ajër, duke iu përgjegjitur mendimit të saj të brendshëm «S'ka rëndësi asgjë, më

shumë se kjo fitore». I erdhi keq që do të ndahej nga Iliriana. Donte t'ia thonte... po nuk i pëlqenin as përcjelljet, as lotët. E dinte që nuk do të jetonte më shumë se deri në mëngjes. Do të hapej dera e barangës e nazistët të tërbuar do të pyesnin:

— Cila është komuniste këtu?

Katerina do të ngrihej në këmbë. Vërtet ajo ishte e lodhur. Shumë e lodhur. Po do të buzëqeshte duke i shtrënguar dorën Ilirianës. Kështu ishte më mirë. Përse ta shqetësonte që tani? Dhe do të thoshte me ballin lart.

— Unë jam komuniste!

Sa do të dëshëronte që vajzat të mos tronditen. Sa do të kishte dëshirë të dëgjonte këngën e saj të dashur. Le të mbushte kënga boshllëkun e barakës së errët. Pastaj le të dilte e lirë dhe të bashkohej me mër-mëritjen e përjetëshme të valëve. Dhe valët do t'ja këndonin të shkujdesura brezave që do të vinin...

Katerina e mori me mend si flinin vajzat të për-qafuara, sikur donin të mbronin njera tjetrën nga kërcënimi. Një vit të tërë ajo ishte **ngritur** me shpejtë se të gjitha. I vërente me radhë, përpiquej të dinte çdo mendim, çdo dëshirë, çdo luhatje të tyre. Ato e pyesnin Katerinën për çdo gjë. I besonin.

Ajo mendonte: «Ti duhej t'i kishe bërë të gjitha luftëtare, Katerinë! Të gjitha! A thua e ke kryer detyrën tënde? Në qoftë se bien një palë, të ngrihen të tjerët. Ku janë të tjerët e tu, Katerinë? Ku janë? Ti e di, shoqe e dashur, s'mund të ikësh e qetë duke thënë vetëm: «unë jam komuniste». Të gjithë duhet të luftojnë për komunizmin ashtu si ti, ndryshe nuk mund të vijë fitorja.

«Fitorja! Nganjëherë të duket sikur ajo është në prak, mjafton të zgjatësh dorën. Sa e kam dëshëruar ditën e fitores. Sa e kam pritur! Asnjë re. Dritë kudo. Edhe në natyrë, edhe në ballin e njerëzve».

Katerina përshekoi e malluar fytyrën e Ilirianës me dorën e ashpër nga puna e rëndë e kampit. Megjithëse vazhdimisht e zënë, e shqetësuar për jetën e të gjitha vajzave të barakës së saj, ajo kishte vënë re, si me

çudi, lulëzimin e nëntëmbëdhjetë pranverave të Iliriana, që bënte kontrast me çdo gjë që i rrethonte. Ajo e ndjente Ilirianën fare pranë. Nuk mund të besonte se kjo ishte hera e fundit që rrinte me të. E përfytyroi një çast fytyrën e saj të rrethuar nga kaçurrelat, që i binin mbi ballë. I kërkoi në errësirë flokët dhe i përkëdheli. E kishte marrë malli për sytë e kthjellët të Ilirianës.

Iliriana e pushtoi, mbështeti kokën mbi supin e saj. Lotët si pikat e shiut lagnin Katerinën.

— Ç'ka ndodhur?

— Pandeja se nuk do të të shihja më!

— Dhe për këtë qan?

— Nga gëzimi. Ti je prapë këtu pranë meje.

Katerina e shtrëngoi Ilirianën e mbytur në lotë, në krahët e saj, me një dridhje të lehtë. Ajo bënte të gjitha përpjekjet të mbahej ende e fortë. Përfytyronte Ilirianën në errësirën e barakës me këtë ndjenjë të ngrohtë njerëzore, kurse përjashta ulërimën e çakajve SS.

— A e mban mend, ç'thoshte Agroni? I plotfuqishëm është ai që mund vetveten. Rina, të ka marrë malli për të?

— Ç'pyetje! Një vëlla të vetëm kam.

— Gjatë gjithë kësaj mbrëmjeje, gjatë kësaj kohe që numëroja çdo sekondë edhe ajo më dukej e gjatë sa një muaj, unë e qortova veten, që të kam fshehur ndjenjat e mia për Agronin.

— Po unë i kam ditur edhe pse nuk më ke thënë asgjë. A nuk përpiqesh çdo ditë që të flasim diçka për Agronin?

— Nuk e di pse mendoj se në këtë aksion të madh është e pa mundur të mos marrë pjesë edhe ai. Agroni ka thithur po këtë ajër, ka menduar për ty, e ndoshta edhe për mua. Dridhem nga gëzimi.

«A është e mundur në këtë çast të flasësh për këto gjëra?» pyeti veten Katerina. Po ajo nuk donte të numëronte sekondat që futuronin parreshtur. Të maste kohën deri në mëngjez?!

— E gjithë kjo ndodhi atë ditë, — vazhdoi Iliriana.  
— E mban mend? Atë ditë që Agroni kish shkruar një



vjershë për Partinë. Sa e bukur ishte ajo ditë! Dielli lëvizte ngadalë duke zbritur prapa ca reve që ngjanin me krahët e një shpendi gjigant të përflakur. Det i qetë, pasqyronte të gjitha nuancat e ylberit. Rrija e mbështetur në pezulin e dritares tuaj. Dëgjoja zërin e Agronit duke recituar vjershën, ndjeja erën e luleve të pjeshkës. Ndiqja rrymën e ujit me një shkëlqim floriri, kërkoja me sy peshqit, që kërcenin mbi sipërfaqe. Ishte e pamundur të besoja se në atë natë do të kryenim një aksion që do të trondiste gjithë qytetin. Çdo gjë ishte e madhërishme e paqësore.

Iliriana e shtrëngoi Katerinën. Ajo lëvizi pak, sepse iu lëndua plaga nga një e therur e fortë në shpatullën e djegur.

«Çudi» — mendoi Katerina. Agroni kishte qenë fare pranë. Ai ishte komisar i asaj brigade që tërhoqi shokët e kampit. Çfarë kishte menduar duke iu afruar portit të vjetër dhe telave me gjemba? Besnikërinë e pakufishmë të së motrës ndaj idealit të tyre, apo sytë e kthjellët të Ilirianës?» Katerina nuk dinte ç'të thoshte. Do t'i vinte keq apo do gëzohej në qoftë se ai mendonte vetëm për sytë e mëdhenj e të thellë si det... Katerina për vete do të duronte lodhjen, urinë, këtë boshllëk që i krijohej sapo Iliriana ndërpriste tregimin e saj. Vetëm ta shihte edhe një herë Agroni para atij mëngjezi. Vetëm njëherë.

Ç'janë këto mendime? pyeste veten Katerina.

Katerina mbylli sytë. Mendoi: Do të kthehej Iliriana në shtëpinë e tyre, në lagjen e kalasë. Hëna e ngrënë do të rrëshqiste gjithnjë mbi rrugicat e mbi rrjetat e peshkatarëve, mbi qiparizet e kishës së vjetër, mbi sipërfaqen e lëmuar të detit, po me atë ndriçim të praruar. Iliriana do të shpinte gëzimin, dashurinë, lumturinë. Ajo do të mbushte shtëpinë e tyre. Atë nuse, do ta priste gjithë lagjja e peshkatarëve, si një dhuratë pas kësaj lufte të gjatë.

Katerina shtrëngoi dorën e hollë të Ilirianës dhe pyeti veten: «A do të bëhej luftëtare e vërtetë Iliriana?»

A mund të qëndronte ballë për ballë vdekjes pa i pulitur sytë? Apo dinte vetëm të cicërinte?

— Sa herë më ke folur ti për të ardhmen! Për atë të ardhme, kur njerëzit do të jenë Njerëz me «N» të madhe, — siç thua ti. Sa të besoj, Rina! E sotmja jonë ngjan me një ditë të vrenjtur me shi. E ardhmja është qiell i kthjellët pas një rebeshi. E ke parë ndonjëherë bregun, malet, qiellin sa i kaltër dhe transparent është pas rebesheve? Ajo do të jetë e bukur. Po unë dua të jem i singertë. Do të më dukej e ftohtë po të më mungonte dashuria e Agronit.

— Ajo... ditë... e ardhmja!... — tha ngadalë Katerina.

Nuk deshte të kujtonte se nuk i përkiste më asaj dite. Kishte bindje që nazistët nuk do ta gjenin kanalën. Shokët e lajmëruan. «I zhdukën gjurmët». Ajo s'desh të kujtojë as njëshkolonën e gjatë, as si do t'i kthenin me duart lart nga telat me gjemba. Këto skena i kishte parë kaq herë.

— Do të vijë ajo ditë... shumë shpejt... Po përpara se të vijë ne do të luftojmë.

— Çdo ditë luftojmë. Luftojmë jeta me vdekjen. Nuk është mjaft kjo?

— Po, po. Kjo është një luftë e vërtetë, e madhe dhe e vështirë! Ne u kemi treguar atyre, që kanë rënë në grackën e qytetit tonë, se çdo rrugë, çdo mur, çdo shtyllë bile edhe ky port i vjetër është një roje, një kësh-tjellë mbrojtëse kundër tyre.

Na kanë rrethuar nga të gjitha anët? Mirëpo shokët tanë e kapërcyen rrezikun. Ata janë të lirë. Ata janë partizanë.

Katerina u mbajt pas dërrasave që përdornin për të fjetur.

Ato ishin të lagështa, të rrëshqisnin nga duart? Ndjente një dobësi të madhe. Po këtë dobësi nuk deshte ta pranonte as vetë, dhe jo më t'ia pohonte Ilirianës. Ndofta e kishte nga ajo plagë që i hapi ai i mallëkuar me dorezën e revolverit? Apo nga hekuri i skuqur në shpatull? Pandehnin se, duke përdorur të gjitha llojet e

torturave të mesjetës mund ta mposhtnin njeriun. Si nuk e dinin ata «zotërinj të kulturuar të Evropës», që asnjë fuqi nuk mund të mposhtë krenarinë e së vërtetës dhe të së drejtës?

Ç'kishte ndodhur në atë çast, kur «vampiri plak», me sytë e zgurdulluar kërcënonte me dorezën e revolverit të gjithë ata për të cilët dyshonte se ishin komunistë? Asgjë. Katerina e vështronte drejt në sy duke shtrënguar nofullat nga dhëmbja sikur i thoshte:

«Jeta ime vlejti diçka. Bjerë, egërsirë! Ç'mund të bësh tjetër ti? Po dije mirë. Kjo histori s'mbaron me kaq! Nuk është e lehtë të shkelësh mbi ndjenjat e shenjta të një populli».

— Pse hesht, Rina? A ëndërron ti ndonjëherë?

— Po.

— çfarë?

— Lirinë.

«Unë e di, — mendonte Katerina. — E di. Dashuria ime është më e madhe. Ajo më bën të shkoj ballëhapur, sapo të trokasë dera e barangës. Po unë nuk do t'i them asgjë Ilirianës. Ajo do ta shikojë vetë kur të zbardhë pakëz drita. Dashuria e njeriut për të ardhmen, lumturinë e njerëzimit, është një ndjenjë e pakrahshueshme me asgjë.»

— Nganjëherë mendoj se nuk e meritoj Agronin! Si thua ti, Rina? — tha Iliriana.

— Përse?

— Dua të jem si ti... E fortë... E papërkulur.

— Po ti ashtu je! Të gjithë ne jemi të fortë, Iliriana, të gjithë luftëtarë.

— A e ke parë pranverën? E ke vënë re, kur kapërxejmë telat e kampit? Atje ku hapim llogore ka lulëzuar një kumbull. Era i shkund petalet e holla dhe i shpërndan pranë dheut të zi e të shkrihtë. Unë nuk duroj dot kur shkelin mbi to çizmet e lustruara të këtyre kanibalëve. Ato janë shumë të dobëta e të pafytyrë. Kurse këta egërsira duan të na fusin në shpirt, mendimin se e tërë jeta është mbuluar nga një guaskë

e murme dhe çdo gjë është nën pushtetin e saj të gurtë; edhe lulet edhe njerëzit.

Katerina mori me mend vështrimin e syve të Ilirianës.

— Kot e kanë... — pëshpëriti me zërin që po i shuhej. — Kot fare... Së shpejti do të vinë tanët. Dhe këta do të dridhen. Ku do të futen? A e di kush e udhëheq aksionin? Agroni... ynë...

Zëri i Katerinës humbi fare. Ajo betohej me vete, se do të qëndronte deri në mëngjez. Jo. Nuk ishte koha për një dobësi të tillë. Ç'ishte kjo marrëzi? Ta linin forcat pikërisht tashti? Ajo do të ngrihej në këmbë. Sikur të kishte aqë forcë sa të ngrihej edhe një herë në këmbë! Të ecte vetë deri te dera e barakës. I vinte rëndë për dobësinë e saj. Filloi të dridhej. Dridhej pa pushim. Përse kishte aq ftohtë? Sikur të kishin një jorgan!

Rrezet e para të dritës depërtuan nëpër të çarat e barakës; ato hynë si të drojtura në errësirën e zymtë duke sjellë me vete diçka të hollë, të bardhë, delikate, si vesa e mëngjezit.

Iliriana zgjati dorën drejt Katerinës. Pëshpëriti.

«Shiko, Rina». Desh t'i tregonte Katerinës rrezet e dritës. Tjetra nuk u përgjegj. Iliriana u ngrit dhe e shikoi e habitur. Katerina ishte zverdhur. Një curril i hollë gjaku i ishte tharë mbi tëmthat. E kishin mbuluar djersë të ftohta.

Iliriana mbeti një copë herë në gjunjë, duke mos i besuar vetes. Si kishte pasur durim Rina t'i dëgjonte të gjitha të fshehtat e zemrës së Ilirianës duke pasur këtë dhëmbje? Ajo ishte shumë e lodhur. E kishin torturuar pa mëshirë. Iliriana, e tronditur, ishte pushtuar nga një mendim i vetëm.

«Ajo është komuniste. Ja çdo të thotë të jesh komuniste».

— Katerinë! Katerinë!

Vajzat e tjera të barakës u zgjuan nga klithmat e Ilirianës. Ato e rrethuan Katerinën. Iliriana nxitoi të griste një copë nga këmisha e saj e pastër dhe i lidhi ballin. Katerina hapi sytë. Ajo i pa me radhë. I erdhi

keq që u zgjuan kaq shpejt atë mëngjez. Atëhere i lindi mendimi:

«Sa më shumë besim tek njerëzit, Katerinë, aqë më shumë luftëtarë».

Iliriana, e ngrirë si një statujë e gurtë pëshpëriste me vete. «Ajo është komuniste».

Katerina e kapi e para, ndofta, instinktivisht përplasjen e këmbëve të ushtarëve SS. pastaj alarmin. Ajo e dinte se ishin rrjeshtuar ata me vështrimin e etur për gjak. Po kjo do të thoshte që nuk kishin zbuluar asgjë deri në mëngjez.

«Duan të hakmerren mbi këto vajza të reja të pambrojtura? Jo!» — tha ajo, si për t'i mbrojtur.

Ato e shikonin Katerinën drejt në sy. E dinin përse kishte ardhur ai mëngjez me të kërcitura këmbësh e të lehura qensh. Kjo nuk ishte gjë e re. Arratisja ishte e njohur për të gjithë të internuarit dhe nuk mund të mos ngjallnin shqetësim të përplasurat e dyerve në barakat. Cila do të ishte preja e tyre për atë ditë?

Katerina u ngrit përgjysmë.

— Mos u çqetësoni. Kërkojnë komunistët. Duan të na flakin në fytyrë disfatat e tyre. Po shokët tanë shpëtuuan shëndoshë e mirë. Dhe të tjerë do të kapërcejnë në atë rrugë. Dhe të tjerë. Më dëgjoni?...

Në barakë sundoi për një çast një heshtje e rëndë. Vajzat rrinin pranë e pranë.

E besonin Katerinën.

Ajo iu lut **Ilirianës ta ndihmonte te ngrihej** në këmbë. Tjetra e ngriti në mënyrë të pavetëdijshme. Vajzat e rrethuan Katerinën. Ato donin të qëndronin pranë saj, si Anteu pranë tokës dhe ta ndjenin veten të paprekshme.

Dera u përplas me furi. Në prak u dukën dy hije të gjata e kercënonjëse si vdekja. Një zë i vrazhdë kumboi tej e tej barakës së errët dhe jehona e tij u kthye përsëri.

— Cila është komuniste?!

Vajzat u shtrënguan pas Katerinës. Nuk donin ta linin të largohej dhe sa më shumë e mbanin atë pranë,

aq më shumë ndjenin dëshirën për të thënë: «Ne të gjitha jemi komuniste» Katerina lëvizi. Donte të shkëputej dhe të dilte në ballë. Ja, tashti mund të ecte vetë!

Po ato nuk' patën kohë të merrnin veten nga habia. Përballë dy hijeve të zeza u duk silueta e ëmbël dhe delikate e Ilirianës.

— Ne të gjitha jemi komuniste — thirri ajo me sytë që i shkëlqenin si ndër ethe. — Dëgjoni! Ne të gjitha jemi komuniste.

Heshtje dhe urrejtje.

Masivi i trupave të shtrënguara, që mbronte Katerinën, si të ishte një njeri, filloi të ecë përpara!

## KENGA E RE, GJYSHJA DHE NE

Gjyshja ime ishte fort e lashtë. Ajo ishte aq e moçme sa nuk i mbante mend vitet e veta. Ishte e kotë ta pyesje se kur kishte lerë. E vetmja njohuri që kishim për moshën e saj ishte se nuk ngarkohej akoma ato kohë, kur Gjonleka grinte halldupin. Por meqë ne as Gjonlekën nuk e dinim ç'kishte qenë, e aq më pak halldupin, që me sa dukej Gjonleka e kishte grirë me biçak, siç grin xha Agua duhanin, nuk e ngisnim gjyshen për punën e moshës.

Ngandonjëherë mua më dukej se gjyshja ishte aq e vjetër sa dhe Mali i Thatë. Po ta shihje me kujdes lëkurën e saj të duarve, të ngjante sikur ajo kishte veshur një palë dorashka të vjetra, si vetë gjyshja, e të pahekurosura kurrë, aq shumë rrudha kishin duart e saj. Pa le fytyra...

E vërteta që se ajo nuk ishte gjyshe, por nënëgjyshe. Po, po, nëna e gjyshes sime. Gjyshja ime e vërtetë kishte vite që kishte vdekur, por ja nëna e saj jetonte dhe ne e thërrisnim gjyshe.

— U turpërova, o jetë, më turpëroi perëndia. Në këtë moshë dhe të qëndroj akoma! S'është e udhës kështu, kush e di ç'gjynahe kam bërë, e hisenë e kujt kam marrë. Vendi im është tashti atje tej, te qiparizat e shën Spiridhonit, — na thoshte shpesh gjyshja.

Por, megjithëse gjyshja gjykonte se i kishte ardhur

koha të vdiste, ne nuk e përkrahim, ne e donim gjyshen shumë, bile dhe më tepër se nënën. Nëna punonte gjithë ditën në «Shtëpinë e fëmijës» dhe rrallë e shihnim, vetëm mbrëmjeve, dhe ajo që na rriste, ajo që ishte gjithmonë pranë nesh që gjyshja jonë e dashur.

Unë asokohe isha shtatë vjeç. Kurse ime motër që e vogël fare. Po të mos e mbaje për dore ajo gremisej, s'kishte mbushur as dy vjeç.

Ishte fillimi i vitit 1945. Tirana sapo ishte çliruar. Partizanët sapo kishin zbritur nga malet dhe puna e parë që bënë ishte hapja e shkollave dhe e mensave për të vobegtit.

Ne ishim të vobegtë, dhe në përgjithësi në lagjen tonë ishin të vobegtë. Të gjithë qenë ose refugjatë nga lufta ose familje dëshmorësh. Pushteti ishte i yni dhe ky pushtet na kishte dhënë gjithshka: Pallatet e avionit dhe të Moskatit, gjithë Tiranën e re, shkollën e re dhe mensën popullore.

Ne ishim të uritur, kur një ditë janari, një partizane me një kobure të madhe varur me zinxhir na ftoi në mensën popullore.

Unë e kuptova mirë që partizanja ishte e jona, e të vobegtëve, përderisa dhe gjyshen e ftoi të hante në mensë tok me të tjerët. Kjo donte të thoshte që dhe partizanja me koburen e madhe mendonte si unë, që gjyshja duhej të jetonte akoma, që gjyshja të ishte gjithmonë me ne.

Gjyshja nuk donte të jetonte më. Ajo ishte mërzi-tur nga jeta, se nuk kishte parë një ditë të bardhë, dhe sikur të mos ishim ne aq të vegjël, saqë me siguri do të humbisnim rrugëve të Tiranës, ajo nuk do të vinte atë ditë në mensë. Me siguri ajo do të vinte gjyslykët, do të merrte lëmshin e leshit dhe me gjilpërat në dorë do t'i bënte çorape të sojme ndonjë ushtari të divizionit të mbrojtjes së popullit, siç bënte para dy muajve për djemtë e malit, partizanët. Dhe ashtu me gjilpëra në duar do të vdiste...

Por gjyshja na donte shumë. Si mund të rrinte gjyshja në shtëpi atë ditë, kur partizanja kishte thënë



se në mensë do të kishte drekë të vërtetë me mish, dhe ne s'mbanim mend qëkur s'kishim ngrënë drekë me mish. Po të rrinte ajo në shtëpi, kush do të na çonte, mua dhe motrën në mensë? Përveç gjyshes s'kishte njeri tjetër. Për më tepër dhe shumë nga gratë fqinje punonin si nëna ime, kështu që dhe fëmijët e tyre duhet t'i merrte gjyshja ime, natyrisht, dhe gjyshet e botës...

Atë ditë, aty afër drekës filloi një shi i madh.

— Kur bën dasmë fukarai, grisët daullja, — tha gjyshja.

Ajo lidhi gjyslykët me gjalmë. Vuri shaminë e zezë në kokë. Na hodhi neve, mua dhe motrës, bokshanë e saj, kurse Jahos dhe Mehmetit, dy shokëve tanë kuçiotë, gjithonë, që jetonin përballë nesh, u hodhi shkor-sën e vetme që kishim. Dhe na vuri përpara si ndonjë çoban i mirë. Për vete ajo mbeti vetëm me pollkën e hollë.

Shiu binte. Rugët ishin mbushur me gropa uji. Uji kishte mbushur kanalet, dhe atje te tanku gjerman i shkatërruar, i rrëzuar në kanal, uji dilte nga gryka e topit si një çesmë fshati.

Ne nuk shihnim as dy metra tutje. Shiu nuk të linte të ngrejë kokën, ai të qëllonte drejt e në fytyrë. Ishim zënë të katër për dore, kurse gjyshja tani shkonte në mes tonë. Në të vërtetë tani e mbanim ne gjyshen dhe jo ajo ne.

Rrugës mendonim për drekën që na priste dhe Jahua tha:

— Do ngopemi kërmë sot, o none.

— Dhashtë zoti, o jetë, — tha gjyshja.

Mua më erdhi inat me Jahon, që i kujtonte gjyshes mishin, kur e dinte që ajo s'do ta vinte në gojë. Gjyshja s'kishte asnjë dhëmb.

Shiu nuk pushonte.

Rruga nuk ishte e gjatë, por shiu kishte bërë aq shumë baltë dhe llucë nëpër të, sa në çdo hap shkisje dhe mund të gremiseshe. Gjyshja s'kishte fuqi të na

mbante, por xhamet e gjyslykëve të saj dukeshin si llamba të vogla, që na udhëhiqnin, të sigurtë.

Përpara ecnin njerëz të tjerë. Një plakë tjetër po shkonte jo larg nesh. Ishte me çitjane. Ishte labe. E arritëm.

— Ku është vendi ku dërkohet, o bijë, — e pyeti gjyshja plakën labe.

— Ja, motër, ja. Edhe ca e arritëm. — tha plaka labe.

Ne u shtuam. Gjyshja bisedonte me plakën me çitjane, kurse ne llaforeshim me nipërit e saj.

Shiu vazhdonte të binte.

Por kur janë shumë njerëz, rruga në çdo mot që të jetë nuk duket.

Arritëm në mensë... Ishim bërë qull. Gjyshes i ishte ngjitur pollka pas trupit. Ajo shtrydhte palët e fustanit, ne shihnim se si gjyshes i ishin bërë këmbët bllëckë. Dhe plaka labe ishte lagur. As ajo s'kishte ombrellë si dhe gjyshja.

Në mensë kishte shumë njerëz, por më shumë qenë fëmijë, dhe pak burra e gra, që s'kishin gjetur ende punë. Kishte njerëz, por nuk kishte zjarr. Megjithatë kjo kuzhinë kishte mensë popullore, si çdo mensë, dhe një partizan i ri u tha gjysheve:

— Shkoni në kuzhinë, nëno, shkoni të thaheni. I thoni kuzhinierit se ju dërgoi Kiçua.

Dhe ne shkuam në kuzhinë. Ne fëmijët përnara, kurse gjyshet tona pas, pa çka që ato qenë lagur gjithë, gjithë, kurse ne vetëm nga këmbët. Kuzhinieri nuk kishte qejfin tonë. Ai kishte gatuar për pesëqind njerëz dhe tani duhej të ndante gjellën.

Në mensë dëgjoheshin pjatat e aluminit, gavetat dhe lugët. Pirunj nuk kishte.

Ne nuk arritëm të thaheshim. Të gjithë prisnin gjellën, dhe ne shkuam e zumë vend në tryezë. Tryezat ishin aq të mëdha, sa nga çdo anë e tyre, në stola të gjatë, rrinin nga tridhjetë vetë.

Dikush filloi të fliste. Ne ishim të vegjël, dhe të tjerët na pengonin me trupat e tyre për të parë se kush

fliste. Nga zhurma e pjatave nuk dëgjohej se ç'thoshte. Vetëm herë pas here dalloheshin fjalë të shkëputura si: pushteti ynë, revolucioni popullor, mensa, borgjezia...

Papritmas nuk u dëgjuan më as pjatat, as lugët, as fjalët e shkëputura, por një këngë. Ishte një këngë e vogël në fillim, e mbytur, po pastaj sa erdhi e u bë më e madhe, më e fuqishme dhe sa më shumë zmadhohej ajo, aq më shumë njerëz ngriheshin në këmbë.

U ngritëm dhe ne.

As gjyshja jonë, as ajo labja nuk e dinin këtë këngë.

— Adete të reja, — tha gjyshja. Ajo kujtonte se këndohej kështu ndonjë lutje e re para buke. Dhe tek shihte të tjerët që këndonin, bënte kryqin.

Kënga thoshte:

«Internacionale do të jetë bota e re».

Njerëzit këndonin Internacionalen, dhe gjyshja ime bënte kryq; ashtu siç kishte bërë gjithë jetën e saj para buke, atëhere kur kishte pasur të hante bukë.

Kurse kënga ishte një këngë e fortë, që të kujtonte detin me dallgë, detin e egërsuar. Bota e re dukej sikur dhe me këngën e saj luftonte të shkatërronte të vjetrën.

Ne nuk e dinim këtë këngë. Kjo ishte një këngë e re për ne. Dhe nuk e kuptonim dot, as unë, as nipërit e labes përse këndohej para buke. Më vonë e morëm vesh që tok me ne hante dhe grupi i korit partizan, që kishte marrë përsipër t'u mësonte të vobegtëve këngët e reja, këngët e revolucionit.

Sa mbaroi Internacionalja, njerëzit filluan të këndonin këngët partizane. Dhe kur erdhi puna për «Ato maja rrypa-rrypa» ne, fëmijët e lagjes më të varfër të Tiranës, nuk u mbajtëm më, ajo ishte kënga jonë, e baballarëve tanë.

Megjithëse të uritur, ne këndonim. Ishte një gjë e rrallë, aq e rrallë sa gjyshes ju mbushën sytë me lot, ngriti gjyslykët dhe me cepin e shamisë fshiu lotët. Unë e kuptova që ajo gëzohej për ne. Ajo qante nga gëzimi. Dhe kur erdhi radha e mishit të vërtetë, mish pa gënjeshtër, siç kishte thënë partizanja, gëzimi që ndjemë

ishte më i vogël, shumë më i vogël nga ç'prisnim. Ende në veshë na buçiste:

«Internacionale do të jetë bota e re»

Më vonë, herë të tjera, këtë këngë e kënduam dhe ne, bile dhe gjyshet tona. Dhe gjyshja ime harroi ta bënte më kryqin para buke. Ndoshta nuk donte, apo ndoshta e kuptonte që kryqi i të vdekurve nuk shkonte me këtë këngë të gjallë njerëzish, që filluan të jetonin jetën e re?

Kur isha i vogël, nuk' e pyeta ndonjëherë gjyshen time të mirë, kurse tani është vonë.

## ATË DIMER

Ne kurrë s'kishim parë fëmijë aq të dobët. Ai erdhi e qëndroi mbanë fshatit, pranë mullirit të Konineve. Ndoshta s'kishte fuqi të shkonte më tej, ose ndoshta mendoi të flinte atë natë atje, nën pemët e larta e të nesërmen të nisej sërish për rrugë, gjersa të arrinte në atë vend ku njerëzit flisnin një gjuhë tjetër nga ajo e vendit të vet.

Atë e ndiqte nga pas uria si një kafshë dinake dhe, për t'i shpëtuar asaj, ai linte prapa lugina, pyje, qafa malesh, kapërcente përrenj të rrëmbyer malorë e shkonte gjithmonë drejt veriut, pas gjurmëve të të uriturve të tjerë. Më të mëdhenjtë e arrinin në udhët e ngushta malore dhe po në rrugë e linin, sepse hapat e tij ishin të vegjël, ndërsa ato të urisë të mëdhej.

Dhe ai zvarriste këmbët pas atyre pa u shqetësuar nga mospërfillja. E dinte se të nesërmen grupe të tjerë njerëzish do ta arrinin në rrugë e do ta linin mbrapa, ashtu si të parët, po tani ishte mësuar me këtë gjendje dhe s'i bënte shumë përshtypje.

S'i bënte përshtypje as kur të trokiturat e tij nëpër porta të ndryshme mbeteshin pa përgjigje; këto porta ai me mend i quante «memece» dhe ishte më i kënaqur kur s'i përgjigjej kush, se sa atëhere kur të zotët e shtëpisë e përzinin duke i thënë fjalë të vrazhda. Kjo e dëshpëronte shumë djalin e vogël. Ishte një gjendje

tepër e hidhur. Bukë s'të jepte askush. Gati të gjithë të përcillnin me të njëjtat fjalë: «Ne s'kemi për vete. Shko më tutje, mbase ata të japin».

Zia e bukës shtynte, në dimrin e vitit 1944, me mijëra grekë të uritur drejt tokës së Shqipërisë. Lufta i kishte shkatërruar kufitë, ashtu siç kishte shkatërrar edhe ekonominë. Njerëzit e kapërcenin vijën e kufirit pa ju nënshtruar asnjë kontrolli. Në Greqi gjendja vazhdonte të ishte e keqe dhe zia e bukës bënte kërdinë. Grupe të vegjël refugjatësh iknin nga vendlindja dhe drejtoheshin në vendet fqinje a ku t'i shpinte rruga. Ata ishin refugjatë të trishtuar, të verdhë, të leckosur e trokisnin nëpër dyert e një vendi të huaj me ndrojtje e me turp, dhe dukej hapur s'e kishin për zanat atë punë aq të vështirë. Ata s'kërkonin as tokë, as fshatra, as qytete, kërkonin vetëm bukë. Dhe nga shtëpitë e kasollet shqiptare, qindra e mijëra duar nënash, ditë për ditë, lëshonin me bujari në pëllëmbët e thata të refugjatëve, atë send aq të zakonshëm e aq të çmuar, që mban emrin bukë. Të japësh bukë s'është e lehtë, por nënat tona e dinin mirë se, të kërkosh, është akoma më e vështirë.

Disa syresh përpiqeshin të bënin një tregëti të ndershme, dhe sillnin vaj e ullinj në ca kaçupë lëkure. Vajin dhe ullirin i këmbenin vetëm me drithë ose me miell; paraja s'hynte në punë. Po këta ishin të paktë; të shumtët e refugjatëve s'kishin asgjë me vete, përveç një thesi të zbrazur nën sqetull.

Ne, që ishim afër kufirit, i shikonim ata kur vinin grupe-grupe në vendin tonë; i shikonim pastaj edhe kur iknin drejt vendit të tyre, të kërrusur nën peshën e trishtuar të asaj ngarkese. Ata karvanë refugjatësh, duke përshkuar njërin fshat pas tjetrit, duke kapërcyer njërin mal pas tjetrit, arritën deri në Durrës.

Ata kalonin në jetën tonë duke sjellë me vete bren-gën e një populli të tërë, po në zemrat tona prej fëmije, fatkeqësia e tyre mbetej diçka e huaj, e pakapshme dhe ne i shikonim pa vëmendje, ashtu siç shikon njeriu muret e rrugës së vet. Mjërimi i fëmijëve ndryshon

nga ai i të rriturve. Ne këtë e kuptuam atë pasdite, kur një grek i vogël qëndroi nën arrat e larta të mullirit të Konines, pranë vijës së ujit. Ai dukej, sikur mbi supet e tij të imta, kishte sjellë ngarkuar mjerimin e të gjithë fëmijëve grekë.

S'kishim parë kurrë fëmijë aq të dobët; këmbët e duart i kishte të holla si kleçka, sytë të mëdhenj pa shkëlqim dhe buzët të zbeta. Lëkura e tij qe e thatë, e për çudi në ngjyrë të hirit. Koka mezi i qëndronte mbi qafën e hollë e dukej si diçka e huaj në atë trup të vogël. Këpuçë s'kishte. Trupin e kishte mbuluar me një këmishë liri të hapur përpara dhe me një palë pantallona të grisura te gjunjët. Gjunjët i kishte çuditërisht të mëdhenj.

I huaji nuk trokiti në ndonjë portë sepse, duket, e pandehte veten akoma në fshatrat greke dhe i pëlqente më tepër të jetonte si të mundej, se sa të dëgjonte fjalë të vrazhda. Mulliri në atë kohë nuk punonte, dhe djalit kjo nuk i bëri asnjë përshtypje, sepse kohëve të fundit ai kishte parë vetëm mullinj të heshtur. Por ai e pëlqeu këtë vend. Sipër arrave dhe nëpër pemët aty afër, zogjtë cicërinin duke e përzjerë këngën e tyre me atë të jazit të mullirit. Nga koha në kohë, disa laraska fluturonin nga çatitë e shtëpive nëpër pemë duke krakaritur me shëmti. Nga malet e Gramozit vinte shushërima e ujërave të përenjve, që rridhnin tatëpjetë, duke e mbushur ajrin me një uturimë të përhershme e të pambaruar.

Lufta për ekzistencë e kishte mësuar djalin si të vepronte. Ai mblodhi disa shkarpa e kërthije, i vuri njërën mbi tjetrën si të donte të bënte zjarr, pastaj ngriti kokën lart nga pemët, ku zogjtë këndonin të shkujdesur dhe filloi të shikonte me vëmendje. Nxori nga gjiri një llastik e, duke qëlluar disa herë, në pak kohë vrau dy laraska e një rabeckë. Deri në atë kohë praninë e tij gati s'e kishte vënë re askush. Vetëm kur zuri t'i shpuploste laraskat, disa fëmijë të vegjël ju afruan dhe po e vërenin me çudi. Edhe ne e lamë lojën përgjysmë dhe i vajtëm më pranë. Ai vazhdonte punën

i qetë dhe, kur ju duk se i kishte rjepur mjaft, i shkoi në një hell të vogël. Çdo gjë e bënte ngadalë, i matur dhe ne as që na vinte re.

Ne rrinim të heshtur pranë tij dhe ndiqnim me kujdes cdo lëvizje, si të kishim para një prestigjator. Vallë, ç'kishte ndër mend të bënte ai? Mos donte t'i piqte e pastaj t'i hante? Kjo ishte e pabesueshme. Laraska dhe rabecka të pjekura ne s'kishim ngrënë kurrë dhe as që kishim dëgjuar se ato mund të haheshin... Kureshtja na shtynte t'i qëndronim pranë e të prisnim se ç'do të bënte me to moshatari ynë i heshtur, me lëkurë ngjyrë hiri.

Vumë re se pa u pjekur mirë ai u ul në bisht, afroi te goja hellin dhe zuri ta brente me uri mishin e laraskave. Dhe hante duke na shikuar me frikë, si një këlysh që trembet se mos ja rrëmbejnë koskën që lëpin. Gjergji, që ishte pranë meje, luajti nga vendi, dhe greku i vogël e fshehu menjëherë pas kurrizit laraskën e përcëlluar.

— U tremb, e shikon?

— Ka frikë se mos ja rrëmbesh.

Gjergji bëri dy hapa prapa dhe ai filloi të hante sërish, duke hedhur vështrime të frikshme rreth e qark. Duart e vogla e të thata ngjisinin çuditërisht me këmbët e zogut, mishin e paktë të të cilit po e shqyente me uri.

Kureshtja pak nga pak, ja lëshoi vendin dhembjes. Ai dukej sikur sollti atë çast mjerimin e të gjithë fëmijëve të uritur grekë, dhe trishtimi u nder në fytyrat tona.

Deshëm t'i thonim diçka, po s'dinim nga t'ja fillonim e për çfarë të flisnim.

— Kushedi që kur s'ka ngrënë bukë! — tha Gjergji.

E mposhtëm ndrojtjen e filluam ta pyesnim, po ai s'dinte asnjë fjalë shqipe dhe gjithë pyetjeve tona u përgjigjej duke ngritur supet e tij të dobëta.

— «Psomi, psomi. Thelis psomi?»<sup>1)</sup> e pyeti Gjergji.

---

1) «Bukë, bukë. A do bukë?» (gr.)



Greku u mundua të buzëqeshte dhe një sërë rru-dhash ju formuan në të dy çipat e gojës. Vallë, a mund ta besonte një lumturi të tillë? Ne u shpërndamë nëpër shtëpitë tona duke vrapuar. Donim kush e kush t'ja sillte bukën më parë.

Unë, ngaqë e kisha shtëpinë më afër, u ktheva i pari. I zgjata bukën. Ai më shikoi në sy, si të donte të provonte sinqeritetin tim e pastaj shikoi copën e bukës. U ndrojt. Mbase nuk i besohej një gjë e tillë. Ja lashë bukën mbi kthis dhe u largova. Ai e rrëmbeu menjëherë; e zuri copën e bukës me të dy duart, si të kishte frikë mos ja merrnin sërish dhe, duke futur kokën midis supeve të tij të ngushta, nisi të hante me uri.

Në çast erdhën edhe fëmijët e tjerë. Ata ja zgjatnin copat e bukës dhe ai, ndërsa me një dorë hante, me dorën tjetër mblidhte copërat me shpejtësi e i fuste nën këmishë duke na shikuar të gjithë me radhë, ndërsa sytë i shndrisnin nga kënaqësia.

Mësuam se e **quanin Dhimosten**.

Ne ndjeheshim të lumtur. Asnjëherë s'kishim provuar ndonjë gëzim të tillë. Po këtë gëzim na e prishi xhaxha Koci. Ai i shpejtë si era me shi, erdhi u fut në mes të grumbullit tonë dhe i hoqi bukën nga dora grekut të vogël. Djali u mblodh si iriq. Mëria jonë arriti kulmin, kur pamë se ja mori edhe të gjitha copat e tjera të bukës, të cilat shoku ynë i largët i kishte fshehur nën këmishë. Ne sa s'po qanim nga inati.

— Hë mo, ç'ke? Pse ja merr bukën? — i tha Gjergji.

— Si s'të vjen pak keq.

— Pse, buka jote është? — i tha Petrua, që ishte në krahun tim.

Xhaxhi Koci filloi të nxehej dhe na bërtiti:

— Ikni, largohuni!

Ne s'dëgjonim të iknim. Vinim rrotull atje pranë mullirit dhe e shikonim me mëri Kocin, që i rrëmbeu bukën Dhimostenit të uritur. Edhe shoku ynë i largët ishte topitur nga ajo e papritur; ai po e shikonte me frikë dhe me urrejtje njeriun që i rrëmbeu bukën nga duart.

Për çudi, Koci i zgjati dorën dhe i tha të shkonte me të. Shoku ynë në fillim u lëkund, po pastaj i dha dorën e tij të hollë. Ne e shikonim me habi. Vallë, ç'kuptim kishte kjo? Ata shkonin rrugëve të katundit, dhe ne i ndiqnim pas me kureshtje. Ku do ta çonte Dhimostenin xhaxhi Koci dhe pse e mori për dore, kur pak më parë i rrëmbeu bukën? Apo mos vallë u pendua dhe do t'i jepte tjetër? Koci diç mundahej t'i thoshte grekut të vogël, ndërsa ai s'arrinte ta kuptonte. Greku kthente kokën nga ne, sikur t'i vinte keq që e kishin ndarë nga grigja jonë. Ai, me ata sytë e tij të zbetë dukej sikur na lutej për diçka e kërkonte ndihmë.

Koci e çoi në shtëpi të vet. Ne e përcollëm gjer te porta dhe pastaj qëndruam atje duke bërë zhurmë. Nuk donim të iknim. As të sharat e të mallëkuarat e nënës së Kocit nuk na përzunë dot. Qëndronim atje duke pritur se çdo të bëhej me mikun tonë të largët. Pas pak, xhaxhi Koci doli te porta së bashku me Dhimostenin. Tani atij i kishte dalë frika. Qe tulatur pas dorës së madhe të Kocit, si pas një gjëje të butë e të ngrohtë dhe e përkëdhelte pas faqes. Në majën e mjekrës i kishte mbetur pak qumësht.

— Budallenj! — na tha xhaxha Koci. — Për pak e morët më qafë. Po të hante ai gjithë atë bukë që i dhatë ju, me siguri do të vdiste. Të uriturve në fillim u jepet pak ushqim. Tani ky piu pak qumësht e pas pak do t'i jap edhe ca tjetër.

Dhimosteni e kaloi atë dimër në fshatin tonë. Ai u bë shok me ne, shok me lodrat tona.

## LITAR I ZJARRTË

Sapo hapi sytë, Miçua u ngrit menjëherë në këmbë, i trembur se mos atë mëngjez kishte fjetur më shumë nga sa kishte menduar. Duke shkelur mbi cepin e jorganit, hapi të dy kanatat e dritares zënë me perde të bardha. Nata po ja linte vendin ditës e drita e re vërshonte mbi tokë duke nxjerrë nga mugëtira krepa malesh, lugina, pemë, pellgje uji, togje kallamash dhe fushën që kredhej e përgjumur nën shtresën e avujve të mëngjezit.

Nëpërmjet gjetheve të vogla e mishtake, kokrrat e kuqe të shegës dukeshin të ndezura flakë, kurse më tej fiku me hijen e tij të dendur dukej sikur kishte mbësh-tjellë një copë natë dhe e ruante s'di se përse. Miçua e hoqi vështrimin nga fiku, shtyu njërën fletë të dritares dhe u shtriq.

Në dhomën ngjitur, nëna vazhdonte të rrihte qumështin në tundës me goditje ritmike, të cilat ngjanin çuditërisht me melodinë e një kënge të vjetër.

...Ai kishte shumë kohë që e priste atë ditë. Në atë pritje të gjatë, që i përngjante një rrugë pa mbarim, ishin mpleksur si fijet e tërkuzës, dëshirat e shumë brezave të tjerë që kishin jetuar në truallin e mur-më të kasolles së tij dhe në trojet e tjera mbi baltën e zezë të Myzeqesë. Pritja ishte shumë më e lehtë e

shumë më e madhe se sa vjetët që kishte Miço Sema.  
«Sot do të vijë komisioni i Reformës Agrare për të ndarë tokat. Do të marrim tokë!» mendoi ai duke hedhur sytë nga fusha.

Kjo ishte arësyeja që atë ditë i kishte dalë gjumi herët, si fëmijëve në ditët e festave. Gëzimi i tij ishte i thjeshtë e i thellë.

Nëna ju afrua të birit me një vedër në dorë. Fytyra e saj e rrumbullaktë, e tharë nga mungesa e ushqimit dhe e nxirë nga dielli, shprehte një gëzim të përmbajtur sa herë hidhte vështrimin mbi djalin. Ajo psherëtiti. Me atë psherëtimë ajo shfaqti shumë gjëra njëherësh: dhimbjen për të shoqin që i kishte vdekur kohë përpara, mundimet që kishte hequr për të rritur fëmijët e vegjël dhe një farë dyshimi nëse çdo gjë do të shkonte ashtu si ishte parashikuar.

Nënë Ksandës i kishte pëlqyer që djalin e saj të madh, Miçon, e kishin zgjedhur në Komitetin e fshatarëve të varfër dhe ju duk si një shpërblim për lodhjet e për mundimet që pat hequr për ta rritur.

Diçka e madhe kishte ndodhur në jetë, që kurse në Komitet ishin zgjedhur njerëz të thjeshtë, argatë e bujqër pa emër, të cilët më përpara s'i përfillte askush. Ksanda e dinte se shtëpia e beut kishte mbetur e shkretë, që kurse ai u vra në operacionin e qershorit; pjesëtarët e tjerë të familjes kishin ikur në qytet pa u çli ruar akoma vendi duke i lënë sarajet bosh; tani ata dukeshin të trishtuar por jo të frikshëm dhe fshatarët kishin qejf kur përlyenin me baltën e opingave të tyre dyshemenë e kuqe prej pishe ose shkallët e hyrjes me granil të bardhë.

— Ti e di kush u zgjodh në Komitet? pyeti papritur Miçua. — Më të këputurit: Stas Kola, Mit Balashi, Sil Puka, kryetari dhe unë. Gjithë të varfërit.

— Po edhe të varfër nuk jemi! — i kundërshtoi nëna me një vendosmëri që ai s'e priste. — Dje, kur vajta në qytet, në vend të nënprefektit që rrinte me bastun në dorë, e di kë gjeta, apo jo? Ndonin e Kol Mones. Ti qenke këtu, o bir, i thashë dhe ju hodha

në qafë. Pa më dhënë ai një copë kartë, nuk e futnim dot tët vëlla në shkollë, edhe me të ngrënë edhe me të fjetur.

Nëna donte t'i thoshte se, përderisa kishin push-tetin e tyre, kishin gjënë më të rëndësishme, pra nuk ishin të varfër.

Vetëm një hije rëndonte mbi shpirtin e nënë Ksandes. Sak Topanxha, dora e djathtë e beut dhe një nga më të pasurit e fshatit, rrinte akoma fshehur nëpër pyje dhe s'kishte pranuar të dorëzohej në qeveri.

Aj ishte kërcënuar në mënyrë disi të turbullt, po qe se do guxonin t'i merrnin tokat njerëzit e fshatit, duke thënë: «Sa të jetë Sak Topanxha gjallë, le të mendohet ai që do hyjë në tokat e mia».

Nëna e dinte këtë gjë. Ai kriminel s'do ishte në gjendje të qëndronte fshehur për shumë kohë dhe një ditë do mbushte ndonjë hendek, po gjersa të vinte ajo ditë, ai mund të bënte një krim të ri, sepse rrugë tjetër s'i kishte mbetur.

— Kur të vini në arat e Sak Topanxhës, ti mos hyr! — e porositi Ksanda. — Gjej një shkak dhe ktheu prapa...

Djali e vështroi nënën në sy dhe buzëqeshi.

— E kush të hyjë, pastaj? — e pyeti duke e ditur që më parë përgjigjen që do të jepte nëna.

— Le të hyjnë ata të tjerët.

— Po sikur edhe ata të tjerët t'i kenë porositur nënat e tyre, kështu siç më porosite ti mua?

Nëna mblodhi buzët, vari kokën mënjanë dhe lidhi qart mbi prehërin e zi. Fytyra e saj u bë e menduar sikur rrudhat t'i ishin dyfishuar në çast.

— Jo nënë, ne s'kemi frikë nga Sak Topanxha. Ai i ka ditët të numëruara.

Dhe nëna e kuptoi se pikërisht Miçua, djali i saj, do hynte i pari në kufirin e tokave të tij.

Dielli doli nga njëra anë e Tomorrit, si duke vënë një dorë mbi supin e malit. Ndriguan fletët e verdha të malit, kulmi i shtëpisë, skela e pusit, qipia me kashtë

dhe Miçua vuri re si ravijëzoheshin mbi tokën e lagur nga vesa hijet e objekteve. Ato në fillim ishin të buta, pa kufij të qartë, pastaj forcoheshin e bëheshin të qëndrueshme.

Miços ju duk sikur për herë të parë në jetë po vëzhgonte si lindte dielli dhe si e priste toka dritën e tij. Herët e tjera, atë mrekulli që krijon drita e diellit në mëngjez, se kishte vënë re, ashtu siç nuk vë re njeriu ajrin që e rrethon e i duket aqë i zakonshëm.

Kur u kthye në dhomë, pa nënën që po zgjonte Katen duke e tundur nga supi.

Katja hapi sytë dhe lëpiu buzët, sikur gjumi të ishte një ëmbëlsirë e lëngshme dhe sikur dëshironte të mblidhte pikat e fundit.

Miçua doli nga shtëpia dhe mbajti vesh se ju duk sikur dëgjoi një zhurmë jo të zakonshme. Eci dhe disa hapa e qëndroi. Në skajin tjetër të fshatit dëgjohej kumbimi i një daulleje. Vallë, kujt i kishte vajtur mendja ta priste këtë ditë me daulle, si një ditë feste a kushtrimi?

Miço Sema ecte dhe këndonte një këngë partizane. Dhe së largu e shoqëronte gjëmimi i daulles.

«Poshtë padronët, padrejtësia

Thërret populli shqiptar...

Kjo këngë i përshtatej tamam asaj dite dhe gjendjes së tij shpirtërore. Marshi i gjëmonte në kokë edhe atëhere kur nuk e këndonte me zë a me buzë, si një melodi që jetonte diku thellë dhe që përsëritej vazhdimisht.

Shumë herë kishin dëgjuar se do merrnin tokë, po a thua se ky diell i ditës së sotme, do ta bënte të vërtetë atë ëndërr që kishin përkëdhelur në netët e gjata të dimrit, kur era frynte kasolleve me një vërshëllimë të gjatë e të frikshme, ose në ditët e verës, kur çlodheshin shtrirë përmbys mbi tokën e huaj duke pritur t'ua thante djersën era?

Miço Sema e dinte si bie erë ugari kur parmenda kthen tokën e butë dhe gruri kur korret; ai kishte

provuar shijen e athët të drapërit që ka prerë kashë misri, erën e kaut të parmendës dhe pluhurin e imtë që të bie mbi flokë, mbi rroba, mbi qepalla e mbi vetulla, që të futet në hundë e në gojë, gjersa pështyma bëhet e trashë dhe e ngjitshme si zamkë dhe gryka të djeg. Në vend të bukës, ai shpinte në shtëpi pluhurin e tokës që kishte marrë mbi vete. Mundohej të shkundoj prej tij pranë pusit dhe pastaj futej brenda në kasolle. Toka ishte e tjetër kujt, edhe pluhuri që sillte po ashtu; vetëm djersa ishte e tij, por pjesa më e madhe e saj kishte mbetur në arë; ajo pikonte thellë në tokë dhe kripa e saj ushqente rrënjët e grurit a të misrit, njësoj si plehu.

\* \* \*

Komisioni erdhi shpejt. Matjen e tokës e kishin bërë disa javë përpara, kurse atë ditë do të caktoheshin kufijtë e do të bënin ndarjen sipas kurorave. Do të ndanin tokën e Hasan Beut, të Sak Topanxhës, të Manastirit Përdëllimtar, kurse tri a katër familjeve të mesme, do t'u shkëputnin pjesën e tepërt.

Ata filluan nga puna. Përpara shkonin anëtarët e komisionit të shoqëruar nga Komiteti i fshatarëve të varfër dhe prapa vinte një turmë fshatarësh moshash të ndryshme.

Nuk kishin as metër — kordelë. Meqenëse komisionet punonin në shumë katunde njëherësh, ishte e pamundur të gjenin aqë metro sa u nevojiteshin. Në vend të tyre, ata përdornin një litar, i cili në çdo dhjetë metra kishte nga një nyje. Atje ku shkonte litari, dukej sikur kishte shkuar zinxhiri i kuq i revolucionit. Ai e priste tokën si një thikë vigane e ua ndante fshatarëve.

Kryetari i komisionit ishte një burrë i gjatë me tëmtha të thinjura e me flokë të zez. Kjo gjë i jepte atij burri një pamje fisnike. Edhe në sjellje, edhe në fjalët e tij ndihej siguri e besim. Ai ishte i ndërgjegj-

shëm për çastet sublime që po jetonte midis atij populli fukara e të etur për tokë.

Miço Sema ju afrua Stas Kolës dhe duke e tërhequr për mënge, e pyeti se kush ishte ai shoku me xhakëtë të bardhë.

— Nuk e njeh shokun Bexhet? Është agronom në Ministrinë e Bujqësisë dhe ka ardhur si i deleguar për të ndihmuar në zbatimin e reformës agrare. Burrë i mirë, — shtoi ai mendimin e tij, pas prezantimit zyrtar, — ka qenë komisar batalioni.

Miçua i hodhi një vështrim plot respekt Bexhetit dhe asaj çantës së tij prej lëkure dreri (plaçkë lufte), të cilën ai vazhdonte ta mbante krahëqafë, si në kohën kur ishte partizan. Sapo i caktohej toka dikujt, Bexhet Lundra, i jepte dorën dhe e uronte që ta punonte gëzuar.

Vetullat e tij u ngritën me habi përpjetë, kur vuri re disa fshatarë që zbathën opingat e lastikat, hoqën çorapet e grisura dhe filluan të ecnin mbi ugar. Përse vallë? Mos vallë ata donin ta ndjenin me lëkurën e këmbës tokën e zezë e të butë, mos vallë donin të shkelnin me tabanin e tyre mbi tokën e tyre? Kjo do të ishte.

Ai qeshi dhe dikujt i rrahu supat. Sotir Çobani ju hodh në qafë dhe deshi ta puthte kur ai i dha dorën për pesë hektarë tokë.

— Jo mua, — i tha Bexheti, — tokën ta dha pushteti, atë të përçafosh. Unë s'jam veçse një nëpunës.

Kur u fut në tokat e Sak Topanxhës, ca fëmijë nga të fisit të tij erdhën e, me vështrime prej këlyshësh të zemëruar, shikonin njerëzit e qeverisë dhe të fshatit që ndanin tokën duke shtrirë litarin me nyje.

— Pesë hektarë. Kujt t'ia japim këta pesë hektarë? — pyeti Bexheti anëtarët e Komitetit të fshatarëve të varfër.

Miçua priti se kush do të përgjigjej nga fshatarët. Ai kërkoi me sy fytyrat e tyre, po ata, sikur ta dinin atë gjë ju ruajtën vështrimin të tij.

— I marr unë, — tha Miçua me vendosmëri.

— Të lumtë Miço! — e përgëzoi kryetari i këshillit.



Pastaj ju afrua Bexhetit dhe ja shpjegoi me dy fjalë ato sekonda lëkundjeje që ishin ndjerë pak më parë.

Miçua nuk provoi të zbathej. Ai e ndjente tokën me të gjitha shqisat, me të gjitha qelizat e trupit dhe ecte duke kënduar me zë të brendshëm atë këngë që i kishte ngjelur në tru:

«Të drejtat ne s'i lypim

Do t'i marri populli vetë!»

Fjalët e këngës partizane po bëheshin të vërteta. Pas tij muarën tokë edhe fshatarët e tjerë, Kozmai, Sifi, Loli, Tashi dhe një kosovar Mazllëm Hakiu.

\* \* \*

Dreka kaloi shpejt.

Kur po ngriheshin për të filluar sërish nga puna, një fëmijë po vinte fushës duke qarë. Ishte Katja, motra e vogël e Miços.

— Ç'ke? — e pyeti Miçua, — pse qan?

Ajo merrte frymë me ndërprerje dhe me kurrizin e dorës fshinte lotët.

— Ata më përzunë... nuk më lanë të kullosja lopën.

— Cilët? — pyeti Miçua duke i vënë dorën mbi flokë.

— Çunat e Sakut... Ata i ranë lopës me gur.

— Po ti ç'bëre?

— Unë u thashë kjo s'është toka juaj, se këtu shkoi litari.

«Shkoi litari» — shprehje e çuditshme që lindi asokohe në fushat e Myzeqesë. Për feudalët dhe për klasat e larta ai qe vërtetë si litar i zjarrtë.

— Shumë mirë, — i tha Miçua, — ti je gocë e zgjuar

\* \* \*

Kur mbaruan punë, thua jse qe bërë muzg. S'u mbe-tej gjë tjetër veçse të ktheheshin në fshat. Daullja akoma vazhdonte të binte dhe të goditurat mbi lëkurë ndiheshin rreth e qark nëpër fushë. Me siguri atje në

shesh të fshatit njerëzit kërcenin e këndonin, po kënga shuhej pa arritur gjer tek ata.

Miçua shikoi fushën, ku ata sapo kishin ngulur shtyllat mbi të cilat do të ngrihej një botë e re. Së shpejti, në tokat që u ndau Reforma, bujqërit do lëronin ashtu si asnjëherë tjetër, me këngë në gojë e me opingat mbi tokën e tyre.

Në anën e majtë, drurët e pyllit më s'dalloheshin, ata sikur i shkriu muzgu dhe u bënë një mur i errët. Mos vallë në ndonjë skutë të tij ishte fshehur ai kriminelin, Sak Topanxha dhe priste me pushkë në dorë? E ç'do të bënte?

«Mund edhe të qëllojë. Kërkon të vrasë. Kë do të vrasë? Do vrasë kë të mundet dhe pastaj do fshihet në pyll. Ç'jam budalla kur mendoj kështu!...

Ngreu o popull punëtor!

Po sikur të vrasë të deleguarin, shokun Bexhet? E pse atë? Sepse ai erdhi e ndau tokat. Ç'turp do të jetë për ne të gjithë. Dhe shiko sa bukur dallohet. Ne të gjithë jemi me rroba të errta, vetëm ai ka xhakëtë të bardhë. Tamam si shenjë për t'u qëlluar. Kot mendoj gjëra të tilla. Pse do ta bënte këtë gjë, mos vallë që të shpëtojë tokat? Ato ikën e vanë. Mund ta bëjë nga inati ose që të përhapë panik. Po vërtetë, sikur ta qëllojë e ta vrasë? Çfarë shpërblimi i çuditshëm. Tokat na i ndau ne, kurse për vete mund të marrë një plumb».

Bexheti ecte përpara. Në muzg xhaketa e bardhë ndriçonte më shumë.

«Po si të veprojmë, si ta mënjanojmë rrezikun? A nuk do të jetë mirë t'i them: «Hiqe xhakëtën shoku Bexhet, sepse...» Ai do të qeshë dhe do të më përgjigjet: «Akoma s'të paska dalë frika nga agai ty, shoku i Komitetit të fshatarëve të varfër?» Jo, nuk do t'i them ashtu!

Bexheti ecte përpara dhe qeshte me gjithë zemër. Sigurisht Kozi po i tregonte ndonjë histori komike.

Një çast më vonë, Miçua i shpejtoi këmbët dhe i doli përkrah Bexhetit.

Po i afroheshin anës së pyllit të heshtur.

— Sikur më vjen ftohtë, — tha Miçua duke rru-  
dhur shpatullat. A do të më bësh një nder, shoku  
Bexhet?

— Urdhëro!

— Më ka hyrë një si e dredhur, sikur të më ja-  
pësh pak xhakëtën.

— Po për kaq gjë? Urdhëro e merre. — Bexheti  
e zhveshi dhe ja zgjati në dorë.

Para se ta merrte, Miçua e pyeti ngadalë:

— Po mos kësh ftohtë ti?

— Jo, jo, — i kundërshtoi Bexheti, — për mua  
mos ki merak. Kur ecën njeriu, nuk ftohet kurrë.

Kozi po shfrynte duke e shikuar Miçon me inat.  
Dhe më së fundi nuk ju durua:

— Ore Miço, ç'janë këto që po na bën? Pse s'na  
kërkon ne, po ju qepe shokut Bexhet?

— Për nder, Xha Kōzi, kjo më pëlqen më shumë.  
Të vesh edhe unë një herë një xhakëtë të mirë. Ato  
tuajat më shpojnë se janë me qime dhish.

— E, -si u bënë njerëzit! U plasi cipa fare! — u  
ankua plaku.

Ecnin njëri pas tjetrit dhe këmbenin më të rrallë  
ndonjë fjalë se shtegu vinte i ngushtë. Miço Sema ecte  
përpara. Hetonte me sy anën e pyllit dhe priste të dë-  
gjonte ndonjë krismë. E dinte fare mirë se, atë çast  
mund të plagosej, ose edhe mund të vritej, në qoftë se  
Sak Topanxha do guxonte të ngrinte dorën. Ishte i qetë  
dhe krenar. E dinte se po të binte, tani do të binte mbi  
tokën e re, të cilën sapo e kishin marrë nga pushteti  
e duke e ndjerë se kjo ishte një gjë me të vërtetë e  
madhe, çdo gjë tjetër i dukej e parëndësishme.

Ata e kapërcyen Bishtin e Dushkut dhe muarën  
rrugën e fushës. Në fshat daullja po gjëmonte nën dri-  
tën i pishtarëve si kushtrim lufte e gazi.

## NËNË E BIR...

Atë mëngjez të përcjelljes për në ushtri edhe teto Ollga doli si nënat e tjera të fshatit.

— Rekrutët, të gjithë në maqina! — urdhëroi oficeri.

Ata shpejtuan e hipën. Po njerëzit e afërm ju afruan maqinave. E me ta edhe Ollga Sheti.

— T'u rrit, Ollgë! — i tha një nga shoqet. — Krejt... krejt si Apostoli!

— Si drita, shyqyr! Veç pastë jetën e gjatë.

— Jetën e gjatë! Jetën e gjatë, moj korbë, se ti e di qysh e rrite!

Po tani teto Ollga as e kish mendjen tek ato që thuheshin për të... Ajo ja kishte qepur sytë të birit e i dukej si çudi që ai ja kishte arritur asaj dite! Me të vërtetë Gazmendi i saj ishte bërë burrë, burrë për të hedhur armën në sup, për të mbrojtur kufijtë e atdheut, për t'ju përgjegjur me zjarr çdo dhunuesi që do të prekte sadopak këtë tokë të shenjtë?

Dhe duke menduar kështu, nga gëzimi u përplot.

— Ç'ke, i tha rekruti i përkulur mbi parmak të karrocërisë së kamionit.

— Nga gëzimi, bir! Nga gëzimi! Ti po shkon. Shko! Vafsh e u kthefsh me shëndet. Veç kij mendjen të nderosh veten, nënën, katundin. Po dhe emrin e babajt, se qe njeri i drejtë që vuajti, punoi e vdiq me nder.

Po mbi të gjitha mos harro kush të rriti: mos harro atë që na ndihmoi e u kujdes për ne ato dit të vështira, atë që do na bëri me shtëpi e me tokë, atë që na u gjet në çdo çast! Dhe ti e di, kush është ajo, bir.

Dhe sërish, duke i mbajtur me zor ata lot të përcjelljes, u ngrit në majë të këmbëve dhe e puthi.

— Nënë! — tha ai i mallëngjyer. — Unë e di kujt klase i përkas. Ti të jesh e sigurtë se yt bir...

Po s'mundi ta plotësonte atë mendim.

— Gati për nisje! — urdhëroi oficeri që i printe atij karvani maqinash ushtarake.

Një zhurmë motorësh kumboi. Pastaj, autokolona lëvizi në tatëpjetën e asaj rruge malore.

— Gazmend!

— Lamtumirë dhe mirë u pafshim, nënë!

Pastaj duar e shami gjithfarësh u valvitën në erë, gjersa ajo autokolonë u zhduk në gjarpërimet e asaj rruge të vështirë, duke marrë drejtimin e kështjellës, (ku dikur kishte pasur qendrën e vet princeshë Argji-roja...) Që prej asaj dite, për disa muaj me radhë Ollga s'e pa më të birin. Vetëm ato letrat nga larg, të cilat i lexonte e i rilexonte shpesh, disi ja nxirrnin atë mall.

\* \* \*

Si çdo repart edhe kompania ku u caktua Gazmend Sheti ka historinë e vet.

— Ai që vendos fatin e fitores në luftë është njeriu! — u tha komandanti ushtarëve të rinj që porsa e kishin veshur atë divizë ushtarake. — Dhe ju e dini, kolektivi përbëhet prej njerëzish. Ai vepron si një organizëm. Po nëse një detaj i këtij organizmi nuk punon si duhet, ai dëmton gjithë organizmin. Pra, nëse ndonjë nga ne s'ecën në të njëjtin hap me kolektivin, ai kthehet në një plagë për të, në një pengesë për kryerjen e detyrës, në një barrierë në arritjen e objektivit. Me pak fjalë ai dëmton qëllimin.

Ushtarët, të heshtur, dëgjonin. E çdo fjalë ju ngulitej në mend. Po pas betimit ushtarak, atyre fjalëve secili filloi t'u jepte një kuptim më të thellë. Tani edhe përgjegjësia u dukej më e drejtpërdrejtë, më e rëndë.

Dhe ja, programi vjetor i stërvitjes filloi. Brezi i kalitjes u kthye në një shesh provash si në luftë të vërtetë. Por jo gjithkush në atë ndeshje arrinte t'ja dilte mbanë. Gazmend Shetit, i binin djersë. Ai s'po mundej t'i përgjigjej këtij brezi të vështirë. Sa keq! Po sikur t'i ndodhte kjo në luftë? A s'do të ishte një pengesë për shokët, për skuadrën, për kompaninë?

— Turp! — thotë më në fund me vete dhe sytë i shkrepëtinjë. Fytyra i ndizet, i skuqet si prush, si flakë.

Dikush e vë re.

— Mos u mërzit, Gazmend! Shpejt do të kalitësh si të gjithë.

Njeriu që i flet është një nga ushtarët e vjetër. Ai e ka kaluar këtë kalvar. Dikur edhe ai nuk e pati aqë të lehtë kalitjen në atë brez.

— Më beso, unë e pata shumë më të vështirë se sa ti në periudhën e parë!

Gazmend Sheti nuk flet; ai hesht, po fytyra i bëhet flakë, prush. Në orët e lira, edhe diçka tjetër ndodh me të. I zymtë e i heshtur gjithnjë hiqet mënjanë.

— Duhet mbajtur afër! — mendon komandanti me shqetësim dhe kërkon midis ushtarëve që lodrojnë. Por s'e shikon! Pyet, por asnjë s'di t'i thotë se ku është. Edhe të nesërmen e të pasnesërmen, po kjo punë. Përsëri askush s'di t'i thotë se ku mund të jetë. E kërkojnë, po asnjë s'e gjen.

— Ku ishe? — i thotë në mbrëmje komandanti hijerëndë.

— Këtu, shoku komandant. — Dhe, i zymtë hesht e bëhet gati të zbrapset.

— S'është mirë që u rri shokëve larg! Pastaj, tek e fundit, thuaj ku je, që të dimë ku të të kërkojmë. Ja, mua m'u deshe pardje, dje dhe sot... Por...

Gazmend i skuqet dhe hesht.

Po të nesërmen prapë po ajo punë.

Dhe ja, çështja e tij fillon të bëhet problem për kolektivin.

Komandanti mendoi ta kontrollonte në kohën e lirë, dhe kështu bëri. Heshtaz u largua. Po dhe Gazmend Sheti, hashtaz e pa u ndjerë, ju shkëputet shokëve të vet. Po këtë herë s'ka mundur t'i shpëtojë syrit të të gjithëve. Dikush e ka parë, dikush po e ndjek.

— Ku do të shkojë!

Dhe ja, ai përpara e komandanti pas, bëjnë për-pjetë.

Ushtari qëndron. Ai porsa ka hyrë në brezin e kalitjes.

— Ç'kërkon të bëjë? — mendon tjetri që nga larg.  
— Përse u ndal?

Gazmend Sheti, i heshtur, fillon të stërvitet. Ja edhe teleferiku, që shpesh e kishte bërë të skuqet para shokëve dhe eprorëve ushtarakë.

— Duhet kaluar me çdo kusht! — thotë me vete. Dhe provon... Por rrëzohet, ngrihet dhe prapë rrëzohet, gjersa më në fund kalon. Disi me druajtje, por kalon.

— Duhet përsëritur! — thotë me vete dhe, përsëri e përsëri kalon nëpër atë kalvar të vështirë. Tani, më i qetë sa më parë, pa të marra mendsh, më shpejt, më lehtë.

Dhe komandanti, i strukur në zabel, e vështron. Ai ngjethet nga emocioni. Kurse ushtari i ri, disi i çliruar nga ankthi i atyre ditëve, çelet për një çast. Tani s'i pritet gjer të vijë e nesërmja. Ai, përkrah shokëve, do të tregojë se është i denjë për t'i qëndruar kolektivit përkrah. Po sikur nesër t'i merren mendtë! Po sikur nesër, nga druajtja, prapë të mos ja dalë tej? Po sikur... sikur...

Dhe prapë e kalon dhe e rikalon atë kalvar.

Tani më shpejt, më i qetë, më i sigurtë.

— Të lumtë! — Të lumtë! — dëgjon një zë nga shkoretë përballë.

Ai? Komandanti i tij?

— Më qenka vënë nga pas? — thotë me habi.

Po tjetri, duke ju afruar, e përqafoi, e puth.

Ushtari, dhe oficeri provojnë të njëjtin emocion. Të heshtur, me vështrimet që xixëllojnë, shikojnë njëri-tjetrin ndër sy.

— Enigma u zgjidh! — tha oficeri Jordan Krati dhe, me t'u kthyer, u tregoi ushtarëve se ku e gjeti Gazmend Shetin, se ku i kalonte orët e lira ai.

Të tjerëve u erdhi keq që kishin menduar keq për të.

— Më ndje! — i tha një nga shokët e rinj. — Unë isha përgatitur të të kritikoja rëndë, kurse ti, në këtë kohë, po hapje një rrugë të re për të gjithë ne që jemi fillestarë si ti... A s'do të ishte mirë të të ndiqnin në këtë shembull?

Dhe heshti.

— Përse hesht? — i tha një tjetër. — Çoje mendimin gjer në fund.

— Unë e thashë fjalën time, — tha parafolësi. — Gazmend Sheti ka ecur më përpara se shumë prej nesh. Të ndjekim shembullin e tij! Kjo është fjala, dhe ky është propozimi që kam.

Pastaj një zë u dëgjua.

— Edhe unë e përkrah këtë mendim.

— Edhe unë.

— Edhe unë.

Dhe shembulli i Gazmend Shetit u kthye në një iniciativë revolucionare. Kolektivi eci përpara shpejt. Por ai që e kapi i pari atë majë, atë kuotë që Gazmendi.

I entuziazmuar, komandanti e përqafoi.

— Sedra dhe ndërjegjija, — i tha para kolektivit — ja, dy krahët e ngjitjes sate të sigurtë, Gazmend! Me krahë të tillë cilido ushtar mund të kapë çdo majë, çdo kuotë...

\* \* \*

Që i papritur ai kthim. Ushtar Gazmend Sheti, me pushkën në krahë po hynte në fshat.



— Ollgë! Ollgë, moj! thirri një grua me ta parë djaloshin nga larg. — Gazmendi po vjen!

Dhe e para, teto Lenka, që i ishte gjetur aq shumë në të vështira Ollga Shetit, u derdh dhe e puthi ushtarin me mall.

Pastaj edhe e ëma duke i dalë krahëhapur përpara.

— Po nga u hapën këto udhë, more bir?

Ai qeshi dhe, i përmalluar, e pushtoi t'ëmën si dikur.

— Më dërguan me leje, — tha. — E dinin që ty të kishte marrë malli fort! Dhe komanda... ja...

Ajo e kuptoi shakanë, po prapë e lumtur, s'dinte si ta shprehte atë gëzim. Pastaj lajmi bëri bujë e shtëpia e Ollga Shetit u mbush plot e përplot.

Kështu kaluan ato orë e kur gjindja u largua, nënë e bir u çmallën pranë vatrës duke biseduar gjer në të gdhirë.

— Çudi! — tha Ollga Sheti e stepur habie. — Sa shpejt u gdhi kjo natë!

Dhe vërtetë ato orë kishin kaluar pa u ndjerë.

\* \* \*

Tamam si ditët më të bukura të pranverës që edhe ajo ditë e 11 shtatorit të atij viti. Dallëndyshet ende s'ishin larguar e blerimi ende e mbulonte tej e tej atë faqe mali të pyllëzuar.

— Sa vend i bukur! — i tha Gazmendi s'ëmës.

Sado nënë e bir, ata bisedonin sikur të ishin shokë me njëri-tjetrin. Ajo ishte në parti qysh në vitet e para mbas çlirimit, dhe edukatës së të birit gjithnjë i kishte dhënë një kujdes të veçantë. Ollga Sheti donte që ai të bëhej njeri i hapët, i drejtë e guximtar në mbrojtje të së vërtetës. Dhe ai mundim nuk i kishte shkuar kot. Shokët përgjërroheshin për Gazmendin e saj. Po ashtu dhe fshati.

Dhe ja, duke punuar pranë e pranë, të qetë e të gëzuar, nënë e bir po bisedonin rreth çështjeve të tyre

të ditës. Gazmendi e pyeste e nëna përgjigjej. Kështu, pak nga pak fjala hapi fjalën e biseda e tyre nga çështjet e fshatit e të shtëpisë kaloi te shkolla e te librat.

— Sa keq! — tha djaloshi — kur isha unë nxënës, këtu kishte vetëm shkollë fillore, kurse tani fshati ka shtatëvjeçare e ata që mbarojnë, me lehtësi mund të vazhdojnë edhe të mesmen.

Nëna buzëqeshi.

— Me të vërtetë, ashtu është. Po ti prapë je i ri e dyert i ke të hapura.

Tjetri s'foli.

— Përse mendohesh? — tha gruaja, duke e shikuar ëmbël të birin.

— Si të them, — tha djali, — edhe ushtria është shkollë. Edhe aty, krahas pregatitjes ushtarake, merr edhe kulturë. Po kur shkon i mësuar është ndryshe. Atëherë edhe shërbimin mund ta kryesh më mirë, edhe puna jote zë vend e mund të duket më shumë. Pra, mund t'i gjendesh e t'i shërbesh më shumë kësaj toke, ku, siç thotë Çajupi: «Balta na duket më e ëmbël se mjalta». Dhe s'di pse s'më hiqet nga mendtë ajo vjershë e tij. Ndoshta se më kujton babanë... A të bie ndër mend ajo letra e fundit e tij që na dërgoi nga kurbeti?

— Po, — tha gruaja. — Veç më vjen keq që s'e pa të lirë këtë dhë e s'të pa e s'të gëzoi as ty.

Djali psherëtiu. Pastaj, të dy, nënë e bir, ranë në heshtje. Dhe ja, pikërisht në këto çaste, buzë pyllit, ndonjë kilometër larg atij brezi kufitar, të dy, nënë e bir panë dy njerëz që kishin qëndruar e, si me druajtje, po mundoheshin të vëzhgonin rreth e qark.

— Cilët do të jenë ata të dy në këtë zonë të ndaluar për civilat? — tha djaloshi nëpër dhëmbë.

— U dukërkam zotërinj nga veshja! — tha gruaja dhe menjëherë u bë gati të çohet më këmbë.

— Prit! Prit! Në asnjë mënyrë s'duhet t'u tërheqim vëmendjen! — tha ushtari i prerë dhe me bishtin e syrit hodhi vështrimin andej, pa ju rënë në sy të dy «civilëve» gjysmë të fshehur pas trungjeve të atyre pemëve.

Por njëri prej tyre dyshoi e, duke u zmbrahur, filloi t'i hynte pyllit. Pastaj edhe tjetri.

— Shihi! Shihi! — tha djali duke e humbur të parin nga sytë.

Gruaja, nga hutimi, kishte ngrirë, po shpejt e mblo-dhi veten.

— Gazmend, — tha, — në mos më gënjejnë sytë, ky i dyti po më duket krejt si Nuri Andoni.

Dhe ky Nuri Andoni ishte kulaku, që ja kishte nxirë jetën familjes së Olgës para çlirimit; Nuri Andoni ishte ai katili, që mori arratinë kur erdhi në fuqi populli. Dhe ende si kishte dhënë llogari këtij populli.

Gazmendi i dinte këto. Prandaj ja bëri me habi:

— Si! Pas kaqë vjetësh të ndodhë një gjë e tillë? S'më besohet.

— S'e di, — tha gruaja, ende e hutuar, — po sido që të jetë, a të shkoj t'u kërkoj pasaportën dhe lejen për qarkullim të organeve të kufirit? — dhe në çast mori urysh për t'u ngritur.

— Jo, — tha djali me një theks të prerë, — unë po vrapoj të marr pushkën në shtëpi për çdo të papritur, kurse ti, pa u rënë në sy, vëzhgo nga do të mbajnë.

— Mirë, bir! Si të mendosh ti! — tha ajo e push-tuar nga një emocion i paprovuar ndonjëherë në jetë.

Pas këtyre fjalëve, si njeri në hall të vet, i lodhur e i këputur nga puna, Gazmend Sheti i ktheu krahët luginës e asaj korijes ndën breg. Dhe ashtu, ngadalë eci gjersa ju zhduk edhe sëmës nga sytë.

— Tani po! — tha me vete — tani s'mund të më vëzhgojnë! — dhe në pikë të vrapit, duke marrë të tatëpjetën, ja dha drejt shtëpisë.

Po dhe Ollga Sheti, me ballë nga korija ishte ngritur e po mihte me shatë. Punonte, po mendja e zemra i rrihnin gjetkë. Nuri Andoni s'i hiqej nga sytë.

Dhe duke mihur, me bisht të syrit, s'ja ndau vësh-trimin korijes përballë. Por ja, përsëri një lëvizje, një zhurmë. E pastaj një siluetë njeriu. Po këtë herë, jo Nuri Andoni.

— Edhe ai, me siguri aty pranë do të jetë! Ah, kur s'i thashë Gazmendit që t'i dilte korijes që matanë e t'u delte mbi breg. Ashtu do t'i kishte ndën vete... do ta kish më të lehtë!

Dhe prapë e shqetësuar, mendon. Po as dorën nuk e ndal. Sipas porosisë s'duhet të bjerë në sy se po i vëzhgon.

Po dhe nga korija dikush po e ndjek në çdo hap që bën, në çdo shatë që hedh.

Dhe tani, jo një, po dy njerëz të rrasur pas trun-gjeve janë ngritur më këmbë. Sytë e tyre janë mbër-thyer mbi të. Dhe ajo i kap ata vështrime, i dikton.

— E qartë! — thotë dhe zemra i rreh me ankth. — Po Gazmendi, pse u vonua kaq fort! Ah, që s'i tha-shë t'u delte që lart! Po njeri tjetër a do të ketë mundur të lajmërojë, vallë? Po sikur...

Po s'arriti ta çojë gjer në fund këtë mendim. Një luftëtar i armatosur u duk mbi qafë. Pas tij edhe katër të tjerë me shata e sopata siç ishin gjetur në arë. Të pestë po vrapojnë.

Dhe teto Ollga çelet në fytyrë. Sido që të ndodhë, i biri do të ketë përkrah edhe të tjerë. Po i armatosur është vetëm ai. S'ka gjë! Prania e të tjerëve i duket sikur i jep edhe më shumë kurajë, sikur ja forcon edhe më shumë atë besim.

Dhe ajo, ngadalë, zbrapset e i del korijes në krah. Tani mund t'u bëjë edhe shenjë.

Dhe korija rrethohet më çdo anë. Pastaj, një prej të pestëve, afrohet në drejtim ku janë strukur «miqtë».

— Ej, Nuri Andoni, dorëzohu!

Dy burrat të zbetë, duke gatitur automatikët, bëhen gati të çajnë përpjetë. As tre kilometra s'i ndajnë nga ajo piramidja, ku në terr e në fshehtësi të plotë kaluan disa orë më parë, para këtij agimi «famëkeq». Po kush i pa e i diktoi? Ata arritën gjatë natës në këtë cak. Koloneli, që i përcolli, u tha se do t'i prisnin atje dy patriotë të tjerë, miq të tyre të vjetër që s'i kishin humbur lidhjet kurrë. Ai u dha edhe emrat e tyre edhe

parullën e kundraparullën për t'u njohur me shoqi-shoqnë. Pra, çështja kishte themel të fortë. Dhe Nuri Andoni i njihte mirë, i kishte miq e rreth familjar.

Pra, kjo që ishte përgatitur ndryshonte nga gjithë ato të herëve të tjera. Po «patriotët», që do t'i prisnin në këtë koriqe, pse s'po dukeshin gjëkund? Kurse zëri, përsëri gjëmoi:

— Dorëzohuni! Përndryshe lumi ju pret!

Po këtë radhë, më pranë se herët e tjera.

Dhe ja, njeriu me pushkë, po u shkante drejt.

— Qenka i vetëm! — tha Vasil Temini dhe e vuri në shenjë.

Po Nuri Andoni s'e la.

— S'na leverdis të hapim zjarr! — tha i prerë. —

Ne duhet të çajmë sa s'është vonë. Për fat të mirë, kreshta është e mbuluar e gjitha me dushk e dëllinjë. E kjo mbulesë shkon deri në brezin kufitar.

Pastaj, me automatikë nëpër duar, të dy burrat vrapuan përpjetë.

Po këtë radhë theksi urdhëronjës i atij zëri qe edhe më i prerë.

— Për të fundit herë, Nuri Andoni. Ndal, po të them! — Dhe pushka automatike e Gazmend Shetit shkrepiti zjarr. Njerëzit që po ngjiteshin ndjenë fishkëllima plumbash rreth e qark. Po ushtari s'don të qëllojë drejt. Ata kanë hesape për të larë, kanë sekrete të shërbimit të fshehtë grek... Ata duhen kapur gjallë.

Dhe kjo brengë e mundon.

Po në këtë çast, rreth korijes edhe zëra të tjerë gjëmojnë. E midis tyre edhe një zë gruaje:

— E ke kot, Nuri Andoni! Kësaj dare, as dreqi nuk i del dot! Jam Ollga Sheti në më mban mend.

Tjetri shtang e, si në ekran filmi, gjithshka i shkon nëpër mend.

Po Vasil Temini dridhet me tmerr.

— Mbaruam! — i thotë shokut që po vrapon.

Tjetri e shikon egër dhe urdhëron të zërë vend. Pastaj, tre automatikë ndizen më të dy krahët. Vasil

Temini hesht i pari. Një plumb e ka marrë në ballë, pa e lënë të luajë vendit nga pozicioni i tij i fillimit.

Po dhe mbi dorën e majtë të Gazmend Shetit, një rrëkezë e ngrohët ka filluar të rrjedhë teposhtë e të lagë dheun aty qark.

— U plagosa, — thotë — po krahun akoma mund ta lëviz. — Duhet shpejtuar sa s'më është mpirë.

Dhe prapë shkëmbehen pushkë midis ushtarit dhe armikut, që ka ardhur nga larg. Gryka zjarresh ndizen në të dy anët.

Po Nuri Andoni turfullon:

— Vasil! Shtjerë po të them! — i akërohet shokut.

Dhe priti:

— Ljepur! — tha me vete dhe përsëri u bë gati ta kërcënonte.

Po tjetri, i mbuluar në gjak, larg atij kolonelit që i përcolli me aqë bujë heshtte i qetë. Dhe ajo heshtje që fliste e tmerroi. Ai kishte mbetur tek.

— O perëndi! — tha dhe, duke u ngritur shpejtoi drejt majës së asaj kreshte të mbuluar me dushk e dëllinjë.

Po për krah tij, duke i thirrur: «Ndal! Dorëzohu!» shkoi edhe Gazmend Sheti. Si qitës i shkëlqyer në nënrepartin e tij, ai e kishte të sigurtë po ta vinte në shenjë. Por ja, të parin e vrau. Të paktën, të dytin ta kapte të gjallë. Nuri Andoni s'ishte një diversant i thjeshtë. Dhe ai këtë e dinte mirë.

— Po i dal anash! — mendoi.

Dhe ja, të dy vrapojnë. Duket sikur përpiqen kush e kush të arrijë më parë në atë majë. Janë krejt në një vijë të drejtë. Dhe maratona vazhdon:

— Tani po! — thotë ushtari i qetë dhe e ve në shenjë, ashtu sikurse në poligon, në ato ushtrimet e qitjes me automatik lart poshtë, kundër objektivit që shfaqet tri herë nga dhjetë sekonda, ose kundër dy vrapuesve në lëvizje e në ndalesë në largësi 200 e 300 metra. Po objektivi në ato ushtrime s'ishte as sa çereku i trupit kaba të Nuri Andonit, e as largësia. Tani ata

s'i ndanin gjithë-gjithë as 50 metra largësi. E në atë gjendje, duke qenë plotësisht i sigurtë për rezultatin, ushtar Gazmend Sheti vuri në shenjë vrapuesin në lëvizje. Po këtë herë në pjesën e poshtme të trupit të tij. Pastaj, një batore gjëmoi korijes dhe, vrapuesi i goditur kofshë më kofshë, u përmbys më hundë drejt një dëllinje përballë. E në atë rrokullisje, edhe automatiku i mbeti varur mbi një degë, kurse një tjetër, gati për zjarr po i qëndronte mbi kokë.

I hutuar, ai u drodh e ngriti duart përperjetë. Por megjithatë akoma s'i besoj, akoma i dukej si ëndërr ajo që kishte ngjarë.

— Mos u çudit, — i tha djali i qetë, — s't'ë vrava se ke hesape për të larë. Këta që shikon duke rendur drejt pyllit shpesh të kujtojnë... Edhe Ollga Sheti midis të tjerëve. S'besoj ta kesh harruar, Nuri bej!

— Po si quheni ju, që më njohkeni kaq mirë? — tha i ardhuri i shtangur habie.

— Ushtar! — tha djali.

Pastaj një mori njerëzish ja behën. Midis tyre edhe Ollga Sheti që kishte rendur në pikë të vrapit. Po turma s'po e linte ta shihte të birin. E në atë grumbull, befaz, një zë gruaje dëgjoi:

— «Gazmendi! Gazmendi! Sa keq qenka përgjakur!» U drodh e, me bërryle, duke çarë përmes njerëzve, doli në krye. I biri, më këmbë, me pushkën gati, akoma i qëndronte mbi kokë Nuri Andonit.

Ajo e pa drejt. Pastaj, duke ju kthyer gruas, që kishte thirrur e pikëlluar, i tha me qortim:

— Mos u trondit, Lenkë! Ai bëri detyrën. Se dhe gjaku dhe jeta e djemve që rritëm i përkasin këtij vendi! — dhe duke ju afruar të birit i buzëqeshi.

— Gazmend, — i tha. — Sot fshati ka festë, po nëna jote ka dyfish festë. Të falem nderit bir! — dhe e qetë, duke grisur një pjesë të atij burullukut të bardhë që mbante në krye, i lidhi plagën.

— Edhe unë, të falem nderit, nënë! Ne u ndodhëm dhe luftuam së bashku në një front. Dhe këtë s'kam për ta harruar kurrë.

## QYTETI QË KISH HUMBUR QETËSINË

Shkrimtari Andon Treshiti vendosi ta kalojë lejen krijuese në qytetin N., ku banonte tetoja e vet. Ajo kishte një shtëpi të vogël e të veçuar, me kopsht plot lule e pemë. Andoni kishte dhjetë vjet pa vajtur atje. Herën e fundit kishte kaluar te tetoja dy javë, që ende i kujtonte me kënaqësi. Qyteti ishte i vogël, i bukur dhe shumë i qetë. Edhe në verë, kur në Tiranë vapa është e padurueshme, atje bën fresk, se qyteti N. është në këmbët e një mali të lartë, hijerëndë, sipër të cilit në netët e qeta del hëna si një sy i madh, i çuditshëm.

Andoni kishte nisur të shkruajë një roman dhe brenda dy muajve kishte hedhur në letër vetëm kapitullin e parë. Puna në zyrë, mbledhjet, zhurma e qytetit të madh nuk e kishin lënë të punojë sa duhet. Atje te tetoja mund të punonte i qetë, pa e trazuar njeri.

Ditën që do të nisej u zgjua shpejt dhe doli nga shtëpia një orë para se të nisej autobusi. Eci ngadalë nëpër rrugët plot zhurmë të qytetit duke shikuar njerëzit, fëmijët e kopshteve që çapitnin të zënë dorë për dorë njëri pas tjetrit, pemët dhe ballkonet me lule.

Kur u nis autobusi, atij për një çast i erdhi keq që po largohej nga Tirana tani në pranverë. Po kur autobusi la pas qytetin dhe u sul nëpër shiritin e zi të asfaltit, në mes kodrash të bleruara, fushash me bar



të njomë, atë e rrëmbeu bukuria e natyrës së zgjuar dhe harroi çdo gjë.

Kur hynë në qytet, kishte rënë nata. Sa vuri këmbët në tokë, ju duk se kishte ardhur në një qytet të panjohur. Në shesh kishte disa ndërtesa të reja trikatëshe, që ai nuk mbante mend të kishin qenë më parë. Sheshi ishte i asfaltuar dhe me drita. Ai hodhi në sup pardesynë, rrëmbeu nga toka valixhen dhe u nis për në shtëpinë e tetos.

Kur hapi derën, në fillim ajo nuk e njohu. Pastaj ju hodh në qafë, i mori valixhen nga dora dhe e futi brenda. Tetoja ishte një grua që sa i kishte kaluar të pesëdhjetat. Ishte trupshkurtër, me flokë të thinjura e të mbledhura pas zverkut. Kishte sy të mëdhenj, të rrumbullaktë që shikonin plot ëmbëlsi dhe gishtrinjë të gjatë, me ngjyrë të zbetë dhe nervozë. I shoqi i kishte vdekur para shumë vitesh dhe ajo jetonte vetëm me të birin që tani ishte ushtar. Punonte si rrobaqepëse në kooperativën e artizanatit.

Atë natë Andoni nuk fjeti mirë, megjithëse ishte i lodhur. Kështu i ngjante gjithnjë natën e parë kur ndërronte shtratin. I doli gjumi disa herë dhe u përpëliti nëpër shtrat deri në orët e vona. Vetëm ndaj të gdhirë e pushtoi një gjumë i ëmbël.

U zgjua pas orës gjashtë.

— Si fjete? — e pyeti tetoja kur e pa që doli nga dhoma. Ajo po nxitonte, prandaj shtoi pa marrë parëgjigje — Unë po iki se u bëra vonë për në punë. Qumështin e ke në zjarr, po më parë ulu e pi kafënë. Edhe një gjë tjetër: Po dole nga shtëpia, mos harro ta mbyllësh derën me kujdes.

— Nuk është nevoja të ma thuash, teto... Pse ç'u bëra unë? — i tha buzagaz Andoni.

— Eh, mor bir, ju njerëzit që shkruani... — tha ajo duke tundur kokën e thinjur.

Nuk e mbaroi fjalën, por i vuri përpara filxhanin me kafënë që avullonte, pastaj hapi derën dhe doli në kopsht me hap të shpejtë. Nga dritarja e sallonit An-

doni e pa duke këputur një trëndafil të kuq të njomur me lotët e natës, pastaj tek kapërceu prakun dhe u zhduk në cepin e rrugës.

— Tani është koha të nis punën — tha Andoni pasi hëngri. E ndjente veten të çlodhur dhe një dëshirë e zjarrtë për të shkruar i vlonte përbrenda. U ngrit dhe shkoi e mori dosjen me dorëshkrimin. Doli në kopsht dhe u ul në një tryezë druri të palatuar nën një plep të lartë plot gjethe fëshfëritëse.

Nuk kishin kaluar as dhjetë minuta, kur para shtëpisë qëndroi një kamion duke gulçuar rëndë. Andoni e la lapsin. Kamioni nuk kaloi tutje, por u ndal aty dhe shoi motorin. U dëgjuan disa zëra që nisën të thërrasin, pastaj një zhurmë e rëndë. Andoni u ngrit, ju afrua parmakut të kopshtit dhe hodhi sytë jashtë. Atëherë e kuptoi si ishte puna. Përballë shtëpisë së tetos po ndërtohej një pallat i madh katërkatësh. Disa punëtorë po shkarkonin tullat nga kamioni. Ndanë pallatit ishte ngritur një kullë e drunjtë dhe mbi të një vinç. Andoni ngriti kokën i habitur. Kati i tretë kishte mbaruar dhe muratorët po ngrinin muret e të katërtit. Andoni dëgjoi një murator duke kënduar atje lart. Mbi kullën e drunjtë një burrë i shkurtër bënte lëvizje me duar dhe i thërriste një djali që rrinte poshtë.

Andoni qëndroi ashtu i rrëmbyer, duke vështruar nga çdo anë pallatin që ndërtohej dhe lëvizjet e shpejta të punëtorëve. Para hyrjes ai pa dy gra me kominoshe e me çizme, që përzienin llaçin dhe një vajzë të re me trup të imët që hidhte ujë në një gropë, në mes të llaçit.

— Sill ujë, Fatime — i thirri njëra nga gratë.

— Bidonat nuk kanë më — përgjegji vajza.

— Shko dhe mbushi — tha tjetra duke u mbështetur te lopata.

— Tani do të shkoj — tha Fatimja.

Rrëmbeu dy bidona të mëdhenj dhe u drejtua nga dera e kopshtit të tetos së Andonit.

— A mund të mbush pak ujë te pusi? — i tha

vajza Andonit duke e vështruar me habi, pasi e shihte për herë të parë.

— Mbush sa të duash, moj vajzë — tha ai dhe shtoi me buzë në gaz — uji është pa para.

Vajza qeshi me zë të lartë. Pastaj kapërceu prakun, ju avit pusit dhe hodhi kovën brenda.

— Për çfarë bëhet kjo shtëpi? — e pyeti Andoni duke u shkëputur nga parmaku dhe duke i vajtur pranë.

— Për banim — përgjegji ajo shkurt dhe tërhoqi me forcë litarin.

Andoni e vërejti me kujdes. Ajo kishte veshur një palë kominoshe pak të mëdha për trupin e saj të imët. Në këmbë kishte mbathur çizme. Flokët i kishte të mbledhur prapa. Kishte një fytyrë të rrumbullaktë, të rreshkur, sy të gjallë dhe duar të mëdha e të fuqishme që nuk ishin në përpjestim me trupin.

— Sa vjeç je? — e pyeti ai pas pak duke e shikuar me admirim.

— Nëntëmbëdhjetë — përgjegji ajo.

— Ke kohë që punon?

— Gati një vit.

— Me këtë punë merresh? — e pyeti prapë ai pas një heshtjeje të shkurtër.

— Tani për tani po. Unë dua të bëhem muratore, por përgjegjësi i këtij objekti thotë se nuk ka vende për muratore dhe se kjo nuk është punë për gra. Unë kam folur me inxhinierin e ndërmarrjes dhe ai më ka dhënë fjalën se kur të nisë objekti i ri, do të më verë të punoj si muratore, pasi të kem bërë edhe një kurs.

— Të pëlqen të bëhesh muratore?

— Shumë. Ajo është punë e mrekullueshme.

Vajza mbushi dy bidonat dhe u nis të delte. Duke e parë, Andoni u habit si mund t'i mbante ajo vajzë aq e re ato dy bidona të rëndë. Por atë e habiti më tepër diçka tjetër: shpirti i çiltër i asaj vajze punëtore, që ëndërronte të bëhej muratore e të ndërtonte shtëpi, shkolla, fabrika...

Mbeti disa çaste palëvizur në vend, duke rrahur

mendime të ndryshme, pastaj ju afrua me hapa të ngadalta tryezës së vogël. Dorëshkrimi ishte i hapur dhe mbi të qëndronte lapsi i tij i verdhë.

«Më mirë po shkoj të punoj në bibliotekë» tha me vete.

Mbylli derën me kujdes dhe doli nga kopshti. Kur kaloi pranë grave që përzienin llaçin, shikoi Fatimen. Pasi i kishte hedhur ujin, ajo përziente llaçin me lopatë. Një tufë flokësh i binin mbi ballin që i ndrinte nga bulëza të vogla djerse. Kur ai i kaloi pranë, ajo nuk e vuri re.

I kredhur në mendime, Andoni përshtoi rrugën dhe doli në shesh. Nga sheshi i vjetër që ai mbante mend, pothuajse nuk kishte mbetur asgjë. Ai ishte zgjeruar dhe rrethuar me shtëpi të reja, dyqane me vitrina të mëdha, salla e kinoteatrit dhe pallati i organizatave.

Biblioteka ishte e qetë. Në sallën e leximit ai gjeti vetëm një plak, që po lexonte gazetën duke lëvizur pareshtur buzët e pa nxjerrë zë.

Zuri vend në një cep dhe hapi dorëshkrimin.

Pas pak, nga dritarja e hapur u dëgjua përsëri buçima e fuqishme e një motori. Pastaj me buçimën u përzie zëri i trashë i një burri që thoshte diçka.

Andoni ngriti kokën, hodhi sytë jashtë dritares dhe shikoi plakun. Ai nuk e kishte prishur terezinë dhe po lexonte i qetë gazetën duke i lëvizur buzët pareshtur.

Jashtë zhurma sa vinte shtohet.

— Mor xhaxho — i foli plakut.

Ai nuk e dëgjoi. Andoni thirri më fort. Atëhere plaku ngriti kokën dhe e shikoi.

— Çfarë po ndërtohet këtu përballë bibliotekës?

— Si the? — e pyeti plakun.

Andoni ja përsëriti pyetjen.

— Fabrika e niseshtesë — përgjegji atëherë ai me zë të lehtë, saqë Andoni mezi e dëgjoi.

Shkrimtari vuri buzën në gaz. Pastaj u ngrit dhe mblodhi faqet e porsahapura të dorëshkrimit.

Para se të largohej ju kujtua diçka. Shkoi pranë

tryezës ku rrinte nëpunësja e bibliotekës dhe e pyeti:  
— Moj shoqe, a është akoma ajo kafeneja në të dalë të qytetit?

— Cila kafene? — përgjegji nëpunësja, një vajzë e ngjallur dhe me gërsheta të shkurtëra.

— Ajo kafeneja rrëzë malit — u mundua t'i shpjegonte Andoni. — Ai vend më duket se quhej Guri i Verdhë. Hë, a është më?

— Tani e kuptova. Jo, nuk është më. Aty është ndërtuar një gurorë e madhe, bile thonë se është gjetur edhe mermer.

Duke ecur nëpër rrugët e qytetit me dorëshkrimin në duar, Andoni e harroi fare punën e vet dhe gjithfarë mendimesh i vlonin në kokë. Atë e habitnin shumë ndërtimet në qytetin e vogël. Kudo vlonte puna dhe ngriheshin ndërtesa të reja dhe fabrika. Papandehur atij ju kujtua Fatimeja, me sytë e saj të gjallë, me duart e fuqishme dhe vuri buzën në gaz.

Teksa ecte ashtu i kredhur në mendime, dëgjoi që dikush e thirri nga prapa. Ktheu kokën. Disa metra pas tij, pranë autobusit, ishte Arqileja.

— Tungjatjeta — e përshëndeti Andoni, i gëzuar që gjeti një të njohur — Ç'kemi, shoku gazetar, nga vjen kështu?

— Nga Korça. Po ti ç'bën këtu?

— Kam marrë lejën krijuese dhe po e kaloj këtu tek tetoja.

— Ke shkruar gjë?

— Mbrëmë kam ardhur, por me sa shoh nuk do të shkruaj shumë.

— Pse?

— Nuk e ke vënë re sa është ndryshuar ky qytet i vogël? — e pyeti Andoni.

— Po, ka ndërruar fare fytyrë, — përgjegji gazetari, pa e kuptuar mirë ku donte të dilte Andoni.

— Këtu, që thua ti, është shumë zor të gjesh një qoshe të qetë për të shkruar ditën.

— Atëherë ndërro orarin e punës.

— Ashtu kam menduar. Do të punoj natën.  
U dëgjua boria e autobusit, që ftonte udhëtarët të hipnin.

Arqileja u përshëndet me Andonin dhe zuri vend brenda, aty pranë xhamit.

Teksa Andoni nisi të largohej, gazetari nxori kokën nga dritarja dhe e thirri:

— Andon, na shkruaj një reportazh për gazetën tonë kushtuar qytetit N.

— Do të shkruaj me gjithë qejf — përgjegjji Andoni dhe pas pak shtoi — Dhe që tani mund të të them çfarë titulli do t'i vë.

— Ma thuaj.

— «Qyteti që kish humbur qetësinë».

Autobusi u nis duke lënë pas vetes një re të bardhë pluhuri.

### LUGINA PËRCJELL JEHONËN E JETËS

Më në fund maqina ndaloi. Kishim ecur katër orë të mira nëpër male e pyje. Rruga, si rrugë e re, ishte e vështirë dhe e lodhshme. Ato vise para disa vjetësh i kisha shkelur me këmbë. Atëhere as që më shkonte ndër mend se në këtë mëngë të thellë do të vija një ditë me maqinë. Gjithë vendi rreth e qark, më të djathtë e më të majtë të burimit të lumit, ishte krejt i pabanuar. Fshatrat e dy krahinave janë përmatanë shpatëve të maleve. Prej shekujsh, mbase, gjithë kjo mëngë ishte djerrë e pashkelur dhe e pakullotur. Natyra ishte aty zot. Drurët qenë rritur si të hazdisur, që buzë ujërave gjithë shkumë gjer në majat e maleve. Njerëzit e dy krahinave asokohe e shkelnin atë vend vetëm një ditë në mot, ditën e shën Joanit. Vinin nga ishin e takoheshin në manastirin e vjetër. Aty përziheshin ngjyrrat e kostumeve të dy krahinave me vallet e lutjet nën tingujt e pizgave, e zileve e të kambanave të shën Joanit, që fillonin të binin qysh një ditë më parë, binin e ndillnin njerëzit, binin tri ditë me radhë dhe njerëzit vinin palë-palë, kaluar e më këmbë, me kalamaj të sëmurë ndër djepa e deshiny të lyer me bojëra. Vinin të lodhur nga rrugët e largëta dhe iknin po të lodhur nga netët e pagjumë. Vinin e iknin, iknin e vinin nga moti në mot me shpresë se fëmijët do të shëroheshin

e deshijtë do të shtoheshin. Vinin dhe kur ikin thonin se s'do të vinin më, po me të dëgjuar këmbanat e shën Joanit vinin përsëri. Tingujt e kambanave i përcillnin fletët e aheve gjer majë malit, pastaj era i rrëmbente ata tinguj e zbriste nëpër shtëpitë e nëpër kullat e fshatrave, që nxirrnin çatitë pranë shkëmbinjve, buzë arave të vogla sa një tepsi. Pastaj një mot të tërë jeta zvarrisej e plogësht dhe e lodhshme, e rëndë dhe e mërzi-shme, pa një ditë gazi, pa një ditë të bukur. Dhe njerëzit prisnin, prisnin të ndodhte diçka dhe kur dëgjonin këmbanat, niseshin...

S'di pse m'u kujtua gjithë kjo e kaluar, mbase më kujtoi këmbana që dëgjova sapo zbritëm nga maqina. Në fillim, kur dëgjova tingujt e këmbanës, më erdhi si çudi. Ç'është kjo këmbanë e përse bie? Hutimin tim e vunë re dy punëtorë dhe ja dhanë të qeshurit. Nga të folurit e tyre, kuptova se ishin banorë të asaj krahine.

— Ç'është kjo këmbanë?

— Këmbana e shën Galerit, — u tall njëri prej tyre.

— Ç'është ky shën Galeri?

— Është ai për të cilin ti ke ardhur, shoku inxhinier.

Unë ja dhashë të qeshurit. Shejtani, desh të ma hidhte. Ai kishte kthyer fjalën galeri në galer. Kur hymë në kafene, ai që u tall, më shpjegoi se si çanga e tyre, një copë shinë çeliku, nuk tingëllonte aq sa të dëgjohej gjer në galerinë Nr.3, se nuk linin zhurmat e ujërave dhe ata kishin vajtur në manastir e kishin marrë këmbanën.

— Bukur u paska vajtur në mend.

— Ç'të bënim. Ata të galerisë Nr.3 tani nuk ankohen më.

— Atje do të bëjmë një urë.

— Për këmbësorë?

— Jo, për transport; do ta bëjmë me të vërtetë, metalike. Faqja matanë është e gjitha me krom —



thashë dhe padashur ripashë me sytë e mendjes hartën tipografike të zyrës për këtë zonë. I gjithë ky pellg do të mbushej me galeri, ose shpella, siç i quajtën në fillim vendasit, shpella si ato të shën Joanit...

Në manastirin e shën Joanit ishin vërtetë tri shpella ose një, po me tri hyrje. Ditën e festës, në errësirë e shpellës, lireshin fëmijët e sëmurë, lireshin atje disa orë që t'u kalonin sëmundjet. Shpella, ky vend i shenjtë, shkelej nga çdo i ardhur dhe aty, në errësirë, njerëzit luteshin e faleshin, i luteshin të padukshmit në të errët, dhe shpresonin që ta shihnin atë në mes të asaj zagushie e nate mbytëse. Shpella ishte e vogël, njerëzit ishin të shumtë dhe frymat e shumta përziheshin e mbysnin ajrin me lutje, me vajtime dhe me goditje të gurëve mbi gur. Me thonj, me gjak, në errësirë njerëzit mundoheshin të shkëpusnin një copë gur nga shtëpia e shenjtë, e futnin në gji, pranë zemrës e dilnin s'andëjmi të zbetë, gati për t'u rënë të fikët, po me shpresën e tij në gji. Atë copëz gur e mbanin si hajmali. Çudi, sa shekuj shkuan e asnjërit s'i vajti mendja që ta shihte atë gur «të shenjtë» në mikroskop, të zbulonte aty gazin e jetës, burimin e jetës. Një ditë u bë kjo çudi, u bë para disa vjetësh, po njerëzit nuk u çuditën që u zbulua aty një madem i rrallë. Një fshatar vendas, që kthehej nga ushtria u çlodh e hëngri bukë buzë shpellës së shën Joanit dhe i erdhi çudi nga vezullimi i gurëve. Ju duk sikur dielli buzëqeshtë me shpellën, apo shpella tallej me dritën. Ky vezullim, si lojë hijesh e dritash, tërhoqi vëmendjen e ushtarit të liruar dhe i pëlqeu kjo shaka hijesh e dritash. Rrëmbeu një gur dhe qëlloi. Guri ra mbi gur e u thye, duke shpërndarë në çast xixa e yje, reflekse shumëgjyreshë. Ai mori një copëz në dorë e tha: «Gur shën Joani» e ju kujtua fëminia e tij, sëmundjet, gjyshja. Ju kujtua ajo copëz guri kur hidhej në sapllak e lulëzonte lule-lule, ju kujtua kur ja jepnin të pinte me zor atë ujë me gur të shën Joanit dhe qeshi. Pastaj mbushi torbën ushtarake me gur e u nis për në shtëpi. Kur shkeli në prag të portës, të gjithë u ngritën më këmbë dhe u qafuan,

e ulën pranë vatrës dhe djali ushtar nisi të tregojë për jetën e vet në ushtri, për shokët e vet tutje në kufi. Vëllaj i vogël, tetëvjeçar, i hapi torbën dhe ja derdhi gjithë ç'kish në të, një copë bukë, pak djathë, një kuti mish e plot gurë të shën Joanit. Kur ranë gurët përdhe, sytë e gjyshes u çelën, kurse të vocrrakut u ngrysën dhe vështruan shtrembër vëllanë e madh me rroba ushtari.

— Iiii, lala besoka!...

— Shëëët, — ja bëri gjyshja; — je i vogël ti, në punë të të mëdhenjve mos u përzej!

I jati përdrodhi mustaqet, pastroi zërin e u mat të flasë. Si erdhi mirë që nga torba e një ushtari të dalin gurë të shën Joanit.

— Këto gurë, baba, — foli me të shpejtë ushtari, — duhet të jenë gurë mademi. Si këta gurë nxjerrin në kufi, si këta shkëlqejnë. Nesër do të zbres në qytet, do t'i çoj në laborator.

— Nesër? Po prit një herë, or bir.

— Jo, baba, nëse do të jenë gurë mademi, do të jetë festë.

— Ç'festë more nip? — u hodh gjyshja.

— Festë e madhe, gjyshe.

— Festa e shën Joanit shkoi, mor bir, shkoi e ne s'vajtëm. E, ç'kohëra kanë ardhur. Si u larguan kështu njerëzit?

— Tani kemi festa të tjera, gjyshe; më të mëdha, më të bukura dhe jo vetëm një.

— Paçi, mor bir, paçi. Shyqyr zotit s'jemi më siç kemi qenë.

— Mirë jemi; do të jemi edhe më mirë, — tha ushtari dhe përkëdheli gurët me xixa...

Pas disa muajsh, në mëngën e thellë të shën Joanit u dëgjuan disa gjëmime të largëta, të thella. Çdo ditë, çdo javë gjëmimet e minave sa vinin dëgjoheshin më të qarta, më të pastra. Dhe rruga ngjitej me zor, pëllëmbë për pëllëmbë, futej thellë e më thellë në pyjet e fjetura gjithë lëmyshk e hije. Gjëmimet si bubëllima

u ngjiteshin dy faqeve të shpateve gjer në majë. S'andajmi era i shtynte e i shpërndante nëpër oxhaqet e shtëpive dhe të kullave. Dhe fshatarët u ngritën me kazma e me lopata dhe zbritën në luginë, e çanë me djersë e mund gjithë mëngën, e çanë më dysh, në dy krahinat dhe, duke punuar, shihnin se si shembeshin ahët shekullorë, si rrëzoheshin me krisma e me potere e si lugina përcillte jehonat gjer tutje, majë shpatit ku shndriste nga dielli këmbanorja e shën Joanit.

Një ditë rruga ngeci. Piketat kalonin mbi shpellën e shën Joanit.

— Minat do t'i vë unë, — u hodh e tha i pari ushtari.

— Jo, — kundërshtoi një burrë i thyer. — Do t'i vë unë minat sot.

— Unë e gjeta i pari mademin në këtë gufë, — nguli këmbë ushtari, — dhe unë kam të drejtë ta shemb.

Të gjithë e aprovuan njëzëri, po burri i thyer në moshë nuk heshti:

— Thashë një herë, minat do t'i vë unë dhe zjarrin unë do t'ja vë. Ti, — ju drejtua një moshatari, — e mban mend tim bir që vdiq në këtë shpellë? Ishte i sëmurë dhe bashkë me time shoqe e suallmë këtu që të shërohej. Aminadhavi e pa, i lexoi diçka nga ungjilli dhe na tha që ta çonim në shpellën e shenjtit. Dhe ne e lamë aty për disa orë që ta shëronte shën Joani. Kur hymë ta marrim, fëmija ishte ftohur. Shpella kishte lagështirë. Dimër qe. Sot do të ishte burrë.

Një heshtje e rëndë pllakosi si pllakë varri. Ush-tari bëri një hap përpara duke mbajtur kasetën me dinamit dhe ja dha.

— Merre, Ndreka.

Ndreka nuk foli, mori arkën e vogël dhe, i hesh-tur e i ngrysur, ju afrua shpellës. Ecte ngadalë, këmbët e duart i dridheshin. Së largu dukej sikur në duar ki-shte një djep të vogël. Sytë e Ndrekës u rrudhën nga errësira e shpellës dhe ai hyri me guxim dhe e vendosi kasetën me kujdes, tamam siç e vendosi dikur djalin e vetëm. Edhe atëhere, si tashti ishte. Dimri qe më të

dalë dhe shpella qante, pikonte pikë-pikë dhe fëmija qante me zë të çjerrë, të zënë.

— Si shumë u vonua, — u hodh e tha një nga fshatarët dhe u mat ta thërriste.

— Lëre, — ndërhyri një tjetër. — Para 12 vjetësh ai besonte. Këtë hap që po e bën s'e ka aq të lehtë. Ai po hakmerret kundër shën Joanit.

Pas pak të gjithë panë shpinën e kërrusur të Ndre-kës që po dilte duke shtrirë përdhe fitilin. Kur erdhi tek shokët u ngrit dhe kërkoi një cigare të ndezur.

— Largohuni, — tha nëpër dhëmbë pa i vështruar në sy. Ai i vuri zjarrin fitilit dhe u largua me hap të matur e të sigurtë. Minat gjëmuan. Qe gjëmimi më i madh. Gurët e shën Joanit u ngritën përpjetë drejt qiellit, u shpërndanë si çadër e ranë përdhe njëri pas tjetrit, pastaj u ngrit një tym i madh. Era e rrëmbeu dhe e shpërndau në ahishte. Pastaj s'u dëgjua më asgjë, as era e aheve, as gurgullima e përroit, e ujërave, asgjë s'u dëgjua. Qetësi e heshtje e plotë. Veshët s'kapnin asnjë zhurmë jete për një çast, për dy...

— Qëndruam shumë pranë e desh u shurdhuam, — qeshi ushtari.

— Ama gjësim.

— Gjashtëdhjetë kile dinamit, s'i thonë shaka.

— Si fluturuan gurët.

— Legjendat, përrallat, — ndërhyri ushtari.

— Ç'do të bëjë murgu kur ta marrë vesh?

— Do të çmendet.

— Aminadhavi i çmendur ka qenë.

— I çmendur, i çmendur, po mua më la pa djalë, — tha ftohtë Ndreka.

— Fajin e kemi vetë, u hodh një plak. — Ne e dëgjonim Aminadhavin.

— More nga është ky murg? Për besë, ka kaq vite në këto anë e s'e dimë.

— Kush ja di rrënjët atij. I ardhur është.

— Duket që nga emri.

— Aminadhav, pëshpëriti dikush.

— E mo, nga fjala amin vjen.

Të gjithë ja dhanë të qeshurit e filluan nga pas-trimi i gurëve. I mirrnin e i hidhnin në gore.

Dikush hypi me të shpejtë mbi një gur të madh, vuri njerën dorë te veshi, tjetrën te qafa dhe thirri me sa fuqi kishte:

— O... murgu Aaminaa dhaav, ke të faalaa ngaa gurët e shëen Joaaniit.

Përsëri qeshën dhe përsëri filluan nga puna. Rruga nga dita në ditë filloi t'i ngjitej të përpjetës së shpatit, la mënjanë manastirin dhe ju afrua fshatrave. Dhe erdhi dita kur zë e lëngëzohet dheu. Pranvera i shtoi ujërat dhe mënga e gjitha u çel e lulëzoi. Pranvera e atij viti i gjeti të hapura udhët e të thella galeritë në të dy faqet e shpateve. Maqinat s'pushonin së ardhuri e së ikuri të ngarkuara me gurë të shën Joanit.

Atë vit murgu Aminadhav, i cili prej kohësh kishte mbetur fillikat në manastir, u ra më fort këmbanave në ditën e festës, po kambanat nuk gjëmuan si dikur, viteve të shkuara, dhe fletët e aheve mezi i ngjitën tingujt deri në majat e shpateve. Zhurmat e maqinave dhe erërat e tymrat e motorave i kishin dehur ahët.

Aminadhavi nuk' u çudit që atë vit i erdhën shumë pak njerëz. Ai, që kur u prish shpella e shën Joanit, u bë si i tërbuar. Për të parën herë në jetën e vet i pa njerëzit e kësaj krahine ashtu siç janë me të vërtetë, njerëz. «Çudi, më parë sikur ishin ndryshe» thoshte me vete, tek vështronte që nga hajati i kishës gjithë mëngën e thellë gjer majë shpateve; dhe bënte çudi sepse mënga s'i ngjante më asaj që kishte pasë qenë dikur. Ajo nuk e përcillte më oshëtimën e kambanave.

Një vit më vonë, ditën e festës së madhe, Aminadhavit nuk i vajtën veçse disa pleq, megjithëse ai u shqye së rëni kambanave.

— Kot e ke që i bie, — i tha një nga pleqtë, kur Aminadhavi u grrit për t'i rënë.

— Po vijnë, po vijnë njerëz, — tha dhe u nis, po shtangu nga fjala e plakut tjetër.

— Ata janë punëtorët e turnit të dytë, shkojnë në galeri.

— Do t'i bie, do t'i bie, — tha me inat nëpër dhëmbë dhe u ngrit lart dhe filloi t'i bjerë me të madhe: Daaang, daang! Duuung, duung! I binte, i binte gjersa lodhej, pushonte pak e përsëri i binte: Daaang, daang! Duuung, duuung! Dhe përsëri pushonte, merрте frymë e përsëri i binte dhe vështronte rreth e rrotull. Ahët fëshfërinin, maqinat uturinin dhe njerëzit lëviznin poshtë e përpjetë galerive, hypnin e zbrisnin nga maqinat, dilnin e hynin nga klubi në menci, nga menca në kinema, në fjetore; të tjerë dilnin s'andejmi dhe s'donin t'ja dinin aspak se binte diku kambana. «Ç'është kësh-tu, pse s'dëgjojnë, ç'kanë që s'dëgjojnë?» dhe vazhdonte t'i binte si për inat. Kur zbriti nga kambanorja ishte bërë dyll i verdhë, si mehit, duart i dridheshin dhe sytë e skuqur i kishin kërcyer përpara.

— Ç'është Aminadhav? — pyeti më plaku.

— Fryma e Satanait, fryma e Satanait, qoftëlargu!...

— Jo, Aminadhav, nëse ti flet kësh-tu për njerëzit se s'të vijnë më, gabohesh. Nëse ti mallëkon, bën përsëri gabim. Njerëzit kanë gjetur rrugën e tyre.

— Qoftëlargu, fryma e Satanait...

— Atëhere ti s'i dashke njerëzit, Aminadhav, — tha plaku dhe iku.

Aminadhavi u drodh nga inati dhe nga që s'dinte se ç'të bënte, vajti përsëri në kambanore dhe përsëri nisi t'i bjerë kambanës me zemërim. Dhe duke i rënë thosh me zë të lartë: «Unë jam këtu». Dang, dang. «Dhe këtu do të jem». Dung, dung. «Ju nuk dëgjoni më, po zoti dëgjon». Dang, dang! Dung, dung!

\* \* \*

Dang! Dong! Dong!...

— Ngreu, shoku inxhinier, se ra çanga, — më thirri një nga punëtorët.

— E dëgjoj, — i thashë dhe u ngrita. Atë ditë kishim shumë punë. Do të qe fitore po të mbaronim p'

rënë çanga. U ngrita dhe kur dola jashtë, pashë ish-ushtarin që vazhdonte t'i binte kambanës çangë.

Dong! Dong! Dong!

— Mjaft i re, — i thashë, e zura veshët me duar.

— Do t'i bie inxhinier, se shokët janë thellë në përrua e s'dëgjojnë. Fryn veri dhe e merr zërin era.

Kur mbaruam punë, shkuam e u pastruam.

— Tani le të vijë konstruksioni metalik, gjithshka është gati.

— Do të pimë sonte, — u hodh e tha punëtori që qe tallur ditën e parë.

— Për urën do të pimë patjetër.

— Dhe unë do të të tregoj fundin e historisë së Aminadhavit. Vdiq nga dëshpërimi se nuk i përgjigjej më njeri tingujve të kambanës.

— E mora me mend, — tha inxhinieri. — Këta janë ata njerëz që kanë grumbulluar pak nga pak në shpirt helmin e fesë dhe ky helm, më në fund, i mbyt.

— Ke të drejtë. Ai kishte kohë që kishte mbaruar, — ndërhyri një punëtor tjetër.

\* \* \*

Brugës, duke u ngjitur për në qendrën e minierës, dëgjuam përsëri kambanën çangë. Tingujt e saj vinin që larg, herë të qartë herë të shurdhët. Era luante me tingujt, i shtynte, i shpërndante. Ecja dhe mbaja vesh se si binte çanga kambanë, se si kumbonin tingujt e saj përzierë me zhurmat e buldozerëve, sharrave e burive të kamionave, se si lugina përcillte tani jehonën e jetës. Disa hapa përpara meje, punëtorët vazhdonin të qeshnin e të thumbonin njëri-tjetrin.

### DORASHKAT

Veriu frynte duke mbushur rrugën me fishkëllima që ndesheshin me shtyllat e treteshin diku nëpër lagje. Drita e neonit përzihej me bardhësinë e dëborës dhe me fërfërizën që formonte re dëbore. Mes kësaj bardhësie, në të dalë të qytetit, vazhdonin rrugën, duke ndihmuar njëri-tjetrin, një burrë dhe një grua.

— Më duket arritëm, Besnik! — foli gruaja me zë të lartë dhe shikoi nga i shoqi, me vetullat e me kokoren të zbardhura prej dëborës. Ai ktheu sytë, i buzëqeshi dhe vazhdoi rrugën. Ajo i shtrëngoi krahun.

— Ky drejtë veri s'po m'len me pa larg. Po qe ku a parki, — foli ai me nëndialektin e vet.

Gruaja tundi kokën, dhe qeshi. Ata s'folën më, veç hynë në kabinën e portierit të parkut automobilistik, ku gjetën një plakush që rrinte pranë stufës dhe lexonte «Zërin e Popullit». Sa hynë njerëzit, plakuri luajti nga karriga dhe u liroi vend të ngroheshin.

— Eni bre, njerëz të per... Ç'u solli tash n'mbramje vonë?!

— Nji hall, bacë! Nesër patjetër do nisemi për në zonën e tërmetit. A thue ka ndonji makinë?

— A veç ju jeni? Për kaç gja mos u shqetsoni. — Ai zgjati kokën te dritarja dhe i thirri me sa zë kish një djaloshi veshur me peliçe.



— Kush niset nesër te tërmeti... te tërmeti?

Djaloshi çau mes fërfërizës dhe zëri i tij erdhi si jehonë deri te plaku, duke e mposhtur atë kor fërshtëllimash të veriut:

— Kolona e Bardhok Komunistit...

Plaku u zmbrops nga dritarja, fytyra i qeshi nga kënaqësia.

— Ju thashë? Nesër do t'u niska Bardhok Komunisti. Ka dy ditë që po bahet gati. Shkoni, takohuni me te në klubin e shoferëve.

— Si i thonë? — pyeti Besniku kureshtar.

— Bardhok Komunisti. Po s'i pat premtue kujt, ju merr patjetër.

— Luigjinë, rri këtu, — i tha Besniku së shoqes dhe doli nga kabina.

Në klub nja tre vetë me mushama e kasketa rrinin pranë dritares, bisedonin e qeshnin me rromuzet e njëri-tjetrit.

— Më falni. a asht këtu Bardhok...

— Cili Bardhok? — pyeti njëri, një djalosh simpatik, duke ngritur kasketën dhe duke shikuar në sy Besnikun.

Besniku u skuq dhe po mendohej si t'i përgjigjej: ishte i sigurtë që Bardhoku do kishte mbiemër tjetër, kurse ai mjerisht s'e dinte. Ndoshta shoferët do të qeshin me të, se ata bëjnë shaka me këdo. Po s'kishte ç'bënte, puna nuk priste.

— Bardhok Komunisti, bre burrë?

Të tre shoferët ja krisën gazit. Dy të tjerët, që ishin «rini», i ranë shpatullave atij babaxhanit që e kishte pyetur Besnikun.

— Unë jam, bre shok. Çfarë halli ke?

— Nesër duhet të jemi tej Qafës tok me gruen. Mora vesh se po shkoni. Apo na mirrni në maqinën tuej?

— Nesër shkojmë shtatëmbëdhjetë maqina. Në orën katër të mëngjezit, te portieri. Maqina ime do të të marrë ty e familjen tënde.

Besniku u përshëndet dhe doli.

Të nesërmen maqina e Bardhokut kaloi mes për mes qytetit me ulurimë, ngarkuar me lëndë ndërtimi për zonën e tërmetit. Në kabinë ishin katër vetë: Bardhoku, Besniku me të shoqen dhe një mësuese e re që vinte nga jugu. Ata heshtnin, kurse motori buçiste, sa nuk dëgjohej zëri i suferinës malore. Maqina hyri në grykë. Bardhoku shikonte përpara. Edhe Luigjina, e shoqja e Besnikut, shikonte përpara. Mësuesja nga Jugu kishte ulur sytë dhe mendohej.

«Në kabinë s'bën ftohtë» — mendonte Besniku.

Përpara doli një e përpjetë me kthesa. Shoferi e përqëndroi gjithë vëmendjen te marshet dhe te timoni. Mendohej ta merrte me mend se ku e kishte grumbulluar më shumë era dëborën.

«Jam në krye të kolonës... Kolona është prapa, unë duhet ta kaloj patjetër këtë drejt malore» — kështu mendonte ai duke shtrënguar timonin dhe duke ndjekur me vëmendje çdo zhurmë të motorit.

— A ju qëllon të udhëtoni shpesh në dëborë, shoku shofer? — pyeti mësuesja.

Bardhoku ngriti kasketën dhe shtrëngoi timonin duke i dhënë gaz motorit. Kishte mbaruar ngjitja.

— Shoqja mësuese, kam dhjetë vjetë që udhëtoj në dëborë. Po mos u tremb. Nuk rrëshqet maqina ime... Nga je, shoqja mësuese? — Bardhoku fliste qartë dhe ngandonjëherë ngatërronte dialektet.

— Nga Vlora.

— Nga Vlora?

Luigjina ktheu kokën dhe e shikoi me vëmendje. Mësuesja ishte trupvogël dhe e shëndetshme. Dy sy të zgjuar e të zez shikonin gjakftohtë. Palletja e saj ishte e re.

— Jeni vullnetare? — pyeti Bardhoku që, si dukej, i pëlqente biseda.

Mësuesja buzëqeshi dhe pohoi me kokë. Luigjina, kthyer nga ajo, vazhdonte ta kundrojë dhe sytë e tyre u ndeshën.

— Për sa kohë? — pyeti Bardhoku duke shikuar gjithnjë përpara.

— Ne dolëm për një deri në tre vjet. Por po qe nevoja, edhe më tepër... — foli mësuesja e re me kre-nari. Asaj i dukej se fliste në emer të atyre qindra vullnetareve që kishin dalë verën e kaluar nga qytetet e Jugut për në shkollat e malësive të Veriut. Këtë e dinte Luigjina, se i kishte edhe ajo dy në fshatin e saj tej Qafës. E dinte edhe Besniku që ishte propagandist me rininë e kooperativës e i lidhte të gjitha detyrat me inisiativat e reja. E dinte edhe Bardhoku që i kishte sjellë me maqinën e tij, në fillim të shtatorit.

— Kurse unë përgjithmonë — i tha Luigjina.

— Pse? — pyeti mësuesja.

— Jam martuar tej Qafës. Atje jetoj tok me bu-rin, në kooperativën malore...

— Nga jeni? — e pyeti Bardhoku.

— Nga Tirana.

— Nga Tirana në malësi tej Qafës?! — u çudit mësuesja e re.

— Posi. Ja, im shoq!

Mësuesja e re vështroi Besnikun, kurse ky i hodhi një shikim të ftohtë.

Shikimi i mësueses së re dukej sikur thoshte: «Ky do të jetë trim i madh...» Sipas saj trimat vlerësohe-shin nga fjalët e pakëta dhe nga shikimi i tyre i veçantë.

— Ç'punon? — pyeti Bardhoku duke kthyer pak kokën nga Besniku e duke mos ja hequr sytë rrugës së mbushur me dëborë që zbriste në një luginë.

— Në kooperativë. Baj çdo punë. Edhe në dimën kemi boll punë...

Bardhoku siguroi marshet dhe u kthye për një çast dhe e shikoi në ninëz të syrit, sikur desh ta kuptonte më mirë. Pastaj i foli Luigjinës:

— Bash mirë ja ke ba, motër! Edhe unë malësor jam. Këndeje. Po u martova në qytet dhe mbeta aty. Një vëlla e kam tornitor, kurse gruan tezgjahiste në kombinat. Më tërhoqi ajo, por ndonjë ditë tash po e hedh mbi karroceri tok me carrokët... — Ai qeshi. — Forca

«shpirtë»!! — i thirri maqinës duke hapur derën dhe duke e mbyllur me forcë. Ndërroi marrshet se po ecte drejt luginës, ku rruga ishte çarë prej traktorit.

— Pse të thonë Bardhok «Komunisti»? — e pyeti Besniku.

Mësuesja dhe Luigjina kthyen sytë. Ndodh shpesh që njerëzit rrinë për një kohë tok, mendojnë secili më vete për të njëjtin problem, por s'e hapin bisedën për atë që i shqetëson. Bardhoku hapi kapakun e sirtarit të sendeve dhe nxori dorashkat e tij të leshta.

— Mësuese, merri e mbajti pak se po mardh... kurse unë i përdor veç kur ndalem.

Mësuesja u skuq.

— ... e që pyete ti, vëlla, si ta thonë emrin, Besnik?... E gëzofsh. Komuniste unë kam veç zemrën dhe emrin. Zaten s'e pat keq ai që ma vuri këtë emër. Atje në zonën e tërmetit, or ti bablok, unë shoh vullnetarë nga gjithë Shqipëria. Të tërë durojnë tufanin dhe ndërtojnë shtëpi të reja për të pastrehët e mbetur trokë. Që atje, unë them, se gjithë ai popull është komunist. Mandej të shifje rininë në Pecaj të Shkurtes, të linte mendja! Çuditej malësori, kur shihte si këndonin cucat e Jugut duke punuar e duke mundur të ftohtit e asaj ane!.. Unë shkoj gjithkund me këtë «nusen» time. E çfarë s'shohin sytë tanë nëpër atdhe, or vëlla! Duhet të rrimë një natë të tërë të kallzoj e s'mbaroj kurrë...

Bardhoku fliste për veten e për maqinën sikur ajo të ishte e gjallë, mikja e tij besnike. Si kuptohej ai e donte maqinën, ashtu si duan prindët fëmijët e tyre.

— Pra, dimrin e kaluar kishte rënë borë e madhe. Unë po kthehesha prej Veriut ku kisha çuar miell. Po kthehesha në qytet i lodhur, i këputur. Ishte pasdreke vonë. Kjo «shpirtja» ecte si era dhe as që ankohej fare. Erë nuk frynte fort, por ishte ftohtë kjamet. Duke ju ulur asaj grykës që ju thashë, shoh në mes të rrugës një njeri të shtrirë, një strajcë, e, pak më tutje, një shkop. E ndal maqinën. Ulem. Një plak! E marr me mundim e e fus në kabinë. Sakaq nis e i bëj masazhe

të shpejta. Kishte ngrirë plakushi i ngratë prej të ftohtit e mezi i ndihej zemra. Ndeza motorin mirë dhe mendova ta çoj në spital. Shikova orën. Duhej edhe mjaft kohë të arrija në qytet, kurse plaku po më mbaronte. Vazhdova ta fërkoj në zemër e në damarë të qafës. Kur m'i çeli sytë plakushi!! I ndritnin sytë. S'e keni idenë sa u gëzova! Sikur të më ishte ngjallur plaku im... Fillova të qesh e të kënaqem me të nga gëzimi që ndjeja. Pastaj ai nisi edhe të flasë e erdhi mirë në vete. Kalova kështu mjaft kohë me të e gruaja më priste atë natë se i kisha thënë që do të kthehesha. Pastaj u nisëm. Plaku e kishte shtëpinë pranë kodrës matanë. E lashë maqinën ndezur në rrugë dhe e përcolla bablokun deri në shtëpi. E çfarë s'bëri që t'ë më mbante për darkë. Unë s'ndeja. Dësh të më jepte lekë. Më zemëroi e u grindta me të sa desh ika pa u takuar fare, ndonëse më kishte rrethuar gjithë familja e farefisi i tij. Nxori e më dha do fiq të thatë. I pranova me qejf e nisa të ha më këmbë. S'dinte si të ma mbushte mendjen t'i qëndroja në shtëpi. Dikur ika. Pas nja dhjetë ditësh kthehem në park. Rregulloj maqinën dhe shkoj në klub. Aty ishin jo më pak se nja tridhjetë a dyzet shokë të mi. Sa më panë, ja krisën gazit. Unë s'kuptova gjë. Mes atij gazi më dhanë dorashkat e leshta që i pata harruar në shtëpinë e bablokut e më kallëzuan se paskish ardhur vetë plaku të më takojë. Mirëpo ne jemi dy Bardhokë në park. E, a do ti? I paskish dalë shoku im. Plaku ishte zemëruar e paskish thënë:

— Jo, or ti! Due at tjetrin, komunistin! Bardhok Komunistin!...

«— S'kemi Bardhok komunisti...» — ishin përgjegjur njerëzishëm shokët e mi.

«— Llagapin s'ia dij, or ti. Por q'aj komunist a, q'at due unë...»

Plakut i kishte mbetur peng që s'më kishte gjetur e kishte shkuar te drejtori. Shokët më detyruan t'i shkoja në shtëpi plakut mirënjohës e zemërbardhë. Tani shpesh më vjen edhe në shtëpinë time. Po nuk rri. Ikën

sa më takon. Kurse emri më mbeti. Të them të drejtën, mua më pëlqen kjo, se më dallon në krejt parkun me gisht, por nganjëherë më bën të skuqem, se s'jam gjithnjë i pari i kolonës si sot. Tani ja kam nisur edhe unë me këtë «nusen» time të jem përherë në të parët kur ka vështirësi. E s'do vdes pa u bërë komunist për-njimend. . .

Heshti. Si duket Bardhoku kishte rrëfyer gjithshka. Besniku me të shoqen dhe mësuesja nga Vlora po mendonin për shoferin. Shoferi dukej se nuk mendonte asgjë veç dëborës së rrugës. Por nuk qe kështu. Ai e theu heshtjen i pari:

— Shoqja mësuese, mos u mërzit. Edhe pak e je në shkollë. Po ju shokë, si u martuat? Pa na kallzoni një herë, se s'kemi si e kalojmë kohën. Hajt, pra! Kush po ja nis? Ti bablok apo «emancipimi»? — e hodhi fjalën ai tek Luigjina që shikonte të shoqin me vëmendje.

— «Emancipimi, emancipimi» — foli Besniku duke qeshur dhe ju drejtua së shoqes. — Tregoje, pse jo!

Luigjina tregoi si e pat njohur Besnikun në zborin ushtarak. Dhe ishin martuar të dy në fshat. . .

«Ja një grua e bukur, me sy të pastër — mendoj shoferi. — Dashuria e vërtetë nuk pyet shumë për qytet a fshat. Duket. Kjo është e gëzuar.»

Në kabinë bënte ngrohtë. Edhe mësuesja e re vullnetare nga Vlora mendonte për këtë çift të ri. Tani nuk mendonte më për shoferin që njerëzit e thërresin Bardhok «Komunisti».

«Këta edhe në Mars t'i çosh, përsëri do të dashurohen, do të ngrejné diku një kooperativë malore dhe do të jenë përsëri të gëzuar e do të flasin me krenari për dashurinë e tyre.»

«Kjo është dashuri e re, më parë s'ka ndodhur kështu», vijonte të mendojë Bardhoku, ndërsa shikonte me vëmendje kthesat e vogla të rrugës së bardhë që fshihej pas kodrës me pisha të rënduara nga dëborat. Fillin ja preu mësuesja.

— Ja, fshati im! Unë po zbres, — tha ajo. La do-

rashkat e Bardhokut mbi motor, mori valixhen e vogël, u përshëndet dhe zbriti. I dha dorën shoferit dhe u nis për në fshat e pas pak humbi mes pishave mbi rrugë.

Kur maqina u nis, mësuesja e re nga Jugu u duk edhe një herë majë kodrës së zbardhur nga dëborë. Përshëndeste me dorë. Bardhoku i ra bories në shenjë përshëndetjeje, kurse Besniku e shikonte nga dritarja e kabinës.

Maqina doli në Qafë dhe pamja u hap tej e tej me tërë madhësinë e saj pa fund. Aty zbritën burri dhe gruaja. U përshëndetën si miq me shofer Bardhokun dhe filluan të çanin dëborën duke u mbajtur me njëri-tjetrin. Bardhoku i shikonte nga kabina.

«Ja, dashuria e vërtetë, po ngjitet në kooperativën malore» — mendoi ai dhe qeshi me mendimin e vet, se ju duk shumë i goditur. Pastaj ndjeu një farë keqardhjeje kur pa kabinën bosh me dorashkat që lëviznin mbi mbulesën e motorit.

«Pse dreqi s'ia dhashë mësueses së re dorashkat... Ajo s'kishte dhe bën ftohtë» — mendoi ai.

— Pa hajt, «nuse», hajt shpirte, në zonën e tërmetit, se i kemi njerëzit jashtë! — foli ai me zë të lartë, sikur po i fliste diçkaje të gjallë, dhe i dha maqinës gaz sa gjëmoi mes rrugës së bardhë që zbriste poshtë Qafës me tërë ato kthesa gjarpërushe. Të ftohtit e dhjetorit të vitit 1967 përplasej mbi xhamat e kabinës dhe zbrapseej me gjithë ulërimën e vet që mbytej e mundej nga uturima e maqinës së Bardhok «komunistit».

## HISTORIA

Ai priste te stacioni i autobusit. Kishin kaluar pesë minuta. Shiu porsa kishte pushuar dhe njerëzit që përkohësisht kishin gjetur strehë nëpër hyrjet e dyqaneve, tani shpejtonin që të mos i zinte furia e re e shiut, që, me sa dukej, nuk do të vononte. Gjëja e parë që atij i kishte bërë përshtypje në Tiranë, kur kishte ardhur para dy javësh nga qyteti i vogël malor B., ishte lëvizja. Këtu njerëzit ecnin më shpejt se në qytetin e tij. Ata nxitonin kur shkonin në punë, ose kur delnin prej saj, nxitonin për në shtëpi, për në kinema, për kudo. Veçanërisht kur binte muzgu. Atëherë qyteti dukej si në ethe. Në trotualet e qendrës njerëzit të shtynin me sup, përplaseshin me ty dhe, pa thënë as «më fal», iknin më tutje. Në fillim atë e shqetësonte kjo lëvizje, por pastaj filloi t'i pëlqente. Atij i pëlqente Tirana dhe jeta e saj. I pëlqente çdo gjë, duke filluar që nga emri Tiranë, që i dukej si diçka që shpaloset papritur dhe ecën drejt, gjer te rrugicat e vogla pranë qendrës, që janë të qeta e të ngushta, në krahasim me rrugët kryesore. Kur erdhi natën e parë në konviktin e studentëve, në kokën e tij ishin grumbulluar kaq shumë përshtypje, saqë nuk e zinte dot gjumi. Ai do të ishte pesë vjet qytetar i këtij qyteti. Kjo gjë e turbullonte. Ditët e tjera, dalëngadalë ai filloi të njihej më mirë me rrugët, me jetën e studentëve dhe me zakonet



e kryeqytetit. Pastaj i bëri përshtypje një gjë tjetër. Këtu njerëzit që ti njuh, kur të shohin rastësisht në rrugë (gjë që ndodh rrallë), nuk ndalojnë të këmbejnë dy ljalë, por të japin një përshëndetje të ftohtë dhe vazhdojnë rrugën me nxitim. Kështu i ndodhi atij ditën e tretë, kur pa në bulevard të madh ca shokë të kursit të vet. Atij ju duk kjo gjë një ngjarje e madhe (po takonte të njohurit e vet mu në mes të kryeqytetit), dhe u bë gati të ndalonte, por ata i dhanë një përshëndetje kalimthi dhe vazhduan rrugën. Kjo gjë e mërziti pak në fillim, ashtu siç e mërziste vetmia, por filloi të mësohej. Përveç shokëve të kursit në Tiranë s'kishte asnjë të njohur tjetër. Duke ecur nëpër rrugë mbrëmjeve, ai mendonte se do të vinte dita që të mos e ndjente veten i huaj në këtë qytet të çuditshëm. Natën në konviktit dhe në klubin e studentëve kishte gjallëri. Studentët mblidheshin te radioja dhe dëgjonin lajmet e fundit për ngjarjet në Çekosllovakë. Ata diskutonin pastaj një kohë të gjatë për to dhe ai e ndjente veten shumë mirë midis tyre. **Por kur delte nëpër qytet vetmia e mërziste.** Ai qe mësuar që në çdo rrugë dhe në çdo klub në qytetin e tij të vogël të takonte miq dhe të njohur, kurse këtu s'kishte asnjëri. Rrugët e Tiranës ishin mbushur me vajza të gjalla dhe simpatike. Ato i mbanin flokët ndryshe, ecnin ndryshe dhe buzëqeshnin ndryshe nga vajzat e qytetit të tij të vogël. Në fillim atij i qe dukur pothuaj i pamundur shoqërimi i tij me një vajzë të tillë. I dukej sikur i përkisnin një bote tjetër, të panjohur dhe të paarritshme për të. Tani, duke qëndruar te stacioni i autobuzit, atij i vinte çudi nga vetja, se si vetëm dy javë pas ardhjes së tij në Tiranë ai po priste në takim një vajzë tiranase. Atij i qe dukur gjithmonë se gjëra të tilla fillojnë zakonisht me vuajtje dhe me fletë të shumta ditari, plot supozime dhe dyshime. Kurse kjo ndodhi në mënyrë fare të thjeshtë. Atë e quanin Diana. Ishte në kursin e tij. Nga përshëndetjet e të gjitha vajzave të kursit, përshëndetja e saj i qe dukur më e ngrohtë. Ata kishin qëndruar disa herë bashkë gjatë leksioneve. Ai ishte shumë i fortë në

fizikë dhe ajo e pyeste vazhdimisht. Atë ditë në mëngjes kur, në pushim, ra fjala për një film që loste këto ditë dhe ai i tha se akoma nuk e kishte parë, ajo tha se gjithashtu nuk e kishte parë filmin dhe po të donte ai mund t'i merrte biletë për në orën pesë e gjysmë, meqenëse rruga për në shtëpi i kalonte para kinemasë. Këtë gjë ajo e tha pa drojtje përpara të tjerëve. Ai gati sa s'u skuq.

Kjo ishte vërtet një ditë e jashtëzakonshme. Në të gjitha emisionet radioja jepte vazhdimisht lajmin e daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Studentët nëpër korridoret flisnin se do të krijohej brigada e studentëve. Ata diskutonin për automatikët e rinj që do të merrnin. Në pushime u bënë dy mbledhje të shkurtëra, ku u tha se ç'duhet të bëjnë studentët e konvikteve në rast prove të alarmit ajror. Jeta papritur mori një ngjyrë të fortë dhe të jashtëzakonshme. Atij ju duk se filloi të shkrihej ajo distancë që ai kishte patur me studentët e tjerë, sidomos tiranas. I dukej sikur ata ju bënë papritur më të afërt dhe më të kuptueshëm. Sikur të mos mjaftonin gjithë këto përshtypje të forta, Diana e ftoi të shkonin në kinema. Jeta fitoi papritur një densitet të tillë, saqë atij i dukej sikur nuk do ta përballonte dot.

Diana po vononte. Mendimi se ajo mund të mos vinte, iu var si një hije mbi mendimet e tjera. Ai donte që ajo të vinte. Donte shumë që ajo të vinte. Në këtë orë, kur dita po ngrysej me shpejtësi, ajo duhej të vinte patjetër. Autobuzët zbrazeshin në stacion njëri pas tjetrit. Ai nuk i hiqte sytë nga dera e përparme, ku njerëzit hidheshin sikur i shtynte dikush. Porsa autobuzi ikte duke zbrazur për një çast stacionin, ai fillonte të mbushej përsëri. Ai pothuajse e kishte humbur shpresën, kur Diana erdhi.

— Më fal se u vonova, — tha ajo gjithë gëzim sikur të kishte bërë punën më të mirë në botë. Ai e ndjeu turbull se, në qoftë se do që të provosh gëzimin e dashurisë, duhet më parë të provosh shqetësimin e

vonesës, që rri gjithmonë si roje përpara pragut të dashurisë. Ai e ndjeu se këto fjalë do të përsëriteshin shumë herë dhe shumë herë ai do të thoshte «s'ka gjë», megjithëse kjo nuk ishte e vërtetë.

— Jemi vonë, — tha ajo, — duhet të ecim shpejt.

Megjithëse shpejtuan, ata nuk u futën dot në film. Porta e kinemasë ishte mbyllur. Dy-tri, të inatosur po i binin portës me grusht, por asnjeri nuk e hapte. Biletat që ajo i kishte nxjerrë nga xhepi gjatë ecjes i mblodhi shuk dhe i hodhi. Ato ranë mbi trotuarin e lagur dhe duke parë se si ajo qeshi, ai e kuptoi se ajo ishte po aq indiferente për filmin sa dhe ai.

— Po tani ç'do të bëjmë? — pyeti ajo.

Ai ngriti supet. Në këto raste nuk e dinte ç'duhej bërë, sepse asnjëherë nuk i kishte qëlluar të vinte në kinema me një vajzë dhe porta e kinemasë t'ishite e mbyllur dhe vajza t'ishite kaq simpatike.

— Shkojmë në ndonjë kinema tjetër? — pyeti ajo.

— Shkojmë.

Ata u nisën prapë drejt qendrës, megjithëse të dy e dinin se nuk do të shkonin në asnjë kinema tjetër, sepse në këtë orë ishte e vështirë të gjeje bileta dhe veç kësaj as ai, as ajo nuk ishin të sigurtë se dëshironin të shikonin vërtet ndonjë film.

Duke ecur nëpër rrugët e qendrës ai çuditej se si mund të ecte kështu lirisht me një vajzë mes për mes qytetit, pa tërhequr vëmendjen e askujt. Ai po vriste mendjen se a duhej që ti propozonte asaj të hynin në ndonjë pastičeri që të blenin akulllore, apo ndoshta kjo gjë do t'ishite një guxim i tepërt nga ana e tij. Ai kishte vënë re se vajzat e Tiranës i hanin shumë akulloret, megjithëse vera kishte kaluar dhe kishin filluar shirat. Diku përpara, u shfaq reklama e një akullloreje të madhe. Ajo ja paralizoi krejt mendimet. Kur u gjenden pothuaj nën dritën e reklamës dhe ai po bëhej gati të hapte gojën, ajo tha e para:

— Blejmë akulllore?

Ajo e tha këtë gjë me thjeshtësi, duke kthyer ko-

kën nga xhami i veshur me avull, prapa të cilit me dhjetëra njerëz hanin akullore në këmbë.

— Unë porsa mendoja...

— Apo s'i ke qejf akulloret? — e ndërpreu ajo.

— Pse s'i kam?

— Të them të drejtën mua s'më pëlqen kur djemtë hanë akullore, — tha ajo, duke qeshur.

Ai s'dinte ç'ti thoshte.

— Megjithatë ti mund të blesh për hatrin tim, apo jo?

Dreq o punë. Përsëri ai nuk dinte ç'të thoshte. Ajo hyri e para në pastičeri.

— Në anët tuaja duhet të ketë shumë dëborë, — tha ajo duke e mbajtur akulloren me dy gishta.

— Po, bie shumë. Disa herë arrin trashësinë dy metra.

— Ah, sa bukur!

Ai donte që të vazhdonte biseda për dëborën, sepse e ndjente që këtu kishte përse të fliste. Dëborë ishte një taban i sigurtë që nuk do ta linte bisedën të fundosej.

— Kurse në Tiranë, mezi bie një herë në vit, — tha vajza pothuaj me trishtim.

— Vetëm një herë?!

— Po. Bile ka vite që s'bie fare.

— Çudi!

— Ama, kur bie bëhet nami, — tha ajo me një ton të gëzueshëm. — Nuk shkon dot në rrugë, sidomos po të jesh vajzë. Djemtë gjuajnë nga të gjitha anët. Po tek ju gjuajnë me dëborë të rriturit?

— Jo. Lozin vetëm të vegjëlit.

— Sigurisht. Atje ka gjithmonë dëborë, kurse këtu është një gjë e rrallë. Prandaj çmenden i madh e i vogël. E di ç'bëri vitin që shkoi vëllaj im i vogël? Pri-shi frigoriferin.

Ai qeshi.

— Më kujtohet, vitin që shkoi ra dëborë të nesërmen e ditës kur u inaugurua monumenti i Skënderbeut.

Në mëngjez ai u gdhi i mbuluar me dëborë. Sa bukur që ishte! Mbi pelerinë, mbi qafën e kalit. Ah, sa bukur!

— Po frigoriferi pse u prish? — pyeti ai.

— A, po, harrova të them. — Ajo qeshi përsëri. — Në mbarim të ditës, dëbora pothuaj u shkri. Çunat e pallatit tonë mezi gjenin grushtet e fundit të saj nëpër tarracat. Kur u shfrytëzua çdo kënd, vëllait tim dhe një djali tjetër, që banonte në apartamentin përballë nesh, ju ra ndër mend të hapnin frigoriferin dhe të bënin topa dëbore me brymën e katit të sipërm. Kur erdhëm në shtëpi e gjetëm guzhinën të lagur. Frigoriferi i hapur punonte pa pushim. Ata zgjatnin duart brenda me radhë dhe nxirrnin grimcat e fundit të brymës.

Duke treguar, ajo qeshte dhe hante akulllore. Ai gjithashtu qeshte. Pasticëria ishte plot me njerëz dhe asnjeri nuk e dëgjonte bisedën e tyre, sepse kishte shumë zhurmë. Ata nuk kishin mbaruar së ngrëni akulloret, kur nga radioja, që ishte vendosur te banaku, u dëgjua zëri i spikeres që po jepte lajmet. Përsëritej lajmi i daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Në pasticëri u bë një farë qetësie. Pas deklaratës zyrtare, jepej një reportazh nga jehona që kishte bërë lajmi në një uzinë të Tiranës.

— Në lagjen tonë u bë një mbledhje e Frontit ku u dhanë udhëzime se ç'duhet të bëjë secili në rast alarmi ajror, — tha ajo duke dalë.

— Edhe tek ne në konvikt u bë një mbledhje e tillë, — tha ai.

Brugët ishin plot me njerëz. Ata ecnin pa ndonjë qëllim dhe asnjëri nuk u kujtua të shkonte në ndonjë kinema tjetër.

— Si mendon ti, — pyeti ajo, — ka mundësi që shtetet revizioniste të bëjnë ndonjë sulm kundër nesh ashtu siç e bënë në Çekosllovakia?

Ai nuk u përgjegj menjëherë.

— Ka mundësi, — tha pastaj. — Në kohën tonë çdo gjë mund të pritët prej tyre.

— Prandaj do të bëhen tek ne alarme ajrore?

— Sigurisht.

— Asnjëherë nuk kam parë alarm ajror, — tha ajo.

Ata pa kuptuar e lanë qendrën dhe, pasi kaluan hotel «Dajtin», u kthyen në bulevardin e qetë «Marsel Kashen». Trotuaret ishin mbushur me fletë të verdha. Duke shkelur mbi to ata e ndjenë se bisedat e tyre ishin në shterim e sipër. Tani që ecnin midis pemëve të larta, të dyve u dukej se ishte një gjë e panatyrshme dhe artificiale të flisnin për akulloret ose ndonjë qyfyf tjetër. Meqenëse nuk gjenin dot një bisedë që t'i përshstatej atmosferës vjeshitore të bulevardit, ata, përsëri pa e kuptuar, e lanë bulevardin «Marsel Kashen» dhe shkuan drejt qendrës. Tani ai priste çdo sekondë që ajo të thoshte se u bë vonë. Por ajo nuk e tha këtë gjë as kur arritën në sheshin Skënderbej dhe as kur kaluan në Rrugën e Dibrës. Ai mendoi se ajo do ta thotë këtë gjë me siguri kur të dalin nga Rruga e Barrikadave tek Mapua Nr. 2. Në qoftë se ajo nuk do ta thoshte as atje, atëhere do ta thoshte tek magazina e Librit Ndërkombëtar. Dhe në qoftë se nuk do ta thoshte as atje atëhere ai, me siguri do të flinte shumë pak kur të kthehej sonte natën në konvikt. Ata kaluan Rrugën e Barrikadave dhe ajo s'tha gjë. Tani po kalonin Librin Ndërkombëtar. Ecën përpara Bar «Krimesë», xhamet e të cilit ishin veshur si gjithmonë me avull të dendur, pastaj, me hapa gjithmonë e më të ngadaltë, vazhduan rrugën përbi Pallatit të madh të Kulturës. Tani ajo do të thotë me siguri, mendoi ai. Do të shikojë orën e qytetit dhe do të thotë. Ajo ktheu kokën vërtet nga ora dhe ai priste të thoshte se u bë vonë, kur në atë çast, diku nga e djathta, sipër qytetit, në fillim e ngadaltë sikur zgjohej nga gjumi dhe pastaj gjithmonë më e fortë dhe e mprehtë, u dëgjua një sirenë. Zëri i saj rritej e rritej vazhdimisht dhe, kur arriti pikën më të lartë dhe filloi të ulej, u dëgjua një tjetër sirenë. Pastaj një tjetër. Një tjetër. Dritat e rrugëve u shuan. Disa zëra thirrën «alarm». Rruga e zhytur papritur në errësirë, në fillim u duk sikur shtangu, pastaj u përmend papritur, u dëgjuan zëra, hapa që vraponin, një zhurmë e mbytur që vinte nga errësira. Dritat e Pallatit

u shuan gjithashtu. Dritat e lokaleve dhe të MAPO-ve po shuheshin njëra pas tjetrës. Ata qëndruan në vend. Rruga oshëtinte nga një zhurmë e mbytur. U shuan dritat e kafeve. Ora u zhduk nga qielli. Qendra u zhyt në errësisë të plotë. Diku u ndez dritë në një dritare. Një zë i rreptë thirri «shuani dritën!» Drita u shua. Dikush në rrugë fliste me zë të ashpër në formë urdhëri: «Qytetarë, futuni nëpër strehët më të afërta. Zbrazni rrugët». Zhurma e verbër e hapave sa vinte bëhej më e mbytur. Sirenat vazhduan të binin njëra pas tjetrës.

Pa ditur as vetë se si, ajo e kishte kapur atë për dore. Përbri tyre ndjenin njerëzit që ecnin dhe futeshin diku. «Qytetarë, largohuni nga rrugët!» dëgjohej zëri i ashpër.

— Këtu është një lulishte e vogël, — tha ai. — Futemi në lulishte.

Ata u futën në lulishten e vogël përpara Pallatit të madh të Kulturës. Ajo nuk ja kishte lëshuar dorën. Në lulishte ishin futur edhe njerëz të tjerë. Ai pa një cigare, pastaj një tjetër. Nga zhurma e sirenave zërat e ulët të të panjohurve nuk dëgjoheshin. Ata rrinin fare pranë njëri-tjetrit. Ishte hera e parë në jetën e tij që një vajzë kishte vënë dorën mbi dorën e tij. Ai ndjente aromën e flokëve të saj të krehura bukur. Një aromë e këndshme, e panjohur.

Sirenat filluan të pushonin njëra pas tjetrës. Dukej sikur po u merrej fryma. Kur heshti sirena e fundit, u bë befas një heshtje tronditëse. Dëgjoheshin vetëm ca hapa të largët që iknin diku. Pastaj, nga qielli erdhi një zhurmë tjetër më e shtirë dhe më e largët. Ata ngritën kokat. Lart, shumë lart fluturonin dy reaktivë, njëri me sinjale të kuqe, tjetri me të kaltërta.

Me një furi të papërmbajtur atij i dyndeshi në gjithë qënjen e tij copëra ndjenjash e mendimesh të shkëputura. Ato shkëlqenin në çast, pastaj shuheshin, pastaj ndizeshin të tjera, ashtu si shkëndijat që lëshojnë një zjarr të madh kur dikush trazon urët. Kishte diçka madhështore dhe tronditëse në këtë minutë alarmi. Dhe befas, ju duk se për herë të parë në jetën e vet, ai

mundi të perceptonte në mënyrë jashtëzakonisht të përmbledhur e të qartë, atë që kishte mësuar, dëgjuar dhe lexuar, mijëra herë, në mijëra këngë e faqe librash e abetaresh, që nga moshë e vogël e gjer më sot për historinë e popullit. Atij ju duk se për herë të parë preku me duar historinë. Ai preku trupin e historisë. Historia ishte aty, rreth e rrotull, e thjeshtë dhe e kup-tueshme si asnjëherë.

Në rrugë kaloi një gaz i policisë me dritë të kuqe. Drita e tij, duke rrëshqitur e zbetë midis drurëve, ra për një çast me një përflakje të përgjakur mbi ballin e tij dhe pastaj humbi. Ajo e mbante dorën e tij shtrënguar edhe më fort. Përse, që nga mëngjezi, kur studentët u lajmëruan për formimin e brigadës dhe u bë ndarja në batalione, asaj, i lehtë si një mjegull, i kaloi dy-tri herë në kokë mendimi se në rast lufte, ai mund të... përpara saj? Ndoshta sepse ai ishte nga zonat e largëta malore, atje ku në meloditë e këngëve ka gjithmonë diçka dramatike? Apo ndoshta se në fytyrën e tij kishte diçka prej atyre që hidhen të parët në sulm? Apo që kjo gjë i kishte kaluar asaj nëpër mend ashtu thjesht, vetëm sepse ai ishte djalë? Ajo vetë nuk e dinte përse dhe as që përpiquej ta dinte.

Njerëzit që ishin futur në lulishte bisedonin me njëri-tjetrin, sikur të ishin të njohur prej kohësh. Ishin po ata kryeqytetas që para një çerek ore mbushnin me nxitim rrugët dhe që atij i qenë dukur gjithmonë të ftohtë e të paafuëshëm. Tani ata bisedonin për avionët, për sulmin e mesnatës kundër Çekosllovakisë, për manevrat e ushtrisë sonë. Dikush tregonte hollësisë se si u pushtua atë natë aeroporti i Pragës. Një tjetër i thosh-te dikujt diçka për mënyrën si asgjësohen desantët.

Atij ju duk sikur ishte në shtëpinë e vet në qytetin e vogël malor B., midis njerëzve të vet, pranë zjarrit dimëror.

Një sirenë e vetme ngriti frymëmarrjen e saj të fuqishme mbi kryeqytet.

— Mbaroi alarmi, — tha një zë.

Neonet e rrugëve u ndezën të parat, duke u për-



pëlitur si të përgjumura. Pastaj u ndez ora e madhe, dritat e Pallatit të Kulturës, lokalet, MAPO-t. S'kaluan shumë sekonda dhe rrugët u mbushën përsëri me njerëz dhe me zhurmë. Maqinat që kishin ndaluar ndanë trotuareve, atje ku i kishte zënë alarmi, filluan të lëvizin. Ca fëmijë vraponin duke imituar zërin e sirenës.

Ata ecën midis turmës së kalimtarëve drejt sheshit Skënderbej. Sheshi ishte plot gjallëri. Autobusat urbanë, të mbushur më tepër se zakonisht, mezi çanin midis njerëzve. Ajo pa orën.

— Koha për shtëpi? — pyeti ai.

Ajo bëri «po» me kokë. Në «po» në e saj kishte një keqardhje të gëzueshme. Kur kaluan përbri monumentit të Skënderbeut, ata të dy buzëqeshën me vete. Me siguri ju kujtua biseda për dëborën.

Tek stacioni i autobusit kishte shumë njerëz që prisnin. Ata bisedonin me njëri-tjetrin, duke treguar gjithë gëzim ku i zuri alarmi. Disa pyesnin se a ishin ndërprerë seancat e kinemave apo shfaqjeve, por asnjëri nuk e dinte me saktësi këtë gjë. Tre autobusë u mbushën njëri pas tjetrit, por turma që priste rritej vazhdimisht. Asnjëherë ai nuk kishte ndjerë kaq ngrohësi në shpirt.

Nga të gjitha anët dukeshin njerëz të armatosur të veshur gjysmëcivilë, gjysmushtarakë. Ajo i vështronte me kureshtje.

— Janë çetat popullore, — i shpjegoi ai.

— Për mbrojtje kundër desantëve?

— Po.

Asaj ju bë qejfi që ju kujtua kjo gjë nga zbori dhe që e përdori në kohën e duhur.

Midis të armatosurve kishte vajza.

— Kurrë neve nuk do të na gjejë askush në gjumë si çekët, — tha ai.

Ndërsa prisnin autobusin, njerëzit qeshnin, bisedonin, bënë shaka. Më tepër se me qytetarë që presin autobusin ata ngjanin me një grumbull njerëzish të afërm që po shkonin diku për të uruar ndonjë ditëlindje apo thjesht për vizitë.

## RRUGËS MES NJEREZVE TË THJESHTË

Atë ditë më kishin thirrur në ministri. Më njoftuan sapo vajta në punë. Ishte ora shtatë e mëngjezit, kurse në ministri më prisnin në orën një të drekës. Unë isha në Qytetin Stalin. Kisha, pra, gjithsejt gjashtë orë. Teorikisht një kohë të tillë e kisha. Po të nisesha me autobus deri në Rrogozhinë dhe pastaj ta vazhdoja udhëtimin me tren, unë do të arrija në Tiranë në orën një e gjysmë. Dhe nga stacioni deri në ministri, duhej dhe gati gjysmë ore akoma. Kështu që s'do të arrija dot. Në fakt kështu dhe ngjau, takimi dështoi; ai nuk u bë, por jo për arsye të maqinës apo për faj të shoferit, por për një diçka tjetër, të cilën po përpiqem ta shtjelloj në këtë tregim.

Meqë me autobus nuk arrija dot, atëhere fillova të kërkoja ndonjë maqinë të rastit. Megjithëse ishte e hënë, si për inat, nga instituti ynë nuk nisej asnjë maqinë për Tiranë. Fillova të interesohesha ndër shokët e mi të ndërmarrjeve të tjera të qytetit. Qyteti ynë është qytet industrial. Kështu që mundësia e vajtjeve të maqinave për Durrës, Tiranë apo gjetkë është gjithmonë reale. Unë e di mirë këtë, ndaj isha pothuajse i sigurtë që do gjeja maqinë. Vura libërthin e telefonave përpara dhe fillova të lëvizija rrethin e pllasmastë.

— A ka atje nga ju, tani shpejt, ndonjë maqinë për Tiranë? — kjo ishte pyetja ime.

Përgjigjet ishin zakonisht të tilla: «Maqina jonë u nis sot në orën pesë të mëngjezit». «Nuk kemi». «Nuk kemi, por pyet... (një emër)».

Në fund, gjeta një maqinë që po ngarkohej me material dhe do të nisej nga ora dhjetë. Tani kisha kohë të mendoja përse më kishin thirrur në ministri. Unë punoja tashmë gjashtë vjet në ekspeditat gjeologjike të naftës dhe gjatë këtyre gjashtë vjetëve kisha bërë dy lutje për transferim në Tiranë, pranë familjes. Më ishin përgjegjur se, për mungesë kuadri, duhet të qëndroja akoma në naftë. Këto dy muajt e fundit, institutit i kishin ardhur dy specialistë të rinj, të specialitetit tim, të petrografisë, dhe në letrën që i dërgova para në jave ministrisë ja parashtroja me të madhe çështjen e transferimit me tezën që «tani kuadri nuk është mangut». «Nga ana tjetër, theksoja në lutje, kam gjashtë vjet që punoj larg shtëpisë, nënën e kam plakë, giyshja është me një këmbë në varr dhe ato kanë nevojë për një njeri që t'u rrijë pranë. Djalë tjetër ato s'kanë. Unë, natyrisht, e kuptoj nevojën që ka nafta për specialitetin tonë, por, ama, kam gjashtë vjet që punoj maleve ku janë e ku s'janë, dhe, besoj, se i lejohet ndërgjegjes sime të jetë e qetë, për të kërkuar dhe unë një vend pune si shokët në ndërmarrjet e Tiranës. Aq më tepër kur kam shtëpinë në Tiranë, kur specialistë të rinj erdhën, etj., etj...».

Pak a shumë këto qenë arësyet e mia, që i paraqitja ministrisë në letrën time të fundit. Kuptohet, të shtruar e të shkruara bukur, vende-vende trishtueshëm, (duhet të bënte efekt), dhe më dukej sikur ajo e kishte bërë efektin, përderisa më thërrisnin në ministri. Zakonisht, kur ministria vendoste të mos transferojë, të përgjigjej me ndonjë shkresë, kurse, këtë radhë, me sa dukej duhej ta kishin patur parasysh lutjen. Megjithkëtë, pranë kësaj ndjenje sigurie, ruaja dhe një ndjenjë tjetër, atë të dyshimit të madh. Më dukej se në ministri mund të më kishin thirrur për të më thënë: «Vërju punës mirë, more djalë (kështu i kishin thënë një shokut to-

në). Ki mendjen tek puna dhe jo tek transferimi. Kërko shtëpi në Qytet Stalin, merri dhe plakat me vete. Mar-tohu e gëzoji dhe ato dhe mos u merr me lutje të kota. Puna jote i duhet naftës dhe pikë. Hajd, të dëgjofshim zënë e mirë!» Këtij arsyetimi që i kundërvihej logjikës sime unë i trembesha dhe kisha kështu, në vetëvete, një dyluftim mendimesh, ndjenjash dhe shpresash.

Kjo ishte gjendja ime kur hipa në maqinë. Shoferi dhe punëtorët që ishin sipër, në karroceri, më bënë zë të ulesha përpara, në kabinë të Zisit, por meqë dhe një plakë donte të vinte me bujtë tek e bija e martuar në Durrës, i thashë shoferit të merrte plakën përpara.

— Më mirë që erdhe me ne këtu sipër, në karroceri, inxhinier. Shoferi ynë vërtet është muhabetçi, por ai është një e do lodhet duke folur gjithë rrugës, kurse ne këtu jemi katër edhe ti pesë, do të kënaqemi dhe rruga s'do të na duket e gjatë, apo jo? — më tha njëri nga punëtorët, sikur donte me këtë të më ngushëllonte për vendin e humbur përpara në kabinë.

— Ashtu është, rruga pa shokë është vdekje, — ju përgjegja unë me një aforizëm, që nuk di se ku e kam lexuar.

Punëtorët më hapën vend në gomën rezervë të kamjonit.

— Do të kesh sedilje të mirë nën vete — më tha më i riu i tyre.

Ata ishin katër vetë. Tre ishin burra të moshuar dhe njëri, ai i sediljes, ishte djalë i ri, më i ri se unë. Ishin të katër punëtorë të pusit të Burizanës, që shpohej diku, pranë Laçit. Kolektivi i kishte lënë të vinin te familjet e tyre të shtunën në darkë dhe gjithë ditën e djelë. Nga e folura kuptoheshin që ishin dy skrapar-linj, një lab dhe i fundit nga Sulova.

— Si vate dasma, o Rakip? — e pyeti njëri nga bu-rerrat djalin e ri. — S'je ngopur me nusen mbrëmë. Të trashëgohesh dhe na i bëj hallall që s'të erdhëm dot në dasmë. Por s'ka gjë, ato adetet tona, si punëtorë, do t'i bëjmë në pus; për martesën tënde e kam llafen.

— Falemnderit, xha Abaz; mirë vate. Na polli një çikë belaja me krushqit, se donin të ma jepnin nusen si qëmoti. Po rinia nuk i la, mirë që kisha me vete edhe ca nga djemtë e ndërmarrjes, ca shokë, se ndryshe do isha bërë emër për gazetë. Megjithëqë, po ta marrësh hollë-hollë, s'kishin se ç'bënin të zestë krushq, se ne, ne të ndërmarrjes, ishim me maqinë, kurse ata me qerre. Ua hodhëm, për nder!..

— Pse mos ua hidhje. Ti u more nusen, i hipe dhe maqinës, kurse ata me qerre donin duvak. Hajde mendje, hajde! Paskan qenë budallenj ata atje tek ju, or mik, — tha xha Abazi, njëri nga ata tre burrat e thyer me mustaqe si të Çaplinit. — Vetëm hap sytë se mos, duke u kënaqur me nuse, harron pleqtë. Duhet marrë dhe ata në qytet tani. Të jetojnë tok me ty dhe me nusen. Mos e bëj si ai i paudhi im që iku e u fut kollovar në shtëpi të botës; — vazhdoi muhabetin xha Abazi.

— Ashtu, he? S'ja mbushe dot mendjen shejtanit të kthehet në shtëpi? Ku e ka ai nderin në botë? — pyeti tjetri burrë i thyer, që dukej të kishte qenë në të ri «kuqo» se akoma nuk kishte filluar të thinjesh.

— Jo, bre, nuk ja mbusha dot mendjen. E dini ç'më tha, more vëllezër? Dëgjoni. «Pse ankohe kot, baba? Ti duhet të kuptosh. Ime shoqe punon në kombinat. Unë punoj në kombinat. Qyteti Stalin me kombinatin janë larg, apo jo? Përderisa Gëzimja (nuses së djalit ja thonë emrin ashtu) ka shtëpinë në Berat, pse të mos jetojmë këtu? Ku është më mirë të punosh, pranë punës apo larg punës?» Mor i pabesë, i thashë, po pse ore, unë që punoj tridhjetë vjet larg shtëpisë ç'kam qenë, budalla? «Jo, nuk ke qenë budalla, por të tillë punë bëje, mundësi tjetër nuk kishe. Kurse unë mund të zgjedh ku është më mirë. Nesër do bëhem me fëmijë. Si do të jetë më mirë për ta, o baba, t'i zgjosh në orën gjashtë-gjashtë e gjysmë, i çon në çerdhe, në Berat e kam fjalën, i hipën pesë minuta autobuzit dhe, tungjatjeta, fillon punën në vaftin që duhet». «Ju po deshët ejani të banojmë bashkë», — shtoi nga xhepi i saj nusja. Aa, të

falemnderit, o nuse e djalit; deri këtu, më tutje jo! Unë nderin e kam në shtëpinë time, atje e ka dhe ky i paudhi im. Kështu u thashë, o shokëni. Gjykomëni në bëra gabim. Por, ke parë ti, më thanë që s'kisha të drejtë. Më mirë do ishte të veja të jetoja me gjithë plakën tek ata. Unë më një qoshe, plaka ime në tjetrën dhe plaka e nuses më atë qoshin atje, të bëheshim kësisoji, azil pleqsh. More, mik vëllai, po unë e di që shteti e ka ngritur në Lushnje, nuk ka nevojë në Berat për aziil pleqsh. Ja, kështu na ngjau. Unë mora flakë, si ai pusi i Marinës, e mban mend Salo? I shava e i ngava ku nuk ngitet dhe ika. Shyqyr që filloj sot punën, se ndryshe për një muaj nuk do e harroj atë të djeshmen.

— Po, Abaz, po. Në punë harrohen të gjitha, dhe të mirat dhe të ligat, — tha plaku kuqalash që ja thonin emrin Salo. Dhe ai më tej vazhdoi bisedën, që po kalonte nga njëri punëtor tek tjetri si një stafetë e shpejtë. — E di pse erdha në Qytet Salin pardje, o inxhinier? Nga ta dish ti, nuk e di. Erdha për djalin — m'u drejtua mua plaku kuqalash. Ishte një burrë i gjatë fort. sa dhe, tek ishim ulur, koka e tij vinte një pëllëmbë mbi timen, kur unë jam një metër e tetëdhjetë i gjatë. Era e qëllonte mirë dhe në qafë dalloje rrudhat e shumta që e tregonin se ishte burrë i vjetër, ndryshe flokët i kishte pa asnjë thinjë. Ai nuk priti ta pyesja unë për djalin, por vazhdoi më tej:

— Kam dhe unë një djalë, jo të vetëm si Abazi, por djalin e madh, se kështu shyqyr i kam nja katërbëdhjetë fëmijë, një batalion. Më shumë djem se vajza. E që thua ti, inxhinier (unë e kuptoja pse më drejtohej mua, shokët e tij në maqinë me siguri e dinin historinë), është i paudhë, ai djali im. As për shkollë, as për punë. As për vete, as për ne. Ishte djali i parë dhe e lamë azat, si atë kalin që e lënë pa fre. Unë puseve, më të katër anët e Shqipërisë kam punuar, kthehem një herë në dy javë në shtëpi. Por siç e di ti, i martuar je, o inxhinier? Jo, e po do ta dish, do ta mësosh kur të martohesh, mëma kujdeset më shumë për fëmijën në

gji, se sa për atë që ecën me këmbët e tija. Dhe shtoheshin kalamajtë, kurse djali i madh rritej dhe harrohej. Si ta them, jo se harrohej tamam, se bukën e hante ai më të madhe se timen, por nuk e kish njeri në zap. Or po, për nder, në punëtorët e shpimit jemi miq për kalamajtë. Mik, si ai që vjen me bujtë dhe ikën. Kështu jemi dhe ne. E di ç'më ka ngjarë? Një herë njëri nga fëmijët, i shtati a i teti nuk më kujtohet, sa kish filluar të fliste, belbëzonte akoma, nuk thosh dot as «k» as «g» dhe kur erdha në shtëpi më thirri «xhaxhi». Nuk më njohu dhe kish hak, kolopuçi i babit. Kisha dy muaj rresht në atë pusin e L-8, e kujton Muço? (ky që iu drejtua ishte punëtori i tretë, plak, që s'kish folur asnjë fjalë deri tani) e mban mend, kishim rënë në avari dhe nuk iknim dot. Jo do ta ndreqim sot, jo nesër, ditët iknin dhe fëmijët, ata që kuptonin malloheshin, kurse të vegjëlit na harronin. Po na kish marrë një mall për shtëpinë që nuk thuhet dot me gojë.

Shoferi po e ngiste më shpejt maqinën. Era frynte më e fortë dhe ne pa e kuptuar ngjiteshim më fort njëri pranë tjetrit të ngroheshim. Xha Salua e ngau më tutje llafin.

— E, ta kisha fjalën te djali i madh, inxhinier. E ka humbur fare yzengjinë, ka qejf të livadhisë si do ai. Mëmën, time shoqe, s'para e dëgjon, mua po nuk ma ka frikën se një herë në dy javë vete në shtëpi. Do thuash ti dhe të tjerët, punëtorët e shpimit kanë djem, por nuk u janë bërë kështu! Mbase; jo mbase, por ashtu është, xhanëm. Këtë vit e futa në punë, në fabrikën e tullave, por kam frikë se mos më turpërojë, para njerëzve, para partisë. I trembem turpit me të. U thashë atyre të degës ushtarake ta merrnin ushtar, nuk pranuan. «Ka ligje shteti, xhaxha. Është i ri djali, sapo ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjeç». Po merreni, ore të uruar se është burrë rrufjani; ja, pashaportën e ka marrë. Merreni se ushtria i bën njerëz edhe më të pagdhendurit se ky. Merreni. Një çanak më shumë nuk i rëndon shtetit. «Jo, — më thanë prapë; — nuk lejohet. Ti përpiqu ta edukosh, xhaxha. Ç'ta edukoj, kur unë

jam larg. Të isha pranë tij, dija unë si e rregulloja. Po ata prapë më thanë. Përderisa është në punë le ta edukojë kolektivi. Sikur ngenë e tij ka kolektivi. Sikur e njeh atë kryetarin e degës, o inxhinier, të kam parë nja dy herë me të? — më pyeti papritur mua.

— Po, e njoh. Kanë qenë shokë, partizanë me tim atë. Babaj u vra dhe vdiq në duart e tija, — ju përgjegja unë.

— Po pse s'thua, or inxhinier, që e gjeta kyçin e burimit. Do ma rregullosh këtë punë, ë?

— Nuk jam kundër t'i them, por kam frikë se mos ti e zmadhon ca, me atë djalin tënd, o xhaxha. Mbase ai shoku i degës ka patur të drejtë kur të ka thënë se e rregullon kolektivi.

— A, ma hëngërt shpirtin me kolektivin. Kolektivi është gjë e madhe, unë e di këtë. Bilez, kolektivi është dhe më i fortë se gjyqi; ja, para ca kohe atje tek ne i bashkoi një burrë e grua që deshën të ndaheshin. Por atë djalin tim nuk po e bije dot në vijë, kurse ti thua ta bien bota.

— Xha Salo, xha Salo, këtu gabove rëndë. Kolektivi është gjithshka. Si guxon ti ta quash veten më të fortë se kolektivi? — tha dhëndrri i ri.

— Ti ke hak, se kolektivi të bëri me nuse, o xhan. Sikur të mos kish qenë ajo maqina e kolektivit, zor se e merrje nusen, ashtu siç deshe, zotrote. Kurse kolektivi tim biri s'ka ç't'i bëjë. Përderisa unë, i jati, nuk ia mbledh dot, ç'do t'i bëjë kolektivi? Për tim bir unë jam kolektiv e shkuar kolektivit.

— Jo, do ta bëjë, ke për të parë që ka se ç'i bën. Ata të fabrikës së tullave, punëtorët e atjeshëm do ta bëjnë njeri.

— Ashtu thonë ata, vërtet ashtu thonë. Kur u thashë atyre të bashkimeve profesionale atje në fabrikë, «ma lini ta marr punëtor me vete në pus» e dini ç'më thanë? «Xha Salo, na ofendon kolektivin, pse ne çfarë jemi, nuk jemi punëtorë këtu? Apo vetëm ju të shpimit jeni punëtorë! Do ta edukojmë ne!»



— E sheh; atëhere ç'kërkon akoma?

— Ushtrinë dua! Ajo i rregullon shpejt.

— Tënden që tënden, o Salo, — i tha xha Abazi.  
— Dëgjoji djemtë!

— Ka për ta rregulluar kolektivi, — shtoi dhëndrri.  
— Ja, unë u martova dje, apo jo? Pse vij atëhere sot në punë? Dhe unë e kuptoj që po të rrija nja pesë ditë me nusen, ishte punë e bukur. Por ja, unë nxitoj të shkoj tek shokët e t'u them; «more vllazër, dua ta marr gruan këtu në pus, a më bëni dot një copë vend në barakë?» Me siguri do më bëjnë.

— Ou, ku të ka vajtur mendja! Ju pjell ajo mendja ju të rinjve sot, — tha xha Abazi. — Tridhjetë e kusur vjet kam që punoj puseve të naftës dhe s'më ka shkuar ndonjëherë mendja ta merrja plakën me vete. Po mirë, ja e more, ç'do të bëjë ajo në pus?

— Si ç'do të bëjë? Do jetojmë tok. Në pastë ndonjë punë andej nga kuzhina, do ta fus atje të punojë. Por, në mos gjetë vend, atje në bujqësi le të vejë në kooperativën e Burizanës, që e kemi pranë pusit. Fshatare është dhe ajo, nuk i përton punës.

— A e qasin? Pa po qe se e qasin, boll të jetë me ty ajo, pa dhe në majë të Tomorrit punon, — tha xha Salua.

— Nuk e di. Nuk e kam menduar që mund të mos e qasin, — u përgjegj dhëndrri. — Po pse të mos e qasin, me ditë-pune është dhe atje, shqiptare është, fshatare është. Ç'do të kërkojnë akoma?

— Mirë e ka. Pse të mos e qasin? Bukur e ke menduar. Kushedi, pas teje, mbase i marrin dhe të tjerë kështu gratë. Por, në punoftë në kooperativë do të jetë larg nga pusi. Nesër, pasnesër, mbetet me barrë dhe do ta ketë vështirë të vejë arave matanë lumit, se pusi është më këtë anë të lumit. Ti, sado larg të jesh nga puna, nga pusi, e bën, je djalë, kurse ajo është femër, e rënduar do të jetë. Po, po; më mirë të zesh shtëpi në fshat, — përsëriti xha Abazi, si e peshoi mirë mendimin.

— S'më kish vajtur mendja, xha Abaz, pa po, ashtu do bëj. Të falemnderit. Do marr me vete edhe sekretarin e partisë në pus që t'i thotë kryetarit të kooperativës atje, të më gjejë ndonjë dhomë. Do na qasin, se shqiptarë ata, shqiptarë ne. Më vjen keq për pleqtë që nuk i marr dot me vete. Janë pleq e duan rehat tani, nuk janë mësuar ata të lëvizin si ne, si ata zogjtë shtegëtarë që sa vjen behari e ndërrojnë folenë. Ç't'i bësh, o vëllezër, dikush duhet ta bëjë edhe këtë punën tonë. Në mos ne, të tjerë. Shqiptar do jetë dhe ai tjetri, që do ta bëjë punën time. Bir nëne do jetë, — i vuri pikë bisedës dhëndrri i Sulovës.

Kjo ishte filozofia e këtij udhëtimi. Dikush duhet ta bënte edhe punën e tyre, një nga punërat më të vështira që njoh. Po kështu dikush do ta bënte edhe punën time. Unë kërkoja transferimin, po a kishte njerëz të më zëvendësonin tani? Jo, se në fakt dhe ata dy petrografë që erdhën, nuk do të bëjnë punën time, ata do të kenë temat e tyre. U shtuan detyrat e institutit, u shtua tematika, u shtuan dhe njerëzit. Kjo nuk do të thotë që u shtuan njerëzit dhe u pakësua puna. Përkundrazi ajo u shtua proporcionalisht. Unë, a kisha arësye të transferohesha? Po këta punëtorë nuk kanë arësye të transferohen? Kanë tridhjetë vjet këta burra të motuar që punojnë larg shtëpive, larg prindërve, grave, fëmijëve. Po kështu do ta ketë dhe ky dhëndrri i ri optimist, larg prindërve. Pse, mos vallë vetëm unë kisha nënën dhe gjyshen, po këta nuk kishin nënat dhe njerëzit e tyre? Por asnjërit prej tyre nuk i shkonte më mendje, qoftë dhe tani gati në pleqëri, transferimi!

Më bëri përshtypje gjatë këtij udhëtimi burri i tretë, i plakur, që e quanin Muço. Ai nuk tha asnjë fjalë nga ana e tij, vetëm aprovonte ose jo me kokë të tjerët. Pse heshti ky plak gjatë gjithë kohës? Ne po i afroheshim Vorës. Këtu unë do të zbrisja, ndërsa ata do të shkonin në drejtim të Laçit, në Burizanë. Nuk dija si ta pyesja atë plakun, si ta zbuloja të vërtetën e tij. Pse nuk tha asnjë fjalë gjatë këtij udhëtimi? Mora kurajo dhe e pyeta:

— Po juve, xhaxha, mos ju ka ngjarë ndonjë tak-sirat? Mos ju ka vdekur njeri? Më falni.

— Larg qoftë, o bir. Jo. S'më ka vdekur njeri. Gjithë mirë i kam dhe djemtë dhe vajzat, si të martuarit ashtu dhe të pamartuarit. Dhe plakën mirë e kam. Por vetëm se ky është udhëtimi i fundit, që bëj me maqinën tonë të shpimit. Sot më lidhën pensionin. Vete sa të ndahem me shokët. Mund të ndahesha dhe të shtunës, por shkova me shpresë se në qytet, po t'u kundërshtoja, nuk do të më nxirrnin në pension. U thashë atyre të këshillit të bashkimeve profesionale, «Më jepni rrogën vetëm sa të pensionit, asnjë lek më shumë, por më lini të punoj akoma». Nuk deshën. «Nuk bëhet kjo punë, o xha Muço, boll punove. Duhet shplodhur tani. Dyzet e pesë vjet që punon, ku do të vesh akoma?» — U kundërshtova, «Mor po, e kam filluar i vogël punën. Ndaj mos shihni vitet e punës, as moshën, por takatin, fuqinë që kam». Nuk deshën që nuk deshën. Ua kishte mbushur mendjen vajza. E kam instruktore në Komitet të partisë. Atë e ka yshtur plaka, kurse vajza u kish thënë, që të mos më linin në punë më, atyre të komitetit. Ja ndigjojnë llafin.

— Po, shumë mirë, xhaxha. Rrove, u nderove, tani, pusho, — i thashë unë.

— Ah, jo biro, jo! Ja, do të punosh vetë dhe kur do të vish në moshën time do ta shoç. Të punosh në mes të shokëve, në mes të punëtorëve të shpimit dhe të kërkosh të dalësh në pension? Nuk bën vaki. E kupton vetë ti se je inxhinier, kur të punon këmba e dora e kam llafin, se në qofsh zaif nuk ke ç'punon më. Por po të jesh mirë si unë, vetëm me të pahirë të nxjerrin në pension. Janë njerëz të mirë, punëtorët e shpimit, vëllezër e shkuar vëllaut. Kurse ti nuk e kuptove pse nuk thashë asnjë llaf. Këta shokët, Salua me Abazin, sikur e bënë me fjalë, nuk më lanë të qaja hallin tim, nuk më lanë të më shkante mendja tek pensioni. Bile edhe ai dhëndrri i ri e ka marrë këtë adetin tonë punëtor. Edhe ti do ta marrësh, inxhinier. Dhe kur ta marrësh

këtë adet të mirë, nuk do t'i lesh të tjerët të dërmojnë veten me hallet dhe me brengat e tyre, por do t'i marrësh hallet e tyre për vete, si puna e këtyre muhabeteve të sotshme. Nuk të iket nga shokët e punës, nga nafta. Për gjithë jetën, derisa të vdesish, nuk të iket. — Këto ishin fjalët e vetme që tha në këtë udhëtim pensionisti naftëtar.

... Unë kujtova për të fundit herë ministrinë, transferimin dhe më erdhi rëndë që nuk i qava dhe unë hallet e mia me këta punëtorë, për t'i lehtësuar brengën e ndarjes nga puna plakut pensionist. M'u duk sikur me atë lutjen time ministrisë i thoshja që më ishin mërzhitur këta njerëz, sikur kisha mall për auditoret e Universitetit. Kurse kjo nuk ishte e vërtetë. Unë i doja këta njerëz, por atë ditë kuptova dashurinë e tyre për njeriun, sa e donin ata naftëtarin plak, xha Muçon, dhe sa i donte pensionisti ata. Dhe e kuptova, e ndjeva mirë, që pas këtij udhëtimi unë do të udhëtoja dhe vite të tjerë me këta njerëz, por kurrë me këtë shkak që udhëtova sot.

## NDËRRUESI I ÇATIVE

Ju e njihni zanatin e ndërruesit të çative. Është një zانات më vete, ndoshta është më i vështirë se sa ai i muratorit. Ty të pikon diku çatia? Në qytet të shërben komunalja. Po në fshat? Ka edhe në fshat zanatçinj të pikave.

Në fshatin malor S., usta i pikave ishte Metja. Bujk, si të tjerët, por edhe murator. Ti kishe një pikë në çati? Vinte Metja e ta zinte dhe të kërkonte, sipas rastit, dhjetë lekë më shumë a më pak, sepse, «a ka punë që nuk shpërblehet?» — thotë Metja.

Në dimër e qërtuan nja dy-tri herë në kryesi, se punonte privat. Metja, nga inati, nuk shkoi më gjëkundi. O! sa mirë e dinte Metja, se do të vinte prapë një pranverë e butë, se dëbora e çative do të shkrinte! Dhe pranvera erdhi. Dëbora nisi të shkrijë, ujërat rrodhën nga strehët, por gjetën edhe shtigjet e vjetra në për plloça. Tavanët u mbufatën nga pikat, u zverdhën, suvaja nisi të bjerë. Nën pika vunë kova, tepsi... Por pikat rridhnin dhe askush nuk guxoi të hipë e t'i zërë vetë. Se nuk është njëlloj si të hash bukë me djathë dhe të zesh një pikë! Duke dashur ta zësh, mund të hapësh edhe dy të tjera. Ca më keq e patën ata që kishin pika afër oxhakut. Të pikonte uji në vatër dhe ec të ndizje zjarr...

Kështu, u kujtuan prapë për Meten dhe filluan t'i luten. Kryesia bëri një sy të verbër. Sepse, fundja, edhe shokët e kryesisë kanë çati, apo jo? Derisa kanë çati, kanë edhe pikat! U duhej edhe atyre Metja. Dhe ja nisi prapë usta Metja të hipë çative. Zë një pikë këtu dhe për çudi, hapet një tjetër, në anën e kundërt të çatisë. Gojët e liga pëshpërisin se Metja xheku lëshonte vetë nga ndonjë pikë që të mos i mbyllej burimi. Por aq i bënte Metes për këtë pëshpëritje. Oxhaku i tij e conte tymin drejt!

Po, papritur, Metes i doli një shemër. Një shemër i zoti dhe që, për çudi, i zinte pikat pa para! Bile, i zinte më mirë se Metja, se kur vinte dorë ai, kishin mbaruar një herë e mirë pikat në çati!

Kush ishte ky njeri?

Një muaj para se të mbushte moshën e pensionit, gjeometrit Isa Vrapit i ndodhi një fatkeqësi. Po kontrollonte asfaltimin e një rrugice anësore në qytet. Një makinë riportabël po vinte me shpejtësi nga larg. Befas, nga kthesa i doli përpara një skodë e ngarkuar me shtylla të centrifuguara. Zisi, që kishte një grua të sëmurë brenda, u kthye në rrugicën që të mos përplasej. Parakolpi e goditi gjeometrin dhe e hodhi tej, rrëzë kanalit. Tri brinjë të thyera, plagë, kontuzione. Për qime shpëtoi nga vdekja. Dhe, ai njeri, që s'kishte menduar kurrë për pension, doli në pension nga halli.

Bashkëfshatarët në fshatin S., ku ai s'kishte shkelur prej vjetësh, mendonin se i kishte prirë fati. Kishte qenë në njësitet territoriale. Mbas lufte zuri punë, «pas rrugëve», siç i thoshin atëhere. Njeri pa shkollë, po i zgjuar e me prirje të natyrshme për ndërtime, i mësoi me ngulm gjithë zanatet e ndërtimit, kreu ca vjet shkollë, u bë asistent gjeometër, pastaj edhe gjeometër. Kishte drejtuar ndërtimin e objekteve të vështira në qytet.

Dhe, për çudi, vitet dhe bredhjet nëpër shumë kantiere ndërtimi nuk ja thelluan aspak rrudhat. Flokët i kishte ende të zeza, fytyrën të kuqërreme si të njeriut të shëndetshëm. Ishte njeri hokatar. Një herë ishte në

9-10

lulishte me një moshatarin e vet, njeri që kishte punuar gjithnjë nëpër zyra dhe s'e kishte vrarë kurrë kockën. Por ishte rrudhur e ishte plakur aqë shumë sa të thoshe se i mungonte vetëm shkopi dhe tespijet. Në tavolinë erdhi edhe drejtori i ndërmarrjes së tij.

— Shoku drejtor! Njihu me babanë tim! — i tha Isaj.

— Babai? Gëzohem shumë! Duket që edhe ti i ke ngjarë nga tiparet! — tha drejtori.

Këtë histori ja kishte ënda ta ritregojë derisa u bë si anekdotë. E kishte këtë dobësi. — I pëlqente të dukej i ri, — dhe dukej vërtetë, — e të pyeste të njohurit e rinj: «Sa vjeç të dukem unë ty?»

Dhe ja! Ky njeri që e mendonte larg e larg pensionin dhe pleqërinë, pasi u dergj disa muaj në spital, doli që aty i sakatuar në trup. Vendet e shembura i dhimbnin dhe nuk flinte dot në krahun ku kishte brinjët e thyera. Por, më tepër i sëmbonte shpirti. Kishte një tronditje t'atillë sa nisi ta urrejë edhe trupin e vet, dikur muskuloz, e tani të flashkët e të ngjallur nga të ndenjurit, e me tule të bardha. Nuk i pëlqente të shihte fytyrën e vet: dikur bojëbronxi, të ashpër e të reshkët dhe tani me faqe buçka e me qime që i mbinin shpejt mbi lëkurën e zbetë.

Kishte një brengë të fshehtë, një dhimbje të habitshme diku, as ai s'e dinte se ku, brenda tij. Punëtorët vinin e vizitonin. Nuk i pëlqente që ata e shihnin ashtu, të flashkët, të ngadalshëm e të ngjallur, ndenjuri në kolltukun e kuq, delikat si një vazo kristali që mund të thyhej nga goditja e parë.

Dhe atëhere e zuri malli për fshatin e vet të largët e të bukur në mes të maleve. O! ai e quante fshatin e vet ndryshe nga çdo fshat tjetër! Kori ja e aheve vinte deri në prag të shtëpive dhe shushurinte gjithë natën me dhimbje nga erërat. Ajri ishte i rrallë, po pishat dhe bredhat e pyjeve të vjetra dhe kurora e dendur e aheve e kishin situr dhe e kishin mbushur me aroma. Dhe pastaj burimet... burime mali të fshehur në mes të

fletëve në pyll, korije me shurupuqë guri që kishin zënë myshk të blertë nga vitet, korije të mbuluara me çati të pjerrëta dhe me postafe prej druri... Të gjitha këto i erdhën ndër mend si një vegim i vjetër që të trishton dhe të bën të dridhesh nga malli... U shkroi kushërinjve të vet nëse mund t'i lëshonin një dhomë me qira për nja dy muaj. Ata u fyen dhe i shkruan se paskësh harruar mikpritjen e fshatit; kështu, në fillim të majit, erdhi në këtë fshat të largët. Dhe e ndjeu se po ndodhte një mrekulli me organizmin e tij: plagët ju shëruan, lëvizte e shëtiste sikur s'kishte ndodhur asgjë!

«Po të kisha mbetur në atë kolltukun e kuq, ku më përgjonin që të mos lëvizja sikur isha një fëmijë në djep, do të isha bërë ulok me siguri», —mendoi.

Po e kuptonte, se çdo gjë që kishte të bënte me aksidentin, kishte marrë fund! E brente pendimi. Pse u nxitua, xhanëm, të dalë në pension! Veç, tashmë ishte vonë. S'mund të kthehej e shkuara.

Filloi të punojë rreth shtëpisë ku banonte. Ngriti një avlli që ishte rrëzuar. Pastaj ranë shira të nxituara siç bien vetëm në verë, shira që lënë gjurma të potershme, po që avullohen po aq shpejt sa edhe vesa. Pylli ndillte gjithmonë shira të tilla. Njerëzit e ndjenë trokitjen e vjeshtës në portë. U hapën plagët që linte Metja pa shëruar! Dhe u hap përsëri punë për Meten. Por, Isai, posa e pa Meten hipur mbi çatinë e murme dhe mori vesh për çmimet e tij, u murrëtye. I tha të kushëririt:

— Ti mos u mërzit. Meten mos e thirrë, se çatinë do ta ndreq unë!

— Ti! — u çudit kushëriri. — Si dashke të hipësh në çati pas gjithë atyre që pësove? Si do t'i ngresh e do t'i lëvizësh pllloçat e rëndë. Jo, për besë, nuk të lë kurrë!

— Ti nuk je doktor, apo jo? I zoti e di mirë se ku i pikon çatia! Nuk do ta lëmë Meten të majmë zverkun mbi çatitë tuaja! — Dhe hipi në çati. Shtëpia e kushë-



ririt ishte e lartë, sa një katana, në rrëpirë. Të merrte frika të vështroje poshtë nga strehët e saj. Usta Metja për këtë çati kërkonte si frëngu pulën, se, «pa shko e hipë zotrote aty? — thoshte. — Që poshtë dukesh sa një harabel, po edhe aty sipër të duket vetja sikur je harabel dhe ja... do të fluturosh!..»

Të djelën, në klub ku mblidheshin gjithë burrat, Isai tha:

— Kjo që ndodh tek ju është turp! Unë i them shfrytëzim këtij, or tungjatjeta! Si ore e lënkeni Meten të trashë qafën me paratë tuaja? E pse? Për një pikë! Në s'qenka e zonja kooperativa ta bëjë këtë punë e të ngrejë një skuadër muratore, le ta zgjidhë këtë punë pas një viti, se këtë mot do t'ua zë unë. Dhe, në i zënca më keq se Metja, të më pështyni të gjithë. Do t'i shpallim luftë shfrytëzimit privat, apo jo? — tha duke qeshur. — Sot po hapet ndërmarrja për zënjen e pikave.

Kështu, usta Metja mbeti këtë vjeshtë pa punë. Vitin tjetër, kooperativa me siguri do të ketë ngritur një skuadër muratorësh. Dhe Isai nuk do të heqë dorë nga puna, që i jep gëzim dhe kënaqësi të vërtetë.

AJO ZBRITI SHTEGUN MË E LEHTË, MË  
E GEZUAR

— Si do t'ja bësh? — e pyeti Tixhja të kushërirën, që ecte para saj në shtegun e ngushtë buzë arës me grurë të korrur.

— Të mitë nuk binden menjëherë, — foli pas një heshtjeje të gjatë Semi.

— Ti e di që unë një herë u veshja si qytetare, por tani më vjen zor.

— Përse?

— Ashtu kot. — Dhe Tixhja qeshi.

Semi heshti, ju kujtua e kushërira një vit më parë, e veshur me një fustan të bukur në ngjyrën e limonit, ju kujtuan dhe fjalët jo të mira që u përhapën menjëherë në fshat për të. Por ja, pas një viti, në mbledhje, të gjitha gratë e fshatit ngritën dorën dhe aprovuan vendimin për ndërrimin e veshjes së rëndë fshatare me rrobe pune të lehta, me ato rrobe që vishen mësueset, mamia.

Me gratë e fshatit e kishte ngritur dorën edhe ajo. Semi kishte vënë re se e kushërira, për të aprovuar, qe ngritur në këmbë dhe vështronte gratë e ulura me ca sy që shkrepëtinin nga gëzimi. Semi e kuptonte që inisiativa e gruas qe një ndihmë e madhe për t'u shkëputur nga diçka e rëndë, po tani që po i afrohej shtëpisë,

nisi ta pushtojë ndrojtja. Ajo, vërtet e priti me gëzim vendimin që posa patën marrë, po që ta vinte në jetë nuk' qe e lehtë për të. I dukej se midis sallës ku u bë mbledhja dhe shtëpisë së saj qe vendosur një plis vigan i shkëputur nga erozionet dhe për ta përmbysur atë do të duhej ndihma e dhjetëra duarve.

Në radhë të parë atë do ta ndalonte i vjehri.

— Shih, shih, — i kishte thënë ai dikur së resë, kur kjo qe kthyer nga një mbledhje, — ndonjë ditë do t'ju heqin edhe brekushet! — Dhe kishte qeshur me zë për një kohë të gjatë.

Semi qe dredhur e tëra nga fjalët, nga e qeshura, nga dhëmbët e verdhë e të fortë të plakut dhe qe futur në shtëpi që të mos e dëgjonte më se e dinte që ai përpiqej të mblidhte veten për të vazhduar më tej shakanë. Natën kishte qarë dhe për një kohë nuk kishte dalë në mbledhje. Po shoqet e thërrisnin gjithnjë dhe ajo sërisht shkoi me to.

Po ja, koha erdhi për të hequr brekushet... Semi qeshi nën buzë dhe vuri re se e kushërira diç ligjëronte.

— Unë e kam fundin terital, a si i thonë, që më solli motra e Avniut dhuratë, kam dhe trikon. Ty po të jap fustanin dhe shkojmë bashkë që nesër.

— Mirë, — ju përgjegj Semi pa patur mendjen aty. E kushërira i mbështeti krahun në sup.

— Mos u ndaj nga ne Semi. Le të zëmërohen pak pleqtë, ata prapë do të gëzojnë.

— Unë do të vij, por nuk dua që pleqtë të hidhërohen. Do të mundohem t'i bind, — u përgjegj Semi dhe pa si e habitur tufën e verdhë të flokëve, që dilte nga shamia e re dhe e bardhë e kushërirës.

Prapa tyre, në fushë, lëkundeshin kokat e mbështjella me shami të bardha të grave, që ktheheshin nga mbledhja në atë mbrëmje të vakët korriku.

Semi u shkëput nga krahu i Tixhes. Ajo eci përpara, në të përpjetën e shtegut buzë arës. Plisat e dheut, të tharë nga vapa, thërmoheshin nën këpucët e saj prej

gome. Ecte dhe mendonte kjo grua rreth tridhjet e pesë vjeçe, me trup të vogël, vetulla të drejta dhe sytë në gështenjë të errët, që përqëndroheshin të vëmendshëm. Të folurit e kishte të shtruar dhe buzët e fryra si prej fëmije qenë gjithnjë të kuqe me gjithë moshën, lindjet dhe punët e rënda të gruas fshatare. Punëve u bënte ballë me shkathësi dhe fshati e nderonte për këtë. Por në shtëpi, sipas zakoneve, nuk i qe dëgjuar fjala, sepse i vjehrrri grindej shumë shpesh në kurrizin e saj. Plaku vetëm një herë e përgëzoi, ditën që hynë në shtëpinë e re, të stolitur me plaçka brenda dhe me lule jashtë. Pastaj, sërish filloi të grindet; kurse e vjehrra, shumë më e re nga i shoqi, sikur qe përtërirë kohët e fundit, faqet i qenë mbushur dhe i vinte rrotull shtëpisë duke uruar çdo ditë e më shumë Partinë dhe shokun Enver, që e bënë kaq të begatshme jetën e fshatarëve. Herëherë, ajo vinte në mbledhje dhe kur kthehej, trazonte zjarrin me mashë e menduar. Pastaj i fliste plakut me zë të ulët. Por për të fjala e plakut qe ligj. Këtë e dinte Semi. Ajo e dinte gjithashtu se mendimet e pleqve, që kishin ndikuar gjithnjë në jetën e tyre, ishte vështirë t'i ndryshoje. A nuk luftoi muaj me radhë bashkë me të shoqin, kur fëmija i vogël u bë një vjeç dhe vendosi të fillonte punën në kooperativë? Ajo vërtet filloi nga puna, por sa e mundonin fjalët e shumta të plakës, që lodhej me kalamajtë! Dhe fjalët mbaruan vetëm atëherë kur u hap çerdhja në kooperativë. Kurse për veshjen ç'do të thoshin, vallë, pleqtë?

Tani Semi do të fillonte përsëri nga e para për t'i bindur se duhej të ndryshonte akoma shumë jeta e saj. Nevojën e këtij ndryshimi e kishte ndjerë edhe më parë, jo të qartë e të përcaktuar, por si një dëshirë të zjarrtë për të kaluar në një jetë më të denjë. Sepse forca e madhe që ndriti shkollën, çerdhen, dhjetëra e dhjetëra shtëpi të reja në fshat, që solli traktorin, linjën elektrike, radion, po e ushqen me dritë edhe shpirtin e Semit, atë shpirt që kishte filluar të ndrydhej dhe

të plogështohej nga jeta e rëndë dhe nga besimi i tepëruar ndaj fatit.

Prandaj Semi e tha fjalën «nesër» plot shpresë.

Kur ju afrua shtëpisë, e kushërira e ndali.

— Prit, — i tha, — të të sjell fustanin.

Dhe rendi drejt shtëpisë së saj. Kur u kthye, mban-te në dorë një shami të kuqe me lule. Me të kishte mbështjellë fustanin e verdhë të hapur të saj, atë fustan që Tixhja e kishte veshur vetëm një herë, kur që nisur nuse, dhe e kishte bërë të qeshë gjithë fshatin. Ajo ja dha kushërirës bohçen dhe diç i foli, duke e parë me sytë e saj të qeshur në ngjyrën e detit; pastaj u fut në jonxhën e rritur, që Avniu, i shoqi, e kishte mbjellë në sheshin para shtëpisë.

Semi mori të përpetjen e kodrës vetëm.

Para portës së shtëpisë së saj po e prisnin disa nga shoqet e brigadës.

— Që nesër ne do të vemë në punë të veshura ndryshe, — i tha njëra.

— Edhe unë, — u përgjegj ajo dhe hyri brenda e vendosur dhe e gëzuar.

\* \* \*

E vjehrra po vadiste domatet në kopsht.

— Ç'u bëre! — i bërtiti ajo.

Semi u vrejt dhe menjëherë pa rrotull për ta lënë diku bohçen.

— Tani sapo mbaruam, — ju përgjegj.

— Të thashë të mos shkoje. Babai u zemërua.

Semi nuk foli.

— U bëre si ato që kemi qeshur, «hop në shkop», — vazhdoi vjehrra.

— Përse nënë!

— Duhet medoemos të dalësh e para? Ti je me tre fëmijë dhe duhet të mbledhësh mendjen, se të presin punët e shtëpisë.

Semi u afrua dhe i mori së vjehrës kovën nga dora e filloi të vadiste e menduar.

— Unë kur dal, përpiqem t'i bëj të gjitha, — foli me zë të ulët.

— E di; por punët e shtëpisë dhe fjalët e botës nuk mbarohen kurrë.

— Përse na duhen fjalët e botës, — u përgjegj nusja dhe zbrazti kovën në rrënjët e domates. Toka e shkrifët dhe e zezë, tek thithte ujët lëshonte nga poret e hapura avuj të ngarkuar me atë aromën karakteristike, që ndjehet vetëm në verë kur laget dheu i thatë.

— E more vesh? — i tha e vjehrra e zbutur kur Semi mbaroi vaditjen.

— Çfarë?

— Zenepen e rrahu i shoqi.

— Zenepen?

— Po, shkoi në mbledhje pa lejën e tija.

Semi u drodh.

— Po ajo ç'bëri? — pyeti.

— Iku nga shtëpia.

— Mirë ka bërë, — foli Semi si e çliruar nga një ankth. — Mos harro se i shoqi ka qenë bir kulaku.

Vjehrra diç mërmëriti me përçmim dhe koka, me atë ballë të lartë dhe të sheshtë, filloi t'i dridhet sipas zakonit.

Semi la kovën në një anë dhe ju afrua.

— Ç'ke, nënë?

— Asgjë.

Semi mezi dallonte sytë e vegjël të plakës nën vetullat e trasha, sepse dielli kishte përënduar tërësisht.

— Kam një fjalë, nënë.

— Folë.

— Do t'i heq këto rrobe, qysh nesër.

— Çfarë do të veshësh?

— Fustan.

Sytë e vjehrrës shkrepëtinë.

— Ti jo.

— Po nënë, kështu vendosëm të gjitha shoqet në mbledhje. Dhe unë i mora Tixhes fustanin.

E vjehrra mbylli sytë dhe filloi të lëkundet e tëra. Nofulla e poshtme me dhëmbët krejt të vëna i ra poshtë. Ajo e shtrembëroi pak dhe foli sikur vërshtëllente:

— Në qoftë se do të më marrosësh bashkë me plakun nga turpi!

Semi, e tronditur, i kapi krahun ta mbante, por ajo, ja shtyu dorën.

— Do të veshim të gjitha fustane, moj nënë, — vazhdoi Semi për ta qetësuar.

E vjehrra nuk ju përgjegj. Ajo hyri në shtëpi. Semi e pikëlluar mbushi gjymet që qenë afër pusit. Disa caste më vonë edhe ajo u fut në shtëpi.

— Mirë mbrëma, — i tha të vjehrrit dhe të shoqit, që rrinin këmbëkryq në të dy anët e vatrës së terur. Ata bënë sikur nuk e dëgjuan dhe Semi, pasi i hodhi një sy së vjehrrës që shtronte sofrën, filloi nga punët e tjera.

Fëmijët u lanë, hëngrën, u vunë në gjumë, darka u shtrua dhe u ngrit, por as i shoqi, as pleqtë nuk hapën gojën për të thënë qoftë dhe një fjalë.

Semi, e lodhur dhe e pikëlluar, përpiquej të takonte vështrimin e të shoqit, por ai radhitte fletët e duhanit syulur. Më në fund, vendosi vetë ta hapë fjalën:

— Në mbledhje..., — tha dhe nuk vijoi më tej sepse i vjehrrri u koll aqë keq sa mend u mbyt. Pastaj u ngrit shpejt e shpejt dhe doli jashtë bashkë me plakën, që diç i pëshpëriste. I shoqi gjithashtu u ngrit. Semi shoi dritën në dhomën e zjarrit dhe u nis për t'u çlodhur. E dinte që gjumi nuk do t'i afrohej atë natë. U shtri e heshtur dhe e inatosur pranë të shoqit në shtratin e gjerë, të ri, prej rimesoje. Ndenji si e ngrirë për një kohë të gjatë.

Semi priste agimin me padurim.

— Më vjen keq që plaku u prek, — u dëgjua papritur zëri i të shoqit.

Semi, që e dinte të fjetur, në fillim u habit.

— Megjithatë, — vazhdoi ai, — duhet veshur ndryshe.

Semi ndjeu një afsh të nxehtë t'i përvëlojë trupin, desh të kthehej nga i shoqi, por s'mundi, sepse ndjeu lotët t'i rridhnin faqeve.

— Dil herët në mëngjez dhe mos qaj! — vazhdoi ai.

— Po, — u përgjegj Semi e ngashëryer.

Sapo zbardhi, ajo u ngrit, rregulloi fëmijët që flinin shkujdesur në shtratin tjetër dhe doli jashtë. Mugëtira e mëngjezit e mbështolli dhe ajo u drodh nga gëzimi dhe nga kontakti me ajrin e freskët të kopshtit, që po ringjallej nga rrezet e para të diellit që sapo prekën tokën.

\* \* \*

Më pas, Semi zbriti shtegun e ngushtë buzë arës së korrur.

Fustani i lehtë në ngjyrën e limonit shkiste dhe valavitej rreth trupit të saj. Semi dukej si lule agulice, që përmendet dhe shkundet nga drita.

Ajo zbriste ndryshe nga herët e tjera, më e lehtë, më e gëzuar dhe i shoqi, që e shihte nga dritarja e hapur, qeshte nën buzë.

— Iku? — e pyeti e ëma prapa krahëve të tij.

— Iku, — ju përgjegj i biri i qeshur.

Plaka psherëtiu dhe filloi të veshë kalamajtë që u zgjuan.

I biri ju afrua për ta ndihmuar.

Dita e re e punës sapo kish filluar.



DHIMBJE

Patjetër që do të binte shi. Blegërimat e shqetësuar të deleve, qielli i turbulluar e i mërzitshëm... të tëra këto shenja tregonin se shiu nuk ishte larg. Ja ku ranë pikat e para. Ca pika të mëdha që e bënë natyrën të rëqethej. Pastaj ranë pika të tjera... Ja behu me forcë shiu. Gjëmuan bubullimat. Shkrepën vetëtimat. Midis bubullimave shurdhonzëse që shuheshin të zvergura pas maleve dhe dëgjoheshin blegërimat e zgjarrëth e qark me forcë, dëgjoheshin shprehnin frikë e panik. Këto blegërima shprehnin frikë e panik.

Papritur, u ngrit mbi të gjitha zëri i çobanit:

— Deee! Ecn! përpara! Ç'trembeni kështu...

— Beee! Beee! Beeee!..

— Hajdeni tani... Lërin! nazet!

Tutje në pyll u dëgjuan të lehura qensh, pastaj një angullimë e kobshme ujku. Blegërima e deleve u bë më e shqetësuar. Çobani kalonte sa nga një anë në tjetrën, tundte në ajër shkopin e fliste me zë të lartë. Ai e ngucte tufën të zbriste sa më shpejt poshtë. Po të arrinte te lumi do ta kishte më lehtë. Gjithë halli ishte sa të arrinte te lumi...

Ju ndërpre në mendimet. Ai çoi kokën lart e mbajti vesh: nëpërmjet mjegullës së qullët, erdhi tek ai zëri i një deleje. Pastaj britma e një qengji, sërish zëri i

deles... pastaj të dy zërat u përzjenë njëri me tjetrin dhe e bënë të dridhej çobanin. «Mos e ka zënë ujku?» tha me vete e u sul drejt tyre.

— Na ujkuuuu! Hyaaa! — bërtiti me sa kish zë dhe e përplasi shkopin pas shkëmbit.

— Be, be, be! — e thirri aty afër delja. Çobani u hodh pas shkëmbit dhe pa se delja kishte mbetur në një çark nga ata që zënë kunadhe. Pranë saj kishte vajtur edhe qingji; sillej rrotull së jëmës e qante.

— Ç'deshe këtej, moj budallaqe. Gjithmonë kështu do të bësh ti? Mirë, mirë, po do ta gjesh ndonjë ditë kokën e kandilit, — i thoshte çobani, teksa i çlironte këmbën.

— Të dhemb? — e pyeti kur pa se delja nuk mund ta lëshonte këmbën përdhe. — E sheh tani ç'kusur të gjen kur ndahesh nga shoqet?

Dy-tri herë qingji i kaloi nëpër këmbë deles dhe ajo u rrëzua.

— Nuk ke faj ti, more xhan, jo, nuk ke faj ti. Faj ka kjo e madhja që i ka marrë koka erë. Po pse, kështu do të ecim ne, a? Hajde mendje, hajde! Kështu do të na zërë nata dhe lumi që na mori pastaj...

Ai e hodhi delen në qafë dhe e nguci tufën të ecte më shpejt. Kur arriti pranë lumit, shiu pushoi. Po tujtje në mal gjëmonin ende bubullimat. Lumi që fryrë nga ujërat e tepërta e kishte dalë jashtë shtratit. Rridhte me kaq furi e kaq i turbullt ish, sa dukej sikur nuk rridhte një lumë me ujë, po një lumë me llum të trashë. Çobanin e pushtoi një shqetësim: «Po sikur...» Shtangu në vend. Ura që shembur. U afrua pranë saj, kapi me dorë trapin e thyer dhe, siç ishte ashtu, me gojën gjysmë të çelur, zuri të marrë frymë me nxitim, pa u ngopur dot. «Po tani?» — pyeti me zë dhe kapi me duar kokën. Delet blegërinë. Eci një copë herë buzë lumit, duke shikuar të gjente vendin më të ngushtë. «Ja, këtu, tha, këtu do t'i kaloj». Ai pa se vërtet atje lumi që më i ngushtë, po në atë vend që edhe më i rrëmbyer. «Do t'i mbaj në qafë e do ti hedh tej një e nga një...» tha dhe u drejtua nga tufa. Mori një dele

dhe zbriti në lumë te vendi i ngushtë. Me të hedhur dy-tre hapa, ujët i erdhi menjëherë në mes dhe e mori yrysh. U përpoq të mbante ekuilibrin e të çante përpara, po nuk ja doli dot në krye. Rryma e nxori në një shesh të mbushur me baltë, po në atë krah që kishte tufën. I lodhur e i dëshpëruar, mezi i nxirrte këmbët nga balta. Kishte marrë fund. S'kishte ç'bënte. Natën do ta kalonte në breg të lumit. «Oh!» psherëtiu. Në tufë ishin nga trembëdhjetë shqerra. Qingja të vegjël, të bardhë, pullali... Qingja akoma të dobët për ti bërë ballë të ftohtit të natës. Ai u ul ashtu i qullur pranë një gorrice, mbështeti kurrizin te trangu i saj dhe mbylli sytë. Blegërima e deleve tani ishte e trishtuar, po çobani nuk dëgjonte. Ishte tepër i lodhur. Futi dorën në xhep dhe nxori shkrepshen. Shkrepsja qe qullur. Ai buzëqeshi dhe nxori nga xhepi tjetër masatin dhe gurin. Hodhi sytë përreth të gjente ca shkarpa dhe pa një kasolle të shkatërruar.

«Vjet kasollja mbahej akoma në këmbë... kush do t'i ketë djegur drutë?... pa shiko, pa shiko ç'kanë bërë! Nuk ka mbetur një qoshe për të futur kokën...» Pëshytyu, mori dhe vetë ca hunj gjysmë të djegur, gjeti ca driza e u kthye pranë gorricës. U ul në gjunjë mbi drizat e shkarpat, ndezi eshkën dhe i fryu asaj për një kohë të gjatë. Pastaj e lëshoi sipër turrës dhe i fryu përsëri derisa shkarpat u thanë e u ndezën. Atëherë e mblodhi tufën aty pranë e tha:

— Ç't'i bësh? Kusur për të hequr. Pa afrohuni dhe ca! Hë, ashtu... Bëjmë si bëjmë e kalojmë dhe këtë natë. Si thoni ju? — ju drejtua shqerrave dhe u përkëdheli kurrizin.

Qe errur. Qielli zuri të kthjellohej dhe aty-këtu dolën yje. Edhe në mal nuk gjëmonte më. Vetëm se frynte një erë e thatë, e ftohtë. Siç dukej, natën do të shtrëngonte edhe më të ftohtit. Delet u afruan edhe më pranë zjarrit dhe u mblodhën kokë më kokë. Çobani u çua disa herë e mblodhi shkarpa. Pastaj shtroi gunën e mbuloi me të pesë qingjat më të dobët. Të tjerët i

rregulloi mirë e mirë në mes të barkut të deleve e vetë u mbështet prapë më kurriz pas trungut të gorricës.

.....  
Ndaj të gdhirë erdhën nga ana e lumit ca të qeshura e zëra të gëzuar të rinjsh.

— Më lini në breg me plaçkat. Unë do të kontrolloj bregun e do t'i vë emrin. — tha një vajzë.

— Nuk ke frikë? — u dëgjua zëri i një djali.

— Frikë! Unë nuk e di ç'kuptim ka fjala frikë. Pse e tund kokën ashtu?

Djali hipi në barkën prej gome dhe u drejtua nga ana tjetër e lumit për të marrë shokët.

— Po të trembesh, thirrë sa të kesh në kokë. Dëgjove? — i foli me të qeshur djali nga mesi i lumit. Vajza mbeti në breg e mbështjellë nga mjegulla e bardhë. Ajo nuk u përgjegj, se po në atë kohë dëgjoi ca blegërima delesh. Vajza u drejtua andej nga vinin blegërimat. Me të kaluar brezin e mjegullës ajo pa pranë gorricës një çoban të shtrirë përdhe dhe një tufë delesh që i qenë mbledhur mbi kokë. Vajza i vajti më pranë dhe vuri re se dy qingia i lëpinin fytyrën çobanit, po ai nuk lëvizte. Kushedi pse, vajza u çua në majë të gishtërinjve dhe eci me kujdes. Me të arritur pranë çobanit, zemra i rahu me forcë. Çobani kishte rënë në krah. Goja i kishte mbetur paksa e çelur, sytë i kishte të mbyllur dhe lëkura e fytyrës i kishte marrë një ngjyrë të thellë mavi. Siç dukej çobani kishte ngrirë natën nga të ftohtit. Vajzës ju bë akull trupi. Ajo u kthye vetëtimthi e ja dha vrapit. Në breg të lumit lëshoi britmën. Djemtë u përgjigjën me të tallur nga mesi i lumit. Vajza thirri përsëri. Heshtje. Me sa kuptohej, vajza nuk e kishte me shaka. Ata i nxituan lëvizjet e remave. Kur arritën në breg, panë se fytyra e shoqes që bërë dyllë e verdhë.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti njëri prej tyre. Tej mjegullës u dëgjua blegërima e dëshpëruar e deleve.

— Atje, — tha vajza, — është një njeri... një çoban i ri. Më duket se ka vdekur.

Njëri nga djemtë i futi dorën çobanit në krahator dhe ja vuri mbi zemër. Të tjerët e patën mbërthyer shikimin mbi shokun e tyre. Heshtje. Dalëngadalë fytyra e djalit u mbush me dritë.

— Është gjallë! — tha dhe e shtriu çobanin në kuriz. I kapi krahët e zuri t'ja lëvizë me të shpejtë. Pastaj i fërkoj me forcë fytyrën.

— Ngrini çadrën, — tha, — dhe ndizni zjarr. Rregulloni dhe një shtrat. Unë po e fërkoj ende.

Një copë herë më pas çobanin e futën në çadër, e zhveshën nga mezi e sipër, e shtrinë në shtrat dhe zunë ta fërkojnë me alkool. Çobani i çeli sytë. Nga gëzimi vajza rrahu duart dhe e puthi në ballë. I dhanë të pinte konjak, e veshën përsëri me këmishën e njërit prej tyre, e mbuluan me batanije dhe e lanë ca kohë ashtu. Nga dreka çobani u përmend, i çuditur, ai pa fytyrën e qeshur të vajzës me flokë të gjatë, pa dhe fytyrat e tre djemve të tjerë që buzëqeshnin dhe ju duk se ishte në ëndërr.

— Çohu vëlla të hash bukë. A të pëlqen mishi i kutisë? Gjeologët hanë mish kutie.

Ç'ishte kjo vajzë që e shikonte me aq ëmbëlsj me sytë e kaltër e gjithë dritë? Ç'ishin këta djem që e ftonin të hante bukë? Përse ndodhej në çadër? U ul ndenjur në shtrat. I dhimbte koka e i merreshin mendtë. Jashtë blegërinë delet. «E? Mos blegërinë delet? Ku janë delet?» Jashtë blegërinë përsëri delet... Ai u çua në këmbë e doli jashtë.

— Ku shkon? — e pyeti vajza.

— Lëre, — tha djali. — Lëre të marrë ajër të pastër. Nuk e vunë re kur u kthye në çadër. Djemtë dëgjonin me vëmendje vajzën që diç u tregonte. Pastaj ata ja shkrepën përsëri të qeshurit. Ishin të lumtur, siç janë gjithmonë të rinjtë që u ecën puna mbarë. Çobani tërhoqi zvarrë gunën e u ul pranë prushit. Drodhi një cigare, e thithi tymin me tërë afshin e mushkërive, po atë çast e mbyti kolla. Grupi i vogël i gjeologëve ktheu kokën nga çobani. Ai qe përkulur i tëri mbi prush dhe shikonte me një trishtim të madh gacat e zjarrit.

— Nuk bën të rrish ashtu, çoban i maleve, — i tha vajza me zë të butë. — Ti duhet të gëzohesh...

— Kush shpëton nga vdekja, gëzohet, — i tha një tjetër. — Mos të vjen rëndë që të gjetëm pa ndjenja?... Cilitdo mund t'i ndodhë një gjë e tillë.

— Posi... tamam ashtu është. — shtoi i treti. — Ka qenë mbrëmë një të ftohtë që mos e pyet hallin.

— Urdhëro tani të hash, se na le edhe ne... — qeshi njëri.

Çobani psherëtiu.

— Ah, ta dish ti ç'më ka gjetur! Më kanë ngordhur tre qingja...

— Mos e bëj kaq të madhe, o çoban i maleve. Thuaj shyqyr që shpëtove vetë.

— I kisha si evlatër, vëllezër, i doja me shpirt... po, ja që më ngordhën... dhe jo pak, po tre... Dhe unë jam çoban i dalluar i kooperativës... eh, more...

U drodh i tëri, u mundua ta përmbante veten, po nuk ja doli dot në krye. Dhe grupi i vogël i gjeologëve panë se si ai çoban i fortë malesh qante si çilimi.

## PËRMBAJTJA E LENDEË

	Faqe
Dy fjalë lexuesit .....	3
Prova e madhe — <b>F. Gjata</b> .....	5
Hasmi — <b>R. Pulaha</b> .....	37
Cila është komuniste — <b>E. Mandia</b> .....	45
Kënga e re. gjyshja dhe ne — <b>A. Kondo</b> .....	55
Atë dimër — <b>N. Prifti</b> .....	61
Litar i zjarrtë — <b>N. Prifti</b> .....	67
Nënë e bir — <b>L. Qafëzezi</b> .....	76
Qyteti që kish humbur qetësinë — <b>Gj. Vlasi</b> .....	88
Lugina përcjell jehonën e jetës — <b>Dh. Xhuvani</b> .....	95
Dorashkat — <b>F. Çakaj</b> .....	104
Historia — <b>I. Kadare</b> .....	112
Rrugës, mes njerëzve të thjeshtë — <b>A. Kondo</b> .....	122
Ndërruesi i çative — <b>T. Laço</b> .....	133
Ajo zbriti shtegun më e lehtë, më e gëzuar — <b>M. Dhroso</b> ..	138
Dhimbje — <b>A. Cerga</b> .....	145